



Botues: Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger
Përkthyes: "UEGEN"
Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj

Rritemi në demokraci

Veprimtari mësimore për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut
Për arsimin fillor

RRITEMI NË DEMOKRACI

Veprimtari mësimore për Qytetarinë Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (EQD / EDNJ)
Për arsimin fillor

Botues: Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger
Autorë: Rolf Gollob dhe Wiltrud Weidinger

Volumi II
i EQD/EDNJ Volumet I-VI
Edukimi për qytetari demokratike
dhe të drejtat e njeriut në praktikën e shkollës
Njësi mësimore, koncepte, metoda dhe modele

Botim i Këshillit të Evropës

Opinionet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet ose të transmetohet, në ndonjë formë ose me çdo mjet, elektronik (CD-Rom, Internet etj.) ose në mënyrë mekanike, përfshirë fotokopjimin, incizimin ose ndonjë sistem tjetër ruajtjeje e rikthimi të informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i *Publikime për Informim Publik* dhe *Drejtoria e Komunikimit* (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Koordinimi për prodhimin, dizajnimin dhe redaktimin e këtij vëllimi është bërë nga IPE (*Projektet Ndërkombëtare në Edukim*; www.phzh.ch/ipe) i Universitetit të **Zyrihut** për Edukimin Pedagogjik të Mësuesve (Pädagogische Hochschule Zürich).

Ky botim është bashkë-financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ilustrimet: Peti Wiskemann

Kapaku: Peti Wiskemann

Faqosja: Dokumentet dhe Publikimet e Departamentit të Prodhimit (SPDP), Këshilli i Evropës

F-67075 Strasbourg Cedex

<http://book.coe.int>

ISBN 978-92-871-6728-6

© Këshilli i Evropës, qershor 2010

Shtypur në Belgjikë

Bashkautorë dhe bashkëpunëtorë

Emir Adzovic – Bosnjë-Hercegovinë

Svetlana Poznyak – Ukrainë

Beatrice Bürgler-Hochuli – Zvicër

Sarah Keating-Chetwynd – Këshilli I Evropës

Regula Kleinberger – Zvicër

Peter Krapf – Gjermani

Laura Loder-Büchel – Zvicër

Sabrina Marruncheddu Krause – Zvicër

Ólöf Ólafsdóttir – Këshilli i Evropës

Arber Salihu – Kosovë¹

Felisa Tibbitts –SHBA

Gordana Trajkova Kostovska – “Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë”

1. Të gjitha referencat për Kosovën, si për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim për statusin e Kosovës.

Përmbajtja

Hyrje.....	7
Korniza konceptuale e këtij manuali	9
1. Parimet themelore të EQD/EDNJ.....	9
2. Tre dimensionet e kompetencës.....	10
3. Konceptet kryesore - thelbi i nëntë kapitujve.....	13
KAPITULLI 1: Identiteti - Unë jam në komunitetin tim.....	15
KAPITULLI 2: Diversiteti dhe pluralizmi - Në shtëpi, në Evropë.....	23
KAPITULLI 3: Barazia - shumica dhe pakicat.....	32
KAPITULLI 4: Konfliktet - Rregulla që ndihmojnë për të zgjidhur konfliktet.....	44
KAPITULLI 5: Rregullat dhe ligji - Baza e të jetuarit së bashku.....	52
KAPITULLI 6: Pushteti dhe autoriteti - Unë jam bos! A jam unë?.....	62
KAPITULLI 7: Përgjegjësia - Unë bëhem <i>eko</i> ... merr pjesë edhe shkolla ime!.....	72
KAPITULLI 8: Të drejtat dhe liritë - Të drejtat e mia - Të drejtat tuaja.....	83
KAPITULLI 9: Media - Media në përdorim: Unë do ta bëja nëse do të mundesha.....	95
Manual për nxënësit.....	109
Fletë pune për nxënësit.....	111
II. Mjete për nxënësit.....	139
Ilustrimet: Të fshehtat e nëntë koncepteve bazë.....	157

Hyrje

Shkolla është vendi i mësimdhënies dhe të mësuarit. Kjo ka qenë gjithmonë e tillë dhe shpresojmë se do të qëndrojë në këtë rrjedhë. Por, ajo që ka ndryshuar, ka të bëjë me çfarë është mësuar në shkollë dhe se si është mësuar ajo. Shoqëria ka ndryshuar dhe ndryshon me shpejtësi në drejtim të jetës ekonomike dhe sociale dhe shkollat janë nën presion që të përshtaten sa më mirë të mundën me kushtet e reja.

Ajo që ka ndryshuar në mendjet e shumë njerëzve ka të bëjë me faktin se shkolla nuk është vetëm një vend ku nxënësit përgatiten për jetën e të bëhen gati kur të rriten; ajo është gjithashtu një vend ku njerëzit kalojnë shumë kohë së bashku. Kjo, në vetvete, jep një mundësi për të mësuar nga të tjerët, por në të njëjtën kohë, në mënyrë të qartë, i detyron nxënësit të mësojnë *aftësitë sociale*.

Nëse një shkollë vendos për të integruar EQD/EDNJ - Edukimin për Qytetarinë Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut - në sistemin e saj (shumë shkolla gëzojnë një shkallë të lartë autonomie), atëherë ajo vendos për të ndërtuar jetën shkollë në mënyrë aktive dhe për të krijuar një situatë të mësuarit model për edukimin e demokracisë. Gjithë shkolla - jo vetëm një klasë - mund të bëhet një mikro-shoqëri. Kjo nuk është thjesht një foto e idealizuar, por një realitet. Askush nuk thotë se të jetuarit së bashku është i lehtë dhe pa konflikte, aq më tepër që shkolla nuk mund të përjashtohet. Por, sidoqoftë, ky nuk duhet të bëhet një qëllim në vetvete. E pra, në shkollë duhet të kemi mundësi e të jemi në gjendje të njohim interesat e ndryshme, t'i sqarojmë këto interesa dhe të mësojmë prej tyre, sepse këto aftësi do të jenë thelbësore për jetën si qytetar.

Ky manual kryesisht u kushtohet mësuesve. Përvoja ka treguar se ai u shërben edhe trajnuesve, zhvilluesve të kurrikulës, autorëve të teksteve, redaktorëve dhe përkthyesve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe ndoshta edhe më larg, moshës së pleqërisë.

Ky manual përmban nëntë kapituj mësimorë për Edukimin për Qytetarinë Demokratike (EQD) dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut (EDNJ). Kapitujt, të përbërë nga katër mësimet secili, janë të destinuar për nxënësit e vitit të fundit të shkollës fillore - përgjithësisht të moshës 10 ose 11 vjeç. Çdo kapitull përqendrohet në një *koncept kyç* lidhur për EQD ose EDNJ: identiteti - pluralizmi - barazia - konfliktet - rregullat dhe ligjet - qeveria - përgjegjësia - liria - komunikimi. Për çdo mësim sugjerohen hapat që duhet të ndiqen me detaje, sigurisht për aq sa kjo është e mundur.

Nëntë *Kapitujt* e paraqitur në këtë manual nuk mund të grupohen së bashku për të formuar një lëndë të quajtur "Edukimi i demokracisë", "Edukimi qytetar" ose çfarëdo tjetër që ju zgjidhni për ta quajtur atë. Kapitujt e veçantë mundën, megjithatë, të përdoren në mësimet e gjuhëve, gjeografisë, historisë, në lëndët shoqërore, etikë dhe arte etj. Në marrëveshje me ekspertë të ndryshëm nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, autorët kanë zhvilluar njësitë mësimore me synim të veçantë tek elementet shpesh të EQD/EDNJ, të cilat mund të integrohen lehtësisht në kurrikulën ekzistuese. Temat e EQD/EDNJ nuk janë për t'u studiuar në mënyrë të izoluar, por të lidhen, në këndvështrim të ndryshme në lëndët që mësohen normalisht në shkollën fillore. Autorët e kanë integruar këtë ide në strukturën dhe organizimin e këtij manuali dhe i kanë organizuar njësitë mësimore, në mënyrë të tillë që ato të bazohen në kompetencat ekzistuese të mësuesve të shkollave fillore dhe në kompleksitetin e mësimdhënies në lëndë të ndryshme. Për ta përmbledhur, nga këndvështrimi i përdoruesit, është e rëndësishme t'i përgjigjemi pyetjes nëse EQD/EDNJ është një lëndë e re apo jo.

Për shumicën e shkollave në shumicën e vendeve, EQD/EDNJ nuk është një lëndë e re në shkollën fillore. Ajo shton një këndvështrim të ri në mësimdhënien dhe në të mësuarit brenda kurrikulave ekzistuese. Kjo do të thotë se mësuesit dhe nxënësit nxiten të punojnë në mënyrë të ndryshme dhe më frytdhënëse.

EQD/EDNJ përqendrohet në arritjet më të mira të nxënësve, që ata të bëhen qytetarë aktivë, të gatshëm dhe në gjendje për të marrë pjesë në formësimin e të ardhmes së bashkësive të tyre,

(me fjalë të tjera, edukimin për demokracinë dhe të drejtat e njeriut). Njëkohësisht, EQD/EDNJ ndjek parimet themelore të mësimdhënies së mirë. Pjesëmarrja në demokraci mundet dhe duhet të edukohet në shkollë, dhe mund të integrohet në çdo lëndë, në çdo nivel moshe. Ndërtimit të *kompetencave* i jepet përparësi ndaj qasjes tradicionale të mësimdhënies në bazë të kurrikulës bazë.

Sigurisht, EQD/EDNJ ka gjithashtu dimensionin që bazohet te përmbajtja, - edukimi për demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Elemente të tilla mund të integrohen në lëndë të tilla si edukimi qytetar, ose mund të përfshihen në histori dhe shkencat sociale.

Por elementi kyç i mësimdhënies së EQD/EDNJ është mësimi në frymën e (ose *nëpërmjet*) demokracisë dhe të drejtave të njeriut, dhe kjo këndvështrim i ri trajtohet në gjithë shkollën. Ky manual tregon se këndvështrimi i EQD/EDNJ sjell metoda të reja të mësimdhënies dhe të mësuarit në klasë, duke pasuruar kështu rolet e mësuesit dhe nxënësit. Nxënësit kanë në dispozicion një kohë më të madhe, *si kohë e të mësuarit real*, ndërsa mësuesi vepron si mbështetës dhe vëzhgues, përveç rolit të tij tradicional si instruktor. Modelet mësimore inkurajojnë mësuesin të përqendrohet në temat e zgjedhura dhe për t'u dhënë nxënësve kohë që t'i trajtojnë këto çështje tërësisht - me fjalë të tjera "të bëjë më pak, por ta bëjë atë mirë".

Mjete dhe fletë pune - manuali për nxënësit

Parim qendror i të gjithë kapitujve është veprimtaria e nxënësve. Kjo bazohet në faktin se të mësuarit është një proces aktiv i të mësuarit dhe jo vetëm një proces i të dëgjuarit pasiv. Në këtë mënyrë, njësitë mësimore shndërrohen në momentet e komunikimit, të kërkimit të informacionit, e pyetjeve dhe shpjegimit. Mësuesi i mbështet këto procese dhe e di mirë se të mësuarit për demokracinë është një proces i vazhdueshëm dhe se, në këtë drejtim, gabimet janë të natyrshme. Të mësuarit e pavarur mbështetet në të ashtuquajturat "mjete". Dymbëdhjetë metodat e zgjedhura mbështesin këtë të mësuar të pavarur dhe të vetë-drejtuar (duke studiuar në biblioteka, kërkime në Internet, kryerjen e intervistave dhe sondazheve, interpretimin e imazheve, një lloj planifikimi me mend, krijimin e afisheve, organizimin e ekspozitave, duke bërë prezantime, përgatitje të sliderave me projektorë ose prezantime në *PowerPoint*, shkrimi i artikujve në gazeta, organizimi i shfaqjeve ose debateve).

Fletët e punës të nxënësve japin një mjet tjetër mbështetjeje. Këto fletë pune janë të veçanta, u përkasin kapitujve dhe u shpërndahen nxënësve. Të gjitha *Fletët e punës* së nxënësve mund të gjenden në fund të këtij manuali. Paketa e plotë e tyre mund të merret lehtësisht jashtë dhe të fotokopjohet për nxënësit. Çdo fletë është me numër sipas *kapitullit* dhe mësimi në të cilën përdoret (p.sh. Kapitulli 2, mësimi 2). Mësuesi vendos se si dhe kur do të përdoren *Fletët e Punës* nga nxënësit dhe se si do të mblidhen prej tyre. Në disa raste mund të jetë praktike një dosje, në disa raste të tjera mësuesit mund të preferojnë për ta vënë çdo gjë në një libërth të veçantë, ose për ta përdorur si paketë ashtu siç jepet në këtë manual - si një broshurë e integruar.

Përvoja e kaluar në përdorimin e materialeve të kopjuara ka treguar se kërkesa më e rëndësishme për mësuesit është se ato duhet të jenë praktike dhe vetë-shpjeguese. *Fletët e Punës* duhet të jenë plotësuese dhe të dobishme, jo të vështira për t'u kuptuar dhe pa konsum kohe për t'u shpjeguar. Për këtë arsye të gjitha *Fletët e Punës* të paraqitura në këtë manual janë të lehta për t'u përdorur, të lehta për t'u kuptuar, të lehta për të modifikuar dhe të lehta për t'u përshtatur me nevojat specifike të një klase ose për variacione në metodat e mësimdhënies. Përveç vlerësimit të zakonshëm për formimin e nxënësve, pjesëmarrjes në veprimtari të e klasës, regjistrimit të pjesëmarrjes së tyre si dhe motivimin e tyre, *Fletët e Punës* përfaqësojnë gjithashtu edhe një mjet mund të shërbejë për vlerësimet me shkrim.

Korniza konceptuale e këtij manuali

1. Parimet themelore të EQD/EDNJ

Qytetaria aktive mësohet më mirë duke vepruar, jo duke u folur për të. Individët duhet të kenë mundësi për të shqyrtuar çështje të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut për veten e tyre, jo t'u thuhet si duhet të mendojnë apo të sillen. Edukimi për qytetari aktive nuk ka të bëjë vetëm me përvetësimin e njohurive faktike, por edhe me të kuptuarit praktik, me shkathtësitë dhe, doemos, vlerat dhe karakteret. Mediumi është mesazhi - nxënësit mund të mësojnë rreth qytetarisë demokratike si nga shembujt e dhënë nga mësuesit dhe mënyrat e organizimit të jetës në shkollë, edhe nga metodat formale të të mësuarit.

Këto parime kanë disa ndërlikime të rëndësishme për proceset e të mësuarit të EQD/EDNJ, domethënë:

a) Të mësuarit aktiv

Mësimdhënia në EQD/EDNJ duhet të theksojë të mësuarit aktiv. *Të mësuarit aktiv* është të mësuarit përmes veprimit. Ky është të mësuarit që arrihet përmes përjetimit të situatave dhe zgjidhjes së problemeve nga vetë nxënësit, në vend të dhënies së përgjigjeve nga dikush tjetër. *Të mësuarit aktiv* referohet shpesh herë si të mësuarit "eksperimental".

Të mësuarit aktiv është i rëndësishëm në EQD/EDNJ, sepse të qenët qytetar është një veprimtari praktike. Njerëzit mësojnë për demokracinë dhe të drejtat e njeriut nëpërmjet ushtrimit të tyre, jo vetëm duke u folur për to. Në arsimimin zyrtar, kjo përvojë fillon në klasë, por ajo vazhdon përmes karakterit dhe kulturës së shkollës, duke u trajtuar disa herë si mësim nëpërmjet demokracisë ose përmes të drejtave të njeriut.

Të mësuarit aktiv mund të jetë një formë më stimuluese dhe motivuese e të mësuarit sesa mësimi tradicional dhe mund të sjellë një qëndrueshmëri më të gjatë të të mësuarit - si për të rriturit edhe të rinjtë - për shkak se nxënësit janë të përfshirë personalisht. Kjo përfshirje ndihmon gjithashtu të mësuarit, sepse përqendrohet në shembujt konkret, në vend të vetëm parimeve abstrakte. Në të mësuarit aktiv, nxënësit inkurajohen që t'i nxjerrin parimet e përgjithshme nga rastet konkrete, jo e kundërta, për shembull, duke marrë parasysh llojet e ndryshme të të drejtave në bazë të një doracaku për "të drejtat" specifike në shkollë - të tilla si rregullat ose kodet e sjelljes shkollore - në vend të diskutimeve abstrakte rreth konceptit të të drejtave.

b) Veprimtaritë përmes detyrave

Mësimdhënia e EQD/EDNJ bazohet në detyrat që mësuesit duhet të realizojnë gjatë mësimdhënies së EQD/EDNJ. Prandaj ky manual ndjek parimet e të mësuarit përmes detyrave.

Të mësuarit përmes detyrave është i rëndësishëm për një numër arsyesh:

- Sepse është një formë e shkëlqyer e të mësuarit aktiv - e thënë ndryshe, të mësuarit përmes veprimit.
- Sepse siguron një strukturë për mjedise të ndryshme të të mësuarit.
- Sepse maksimizon kohën në dispozicion për të mësuar, ndërkohë që nxënësit janë duke punuar në detyrat që sidoqoftë ata duhet t'i bëjnë.
- Sepse jep për zgjidhje probleme të jetës reale dhe materiale autentike për të analizuar.
- Sepse e bën të mësuarit më të kuptueshëm dhe për pasojë edhe më stimulues.
- Sepse u jep nxënësve një ndjenjë zotësie dhe arritjeje.

c) Puna në ekip

EQD/EDNJ duhet të theksojnë format bashkëpunuese të të mësuarit, të tilla, si p.sh., duke punuar në çifte, në grupe të vogla ose grupe të mëdha dhe (ose) në grupe përkrah bashkëmoshatarëve. Të punosh në ekiye është e rëndësishme sepse:

- I pajis nxënësit me modelet e veprimtarisë bashkëpunuese në grup, që më pas mund t'i zbatojnë në klasë.
- I nxit nxënësit për të shkëmbyer përvojat dhe opinionet e tyre dhe, duke ndarë problemet e veta me ta, ndihmon në rritjen e shanseve për zgjidhjen e tyre.
- Vepron si një kundërpeshë ndaj përvojës së qëndrimit të vetmuar në klasë.

d) Metodatat ndërvepruese

EQD/EDNJ duhet të vënë theksin në *metodat ndërvepruese*, të tilla si diskutimet dhe debatet. Metodatat ndërvepruese janë të rëndësishme sepse:

- Ndihmojnë mësuesit të mësojnë se si të përdorin metodatat ndërvepruese në mësim.
- Ato janë një mënyrë për të nxitur mësuesit që të bëhen pjesëmarrës aktiv në trajnim.

e) Të menduarit kritik

Sigurisht EQD/EDNJ i nxit nxënësit të reflektojnë për vetë çështjet e EQD/EDNJ, në vend që të marrin "të gatshme" përgjigjet nga mësuesit. Kjo është e rëndësishme sepse:

- I ndihmon nxënësit të mendojnë vetë, një tipar thelbësor i qytetarisë demokratike.
- I pajis ata me ndjenjën e zotërimit dhe të fuqizimit: ata ndihen të aftë të marrin përgjegjësi për të gjithë të tjerët.

f) Pjesëmarrja

EQD/EDNJ u jep nxënësve mundësi që të kontribuojnë në procesin e trajnimit. Ata duhet të nxiten, sa më shumë të jetë e mundur, që të jenë aktivë në të mësuarit e tyre, në vend që të përfitojnë dituritë në mënyrë pasive.

- Për shembull, duke zgjedhur detyrat që dëshirojnë të përgatisin, vlerësimi i pikave të tyre të forta dhe dobësive të tyre, si dhe vendosjen e objektivave për mënyrën se si mund të përmirësohen.

Elementi i pjesëmarrjes është i rëndësishëm sepse:

- ai ndihmon nxënësit të mësojnë se si të ndërtojnë pjesëmarrjen në jetën e tyre jashtë shkollës.
- ai i fuqizon ata dhe u jep edhe një ndjenjë të qartë zotërimi.

Në pak fjalë, EQD/EDNJ:

- Është **aktiv** - thekson të mësuarit duke vepruar.
- **Bazohet te detyra** - strukturuar rreth detyrave aktuale të EQD/EDNJ për mësimdhënien.
- Është **bashkëpunues** – aktivizon punën në grup dhe të mësuarit bashkëpunues.
- Është ndërveprues - përdor diskutimin dhe debatin.
- Është **kritik** - nxit nxënësit të mendojnë për veten e tyre.
- Është **pjesëmarrës** – u mundëson nxënësve që të kontribuojnë në procesin e trajnimit.

2. Tre dimensionet e kompetencës

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha: analiza dhe gjykimi politik, përdorimi i metodave dhe vendimmarrja në politikë e veprim, të cilat janë të gjitha të lidhura ngushtë, madje për këtë arsye nuk duhet të trajtohen veçmas.


Në çdo mjedis të mësuarit - qoftë me apo pa vetëdije - do të ketë elemente për të tri kompetencat, të cilat, edhe pse jo të gjitha, do të preken në të njëjtin nivel thellësie. Kjo nuk është e nevojshme, pasi ndonjëherë krijohet mundësia që të përqendrohemi më shumë te

metodat, herë të tjera te veprimi e në raste të tjera tek analiza. Në çdo kapitull, ne japim një vlerësim të përafërt të shkallës së zhvillimit të tri kompetencave, duke përdorur një tabelë të ngjashme me shembullin e mëposhtëm. Tre yjet tregojnë një nivel të lartë, dy yje një nivel mesatar dhe një yll një nivel më të ulët. Megjithatë, varet nga metodat e mësimdhënies dhe përzgjedhja e situatave mësimore nëse disa prej kompetencave do të bëhen më të rëndësishme sesa parashikohet.

Kompetenca në ...		
... analizën politike dhe gjykimin	përdorimin e metodave	vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	*	***

Më poshtë është një pamje e të tri kompetencave në fushën e EQD dhe EDNJ. Ky koncept i tri kompetencave është diskutuar gjerësisht në shkencat politike dhe ende nuk ka përgjigje përfundimtare për këtë diskutim.²

A	B	C
Kompetenca në analizat politike dhe gjykim	Kompetenca në përdorimin e metodave	Kompetenca në vendimmarrjen dhe veprimin politik
Aftësia për të analizuar dhe diskutuar ngjarjet politike, çështjet e diskutueshme, si dhe problemet e zhvillimit ekonomik dhe social, duke marrë në konsideratë aspektet dhe vlerat e çështjeve në diskutim.	Përvetësimi i dhuntive dhe aftësitë për të zbuluar e absorbuar informacionin, në përdorimin e mjeteve dhe medieve të komunikimit, si dhe për pjesëmarrjen në debatin publik e në vendimmarrje.	Aftësia për të shprehur mendimet, vlerat dhe interesat në mënyrë të përshtatshme në publik. Aftësia për të negociuar dhe kompromis. Aftësia për të vlerësuar mundësitë (dhe kufizimet) e dikujt në pjesëmarrjen politike dhe në zgjedhjen e duhur rreth një plani veprimi.



A. Kompetenca në analizat dhe gjykimin politik

Qëllimi është të zhvillojmë kompetencën për të analizuar ngjarjet politike, problemet dhe çështjet e diskutueshme dhe për të aftësuar nxënësit të shpjegojnë arsyet për gjykimet e tyre vetjake. Shkolla mund të kontribuojë në këtë proces, duke i mbështetur nxënësit në përdorimin e qasjeve të strukturuar në bazë të koncepteve kyçe, për të arritur në një nivel më të lartë të të menduarit kritik.

² Për më shumë, shih botimin e KE “Si, të gjithë mësuesit mund të mbështesin edukimin për qytetarinë dhe të drejtat e njeriut *rights: kuadër për zhvillimin e kompetencave*” (2009). Manuali mund të shkarkohet në adresën www.coe.int/edc.

Për të aftësuar nxënësit të zhvillojnë këtë nivel gjykimi (gjë që duhet të mendohet me kujdes) janë të nevojshme kompetencat e mëposhtme:

- Aftësia për të kuptuar rëndësinë e vendimeve politike për jetën e vet personit.
- Aftësia për të kuptuar dhe gjykuar rezultatet e vendimeve politike, që ndikojnë për aktorët dhe ata që nuk janë aktorë, të qëllimshme apo të paqëllimshme qofshin këto vendime..
- Aftësia për të kuptuar dhe paraqitur këndvështrimin vetjak dhe atë të tjerëve.
- Aftësia për të kuptuar dhe zbatuar modelin tredimensional të politikës: **a)** dimensionin institucional **b)** dimensionin i përmbajtjes dhe **c)** dimensionin i procesit.
- Aftësia për të analizuar dhe vlerësuar fazat e ndryshme të proceseve politike në nivelin *mikro* (jeta në shkollë), - nivelin e *mesëm* (komuniteti ose bashkësia) dhe në nivelin *makro* (politika kombëtare dhe ndërkombëtare), duke zbatuar parimet e qeverisjes demokratike dhe ato të drejtave të njeriut.
- Aftësia për të paraqitur faktet, problemet dhe vendimet me ndihmën e kategorive analitike, duke identifikuar aspektet kryesore të lidhura ngushtë me vlerat themelore të drejtave të njeriut dhe të sistemeve demokratike.
- Aftësia për të identifikuar kushtet sociale, ligjore, ekonomike, mjedisore dhe ndërkombëtare, si dhe interesat e zhvillimeve, në diskutimet rreth çështjeve aktuale të diskutueshme.
- Aftësia për të kuptuar dhe për të vlerësuar mënyrën në të cilën çështjet politike janë paraqitur nga media.

B. Kompetenca në përdorimin e metodave

Për të marrë pjesë në proceset e ndryshme politike, nuk është e domosdoshme që të kesh vetëm njohuri themelore rreth çështjeve politike, kornizave kushtetuese dhe ligjore si dhe proceseve të vendimmarrjes, por edhe të kesh kompetenca të përgjithshme të fituara si pjesë e lëndëve të tjera (të tilla si komunikimi, bashkëpunimi, që lidhen me informacionin, të dhënat dhe statistikat). Aftësi e dhunti të veçanta, si ato të qenit i aftë për të argumentuar *pro* ose *kundër* një çështjeje, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për pjesëmarrjen në ngjarjet politike, duhet të trajnohen dhe promovohen në edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin për të drejtat e njeriut. Kjo vë theksin në të mësuarit përmes detyrave, sepse dhënia e detyrave, është thelbësore në zhvillimin e kompetencave. Në EQD/EDNJ, metodat e përshtatshme për simulimin ose mbështetjen e çështjeve kundërshtuese në publik janë mjaft të përhapura (p.sh., diskutimet dhe debatet). Për të arritur këtë, janë nevojshme aftësitë e mëposhtme:

- Aftësia për të punuar në mënyrë të pavarur në gjetjen, përzgjedhjen, përdorimin dhe prezantimin e informacionit të dhënë nga masmedia dhe (ose) mediat e lajmeve, në mënyrë kritike e të përqendruar (duke përdorur statistika, harta, diagrame, lista, karikatura etj.).
- Aftësia për të përdorur mediet në mënyrë kritike si p.sh. për të zhvilluar produktet të veta mediatike.
- Aftësia për të kryer kërkime, domethënë për të marrë informacion nga burime origjinale nëpërmjet vëzhgimeve dhe intervistave.

C. Kompetenca në vendim-marrjen demokratike dhe në veprim

Qëllimi është për të përvetësuar aftësinë e bashkëveprimit me besueshmëri e në mënyrë të përshtatshme me mjediset politike dhe në publik. Për të arritur këtë, janë të nevojshme aftësitë dhe sjelljet e mëposhtme:

- Aftësia për t'i shprehur mendimin politik në mënyrë adekuate dhe me vetë-besim duke zotëruar forma të ndryshme të dialogut, debatit dhe diskutimit.
- Aftësia për të marrë pjesë në jetën publike dhe për të vepruar politikisht (duke argumentuar, diskutuar, debatuar, drejtuar një diskutim; ose duke përgatitur një prezantim me shkrim dhe me mjete pamore për afishe, gazeta muri, minutat e një takimi, letra për redaktorin, shkrimin e peticioneve etj.).

- Të jenë në gjendje të pranojnë mundësitë e tyre për të ushtruar ndikim politik dhe të formojnë koalicione me të tjerët.
- Aftësia për të pohuar se ka të drejtë, por edhe për të bërë kompromis.
- Gatishmëria dhe aftësia për të njohur idetë dhe “lojtarët” antidemokratikë dhe për t’u dhënë atyre përgjigjen e duhur.
- Gatishmëria dhe aftësia për t’u sjellë në mënyrë të hapur dhe në frymën e mirëkuptimit në një kontekst ndërkulturor.

3. Konceptet kryesore - thelbi i nëntë kapitujve

Të menduarit dhe të mësuarit kanë të bëjnë shumë në ndërlidhjen e konkretes me abstrakten. Konceptet kyç në këtë manual, si dhe ato në vëllimet e tjerë të EQD/EDNJ janë zhvilluar duke përdorur shembuj konkretë dhe janë përqendruar në situata të të mësuarit ndërveprues..

Artisti që ka krijuar faqen e kapakut ka vizatuar nëntë copë enigma, nga një për çdo kapitull. Së bashku ato formojnë një gjëgjëzë të plotë. Kjo tregon se të nëntë konceptet janë të lidhura në shumë mënyra dhe formojnë një të tërë kuptimplote. Është po aq e rëndësishme të dimë se çdo kapitull mund të përdoret edhe si një njësi e pavarur dhe kështu çdo pjesë e enigmës ka një vlerë të brendshme në vetvete. Të nëntë kapitujt së bashku kanë potencial për të plotësuar një vit të plotë mësimdhënieje të EQD/EDNJ.

Një fjalë e urtë thotë se “një fotografi vlen më shumë se një mijë fjalë”. Kjo gjëgjëzë mund t’i kumtojë lexuesit një informacion të gjerë në lidhje me konceptet kyçe në këtë manual, për kërkesat për zgjedhje didaktike, si dhe në lidhje me *të mësuarit konstruktivist*.

KAPITULLI 1

IDENTITETI

Arsimi fillor

Unë në komunitetin time



1.1 Kjo është ajo që më pëlqen

Unë jam djalë / Unë jam vajzë dhe ndihem mirë me atë që më pëlqen dhe bëj

1.2 Simbolet e mia personale (stema e simboleve I)

Kjo është ajo që unë jam

1.3 Kjo është stema jonë e simboleve (stema e simboleve II)

Ne jemi të fortë si grup, sepse jemi individë të fortë

1.4 Individët dhe grupet

Fuqitë e individëve si potencial për shoqërinë

Kapitulli 1: Koncepti kryesor - "Identiteti" (për arsimin fillor)

Informacion në ndihmë të mësuesit: si ndikojnë perceptimet e vetë nxënësve për veten në identitetin dhe pjesëmarrjen e tyre në grupe dhe si e shohin ata shoqërinë?

"Identiteti", në një kontekst psikologjik, ka të bëjë me imazhin e vet (modeli i tij mendor), vetëvlerësimi dhe individualiteti. Identiteti gjinor është një pjesë e rëndësishme e konceptit të identitetit. Kjo dikton në një shkallë domethënëse se si një individ e sheh vetveten, si person dhe në lidhje me të tjerët dhe, për këtë arsye, dikton edhe potencialin që ai mund të sjellë në një grup.

"Identiteti" në kontekstin *sociologjik* fokusohet në konceptin e sjelljes në role. Në këtë drejtim, individi zbulon identitetin e tij (ose të saj) me anë të mësimit të roleve sociale dhe përvojave vetjake në këto role.

Megjithatë, "identiteti" është përdorur zakonisht për të përshkruar identitetin personal - të gjitha gjërat që e bëjnë një person *unik*, të veçantë. Ndërkohë, sociologët shpesh e përdorin termin për të përshkruar identitetin social ose gjithë anëtarësinë e një grupi që përcakton individin.

Duket qartë se identiteti është shumë i rëndësishëm në fusha të ndryshme. Në kuadrin e EQD dhe EDNJ, identiteti ka një karakter specifik: nëse njerëzit e kanë sqaruar pozicionin e tyre ata janë të aftë të përkrahin njëri-tjetrin si individë dhe në grup. Ky është një proces i përvetshëm dhe vazhdimisht në ndryshim. Sqarimi i identitetit ose zbulimi i identitetit të dikujt duhet kësajsoj të mbështetet që në moshë të hershme. Kjo nuk duhet të bëhet me mjete didaktike, por duke u dhënë individëve mundësinë që të gjejnë veten, me të gjitha përparësitë dhe dizavantazhet që përfshihen në të. Një shtet i hapur dhe demokratik mund të funksionojë vetëm nëse individët mund të mbrojnë të tjerët, pa humbur veten e tyre në këtë proces.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është në mbështetjen e zhvillimit të kompetencave në tri fusha. Ky krye ka profilin e mëposhtëm të kompetencës:

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	***	*

Mjetet mbështetëse

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga ato që përdorin nxënësit. Mësimdhënësi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit duhet të bëjnë përgatitje shtesë që të jenë në gjendje për të punuar me këto mjete.

- Hulumentim në biblioteka
- Hulumentim në internet
- Kryerja e intervistave dhe sondazheve
- Interpretimi i imazheve
- Harta mendore
- Krijimi i afisheve
- Organizimi i ekspozitave
- Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve
- Përgatitja e sliderave me projektor ose një prezantim në PowerPoint
- Shkrim artikujsh gazetash
- Organizim shfaqjesh
- Organizim debatesh

Kapitulli 1: Identiteti**Unë në komunitetin tim****Si ndikon perceptimi për veten në identitetin e nxënësve, në pjesëmarrjen e tyre në grup dhe këndvështrimin e tyre për shoqërinë?**

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Kjo është ajo që më pëlqen	Nxënësit zbulojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre dhe të tjerëve. Ata bëhen të vetëdijshëm për efektet e stereotipave gjinore.	Nxënësit shkruajnë preferencat dhe sjelljet e tyre të ndarë në katër kategori. Ata shkëmbejnë përgjigjet me njëri tjetrin dhe reflektojnë rreth tyre.	Letër dhe stilolapsa, kopjet e shtypura të materialit të shtypur ("Më pëlqen dhe nuk më pëlqen" tabelë).	Punë individuale dhe në grup, diskutim në seancë plenare.
Mësimi 2: Simbolet e mia personale (stema e simboleve I)	Nxënësit nxisin vetë-respektin, duke njohur dhe vlerësuar aspektet e tyre pozitive.	Nxënësit krijojnë simbolet e tyre personale të cilat do të jenë stema e emblemës së grupit. Ata i drejtojnë pyetje vetes në lidhje me perceptimin për veten dhe përdorin pikat e forta të identitetit si në mësimin 1. Nxënësit formojnë grupe si një parakusht për mësimin 3.	Tabelat nga mësimi i mëparshëm, kopjet e shtypura të stemës (dy për nxënës), lapsa me ngjyrë, gërshërë.	Punë individuale dhe formimi i grupeve.
Mësimi 3: Kjo është stema jonë e simboleve (stema e simboleve II)	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për potencialin e fuqisë së tyre individuale që ata sjellin në grup. Ata bien dakord për një emër dhe moton e grupit.	Në grupe me nga katër vetë, nxënësit shpjegojnë simbolet e tyre personale për anëtarët e tjerë të grupit. Ata krijojnë një stemë të përbashkët dhe bien dakord për një emër, një moto dhe një simbol të përbashkët për ta. Nxënësit paraqesin emblemat e tyre në klasë.	Kopje të stemës nga mësimi i mëparshëm, lapsa me ngjyrë, ngjitës.	Punë në grup (të katër në këmbë) dhe një prezantim në grup.
Mësimi 4: Individët dhe grupet	Nëpërmjet diskutimit, nxënësit kuptojnë se forcat e tyre individuale kanë potencial brenda një grupi. Ata kuptojnë konceptet e veprimtimit në grup dhe ndarjen e punëve. Ata mund të bëjnë identifikimin e grupeve në shoqëri ku pikat e forta duhet të kombinohen që të jenë të suksesshme.	Nxënësit flasin për pikat e tyre të forta dhe lidhin ato me përvojat e tjera në situatat jashtë shkolle. Në një nga seancat e përbashkëta, ata identifikojnë situata ku aftësitë e ndryshme janë të nevojshme për suksesin e grupit.	Dërrasë e zezë ose tabelë.	Diskusimi plenar.

Mësimi 1**Kjo është ajo që më pëlqen****Unë jam djalë/Unë jam vajzë dhe ndihem mirë me atë që më pëlqen dhe bëj**

Objektivat e mësimi	Nxënësit zbulojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre dhe të të tjerëve. Ata bëhen të vetëdijshtëm për efektet e stereotipave gjinore.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit shkruajnë preferencat e tyre dhe sjelljen në katër kategori. Ata ndajnë përgjigjet e tyre me nxënësit e tjerë dhe reflektojnë për to
Burimet	Letër dhe lapsa, kopje të shtypura e doracakëve ("Më pëlqen të bëj" tabelë).
Metodat	Punë individuale dhe në grup, diskutim plenar.

Përshkrim i mësimi

Mësuesi paraqet temën duke bërë pyetje të tilla si "Cilat aktivitete do t'ju pëlqejnë të bëni?", "Cilat aktivitete nuk ju pëlqen t'i bëni?", "Cilat aktivitete bëhen nga vajzat?" dhe "Cilat aktivitete bëhen nga djemtë?" Mësuesi u jep kohë nxënësve të mendohen rreth përgjigjeve të mundshme dhe më pas pranon përgjigjet e tyre.

Si hap i dytë, mësuesi u jep nxënësve një kopje të fletëve t punës, letër dhe lapsa. Nxënësit duhet të palosin fletën e punës në gjysmë dhe, si fillim, të përdorin vetëm pjesë e sipërme të tij. Mësuesi jep udhëzimet e mëposhtme për nxënësit:

- Shkruani nëse jeni vajzë apo djalë.
- Shkruani pesë gjërat që ju pëlqejnë të bëni.
- Shkruani pesë gjërat që ju i bëni, por nuk dëshironi që t'i kryeni.
- Shkruani pesë gjëra që ju nuk dëshironi t'i kryeni dhe nuk i bëni.
- Shkruani pesë gjëra që ju nuk i bëni, por do dëshironit t'i bëni.

Në vijim, tregoni për çdo gjë që keni shkruar, nëse mendoni se është e pranueshme për seksin tuaj që ta bëjë atë (nëse jeni djalë, janë gjëra që mund të bëhen nga djemtë, nëse jeni vajzë, janë gjëra që mund të bëhen nga vajzat).

Kur nxënësit kanë mbaruar, mësuesi kërkon që ata të kalojnë nëpër klasë dhe të ndajnë përgjigjet e tyre me pesë nxënës të tjerë. Ata regjistrojnë përgjigjet nxënësve të tjerë në pjesën e poshtme të fletës së punës.

Më tej, mësuesi u kërkon nxënësve të ulen në një rreth dhe të diskutojnë së bashku duke përdorur pyetjet e mëposhtme si një pikë fillimi:

- Çfarë mendoni për përgjigjet e shokëve tuaj të klasës? A ishin befasuese?
- Cilat janë gjërat që vetëm ju mund të bëni?
- Cilat nga gjërat që arrijnë shokët e klasës ju bëjnë më tepër përshtypje?
- A vëreni ndonjë ide të përbashkët në gjërat që nxënësit pëlqejnë të bëjnë, por nuk e bëjnë?
- Çfarë ndodh nëse një vajzë bën "gjëra të djemve"? Ose nëse një djalë bën "gjëra të vajzave"?
- Si mendoni se do t'u përgjigjen këtyre pyetjeve anëtarët e familjes suaj?
- Pse ne përgjigjemi në këtë mënyrë? Pse ne mendojmë se disa gjëra janë për t'u bërë vetëm nga vajzat dhe disa janë për t'u bërë vetëm nga djemtë?

Si hap i fundit, lidhni pyetjet me çështje të EQD dhe EDNJ:

- Çfarë ndodh nëse dikush nuk di asgjë në lidhje me gjërat që ju pëlqejnë t'i bëni dhe i bëni?
- Çfarë ndodh nëse dikush nuk i di gjërat që nuk i pëlqen për t'i bërë, por që i bën?
- Kush vendos se çfarë mund të bëjë një vajzë dhe çfarë mund të bëjë një djalë?
- Çfarë ndodh nëse ajo që bëjnë djemtë dhe vajzat është e ndaluar?
- A mendoni se rolet do të qëndrojnë ashtu siç janë? A ka qenë gjithmonë kështu?

Zgjerim: mësimi mund të zgjerohet duke u përqendruar në çështjen e asaj që nxënësit nuk e bëjnë, por që do të donin ta bënin. Mësuesi, së bashku me nxënësit, përpiqet të gjejë zgjidhje se si mund të provohen këto gjëra në kontekstin e klasës.

Mësimi 2

Simbolet e mia personale (stema e simboleve, pjesa I)

Ky jam unë

Objektivat e mësimit	Nxënësit nxisin vetëvlerësimin duke njohur dhe vlerësuar aspektet e tyre pozitive.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit krijojnë simbolet e tyre personale të cilat do të jenë pjesë e një steme simbolike për grupin. Ata pyesin veten rreth perceptimit që kanë për veten dhe përdorin pikat e forta të identifikuar në mësim 1. Nxënësit formojnë grupe si një parakusht për mësimin 3.
Burimet	Tabelat nga mësimi i mëparshëm, kopje të shtypura të stemës (dy për nxënës), stilolapsa me ngjyra, gërshtë.
Metodat	Punë individuale, formimi i grupeve.

Informacion

Në traditën evropiane, një stemë e simboleve, e quajtur një arritje e armaturës, mbajtje e armaturës ose shkurt- armë, është një shenjë që i përket një personi të caktuar (ose grupi njerëzish) dhe përdoret prej tyre në një shumëllojshmëri mënyrash. Historikisht, stemat e simboleve u përdorën nga kalorësit për të mundësuar dallimin e tyre nga ushtarët e armikut. Në Evropë njerëzit e thjeshtë mund t'i përshtatnin simbolet e tyre. Ndryshe nga vula dhe emblemat, stemat e simboleve kanë një përshkrim formal që shprehet si një stemë. Në shekullin e 21-të, stemat e simboleve janë ende në përdorim nga një numër institucionesh dhe individësh (për shembull, disa universitete kanë udhëzime përkatëse se si mund të përdoren simbolet e tyre, me qëllim mbrojtjen nga përdorimi i tyre pa kriter).

Arti i projektimit, shfaqjes, përshkrimit dhe regjistrimit të simboleve quhet *heraldikë*. Përdorimi i stemave të simboleve nga vende, shtete, provinca, qytete dhe fshatra quhet *heraldikë qytetare*.

Përshkrimi i mësimit

1. Mësimi i dytë fillon me formimin e grupeve të nxënësve me nga katër vetë. Rekomandohet që të grupet të formohen duke përdorur një lojë grup-formimi, të tilla si shpërndarja e skedave që përputhen në grupe me nga katër ose fotografi në grupe me nga katër etj. Detyra e nxënësve është që të gjejë partnerët e tyre dhe të formojnë grupin.

2. Pas kësaj, nxënësit duhet të ulen së bashku në grupet e tyre. Çdo njëri prej tyre merr një kopje të printuar të stemës. Një kopje e stemës është vendosur në mes të tabelës. Ka katër seksione në stemë dhe nxënësit duhet të zgjedhin një seksion secili. Ata duhet të shkruajnë emrat e tyre me laps te kopja në mes të tabelës. Në kopjen e tyre, ata duhet të fillojnë prerjen e pjesës personale të stemës së caktuar për ta.

3. Mësuesi u kërkon nxënësve të mendojnë se çfarë simboli personal mund të përdorin ata për të përfaqësuar veten. "Kjo është ajo çka unë jam" duhet të jetë motoja për këtë detyrë. Mesazhi i zgjeruar e kësaj detyre mund të jetë "Kjo është ajo që unë sjell në grup". Për këtë, mësuesi duhet të kërkojë nga nxënësit të nxjerrin tabelat e krijuara në mësimin 1. Ata mund të marrin disa ide nga kolonat "Më pëlqen të bëj dhe bëj" dhe "Unë nuk e bëj, por do të doja ta bëja". Tani, ata duhet të gjejnë simbole që përfaqësojnë tiparet e tyre më të forta për t'i vendosur në seksionin e tyre. Pyetjet e mëposhtme mund të jetë një ndihmë:

- Si e shihni veten tuaj?
- Çfarë ju duhet?
- Çfarë mund të bëni?
- Për çfarë ju vjen keq kur mendoni për jetën tuaj?

Mësimi 3**Kjo është stema jonë e simboleve (stema e simboleve pjesa II)****Ne jemi të fortë si grup, sepse jemi individë**

Objektivat e mësimit	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për potencialin e tyre individual dhe pikat e forta që sjellin në grup. Ata bien dakord për një emër dhe moton për grupin.
Detyrat e nxënësve	Në grupe me nga katër, nxënësit shpjegojnë simbolet e tyre vetjake për anëtarët e tjerë të grupit. Ata krijojnë një stemë të përbashkët të simboleve dhe bien dakord për një emër, një moto dhe një simbol të përbashkët për të. Nxënësit paraqesin stemat e simboleve të tyre para klasës.
Burimet	Kopje të stemës së simboleve nga mësimi i mëparshëm, lapsa me ngjyra, zamkë.
Metodat	Punë në grupe (katër nxënës në grup) dhe prezantimi në grup.

Përshkrimi i mësimit

Në vijim të mësimit 2, nxënësit diskutojnë për simbolet që kanë krijuar dhe diskutojnë mendimet e tyre për to. Mësuesi i kërkon nxënësve të kryejnë detyrat e mëposhtme:

- Shpjegoni simbolin(et) tuaj për anëtarët e grupit;
- Ngjitni të gjitha pjesët e simbolit (simboleve) në stemën tuaj të simboleve;
- Gjeni një simbol të përbashkët për grupin tuaj (në mes), një moto për idetë tuaja (flamuri më i lartë) dhe një emër për grupin tuaj (flamuri i poshtëm).

Mësuesi duhet t'u tregojë nxënësve se vendimet duhet të merren së bashku, në mënyrë që të gjithë të mund të identifikohen me vendimin që kanë marrë.

Stemat e simboleve të përfunduar paraqiten në *seancë plenare* nga një anëtar i grupit dhe shfaqen në mur, së bashku me gjithë të tjerët.

Mësimi 4

Individët dhe grupet

Pikat e forta të individëve si potencial për shoqërinë

Objektivat e mësimimit	Nëpërmjet diskutimit, nxënësit kuptojnë se pikat e tyre të forta individuale më shumë mundësi brenda një grupi. Ata i kuptojnë konceptet e punës në ekip dhe ndarjen e punës. Gjithashtu, ata mund të identifikojnë grupet në shoqëri, ku pikat e ndryshme të forta duhet të jenë të harmonizuara për të qenë të suksesshëm.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit flasin për pikat e tyre të forta dhe e lidhin këtë me situata të tjera jashtë shkollës. Gjatë diskutimit, ata zbulojnë situata ku aftësitë e ndryshme janë të nevojshme për suksesin e grupit.
Burimet	Dërrasë e zezë ose tabelë.
Metodat	Diskutim i përbashkët.

Informacion

Diskutimi (shkëmbim i argumenteve, nga latinishtja, *discussio*, domethënë argument) është një formë e veçantë e komunikimit verbal mes dy ose më shumë personave, në të cilin diskutohet një ose më shumë çështje (d.m.th. duke diskutuar, të dyja palët paraqesin argumentet e tyre. Një diskutim duhet të zhvillohet në frymën e respektit të ndërsjellë. Një stil i mirë i diskutimit kërkon që folësit të lejojnë dhe madje edhe të nxisin shprehjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të tjera, duke i trajtuar ato me kujdes në vend që t'i kundërshtojnë me arrogancë. Cilësitë personale, të tilla si: qetësia, qëndrimi i hijshëm dhe mirësjellja, do të jenë të dobishme për të dy palët. Në rastin më të mirë, një diskutim do të çonte në zgjidhjen e një problemi ose në një kompromis, të pranueshëm nga të gjithë palët e përfshira.

Në shoqëritë moderne, diskutimet janë shprehje e mjeteve qytetare paqësore për menaxhimin e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e konflikteve të interesit dhe objektivave të ndryshme. Kësisoj, konfliktet nuk shtypen, por zgjidhen. Duke mësuar dhe ushtruar aftësitë e tyre për diskutim, nxënësit mësojnë një element bazë për arritjen dhe ruajtjen e paqes në shoqëri.

Përshkrimi i mësimimit

Nxënësit ulen në grupet e tyre me një tabelë përpara.

Atyre u është dhënë detyra për të organizuar një diskutim trehapësh (shih fletën e punës së nxënësve):

- Mendoni për anët e forta që ju nxorët ose shkruat poshtë stemës suaj të simboleve dhe i shkruani të gjitha në tabelë.
- Diskutoni se në cilat situata këto pika të forta mund ta ndihmojnë grupin tuaj. Mendoni për shembuj dhe shkruajini ato.
- Si hap të tretë, mendoni për situatat jashtë shkollës. Ku mund t'ju ndihmojnë pikat e forta dhe aftësitë? Si individ? Brenda një grupi?

Pasi të kenë mbaruar, nxënësit formojnë një *rreth* për të diskutuar rezultatet.

Mësuesi drejton diskutimin në mënyrë të tillë që nxënësit të kuptojnë konceptin e përdorimit të pikave të forta dhe të aftësive të individit si burim *pushteti* brenda një grupi.

KAPITULLI 2

Diversiteti dhe pluralizmi

Arsimi fillor

Në shtëpi, në Evropë

2.1 Çfarë është Evropa?

Çfarë di unë për Evropën ku jetoj?

2.2 Unë jam në shtëpi në Evropë (ndërtimi i një hartë fizike I)

Vendet e Evropës

2.3 Unë jam në shtëpi në Evropë (ndërtimi i një hartë fizike II)

Lumenjtë, male dhe fushat në Evropë

2.4 Evropianët janë të ndryshme dhe të barabartë

Ajo që kemi dhe nuk kemi të përbashkët

Kapitulli 2: Koncepti kyç - "Diversiteti dhe pluralizmi" (për arsimin fillor)

Informacion i zgjeruar për mësuesit: çfarë gjurmësh të Evropës janë të pranishme në jetën e përditshme të nxënësve?

Nxënësit, në këtë nivel i perceptojnë ndryshe nga të rriturit kohën dhe marrëdhëniet hapësinore. Prandaj, kur trajtojmë Evropën si një temë në arsimin bazë, është thelbësore që të gjejmë pikat e përshtatshme për moshën ku mund të zhvillohet një koncept didaktik e mësimit për Evropën. Konceptet e hapësirës dhe marrëdhëniet me të janë të ndryshme me ato të nxënësve në arsimin e mesëm. Njohuritë e para të nxënësve, qëndrimet e tyre aktuale dhe interesat e tyre ndaj Evropës, si dhe mënyrat e ndryshme të mbledhjes së informacionit, duhet të pasqyrohen paraprakisht nga mësuesi. Si mund të mësojnë për Evropën nxënësit e shkollave fillore? Të mos harrojmë këtu një nga pyetjet kyçe të EQD/EDNJ në lidhje me Evropën: cili është Identiteti evropian? EQD/EDNJ nuk është një koncept kombëtar. Ky është një koncept që trajton çështjen si jetojnë njerëzit së bashku në mjedisë të ndryshme: në familje, lagje, klasë, shkollë, rajon, vend dhe më në fund në Evropë.

Kur shikon jetën e nxënësve, bëhet e qartë se, sot, nxënësit e këtij niveli, në jetën e tyre të përditshme rriten bashkë me një dimension ndërkombëtar dhe për kësaj edhe evropian. Nxënësit e përjetojnë këtë në aspektin e ndërkombëtarizmit, e shumëkulturave, e shumëgjuhësisë në kontekste të larmishme:

- ata jetojnë së bashku me fëmijët e popujve dhe kulturave të ndryshme (në kopsht, në shkollë, në zonën ku jetojnë);
- përmes produkteve ndërkombëtare;
- përmes referencave evropiane dhe ndërkombëtare në media, të përdorura nga nxënësit (libra, revista, televizion, CD, Internet etj);
- përmes udhëtimeve.

Shumica e këtyre konteksteve janë marrë të mirëqena nga nxënësit që në moshë të re dhe perceptohen në mënyrë të pandërgjegjshme. Për shembull, nxënësit nuk janë të vetëdijshëm për origjinën e ushqimeve të tilla si spageti, pica dhe kruasantë, pasi ata nuk e kanë përjetuar në mënyrë aktive procesin e ngadalshëm të integritimit të mallrave të konsumit në Evropë. Në të njëjtën kohë, këndvështrimet stereotip dhe të thjeshtëzuara të pjesëve të ndryshme të kontinentit tonë shfaqen vazhdimisht në media. Për nxënësit, këto stereotipa mund të bëhen "njohuri paraprake" për Evropën, përpara se ato, në një farë mënyre, të pranohen si të vërteta. Në të vërtetë, këto janë më shumë qëndrime ose besime subjektive sesa njohuri.

Kështu, nxënësit e kësaj moshe nuk mund të shihen më si një *tabula rasa* në lidhje me Evropën. Ajo çfarë mësimit për Evropën mund të shtojë është dimensionin i klasifikimit, i sistemit, i zgjerimit dhe i vënies në vendin e duhur të ndonjë njohurie të mëparshme. Për këtë arsye, mësime dhe të mësuarit duhet të synojë reflektimin për stereotipat e pranishme, e paragjykimet dhe mendimet, si dhe të përqendrohet në rritjen e ndërgjegjësimit të një shoqërie evropiane shumëkulturës dhe shumëgjuhëse, në vetvete të larmishme, por të barabartë.

Në krahasim me nivelin e mesëm, mësimit dhe të mësuarit në lidhje me Evropën në arsimin bazë duhet të jetë një përvojë e jetuar në mënyrë aktive. Mësimit duhet të përfshijë një qasje shumë mendje hapur, që priret drejt dy dimensioneve disiplinore – objektiviteti, paanshmëria dhe idealja – që përdorin shembuj shumë konkretë nga jeta e përditshme e nxënësve. Për këtë grup moshe, komunikimi i vërtetë dhe miqësia janë dimensionet qendrore didaktike për mësime dhe të mësuarit. Nëse grupi përfshin nxënës që kanë lidhje me migracionin, kjo do të mund të përdoret si një pikë fillimi për mësime dhe të mësuarit për Evropën dhe popullsinë e saj.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky krye ka profilin e mëposhtëm të kompetencës:

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	**	***

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

Hulumtim në biblioteka

Hulumtim në internet

Kryerja e intervistave dhe sondazheve

Interpretimi i imazheve

Harta mendore

Krijimi i afisheve

Organizimi i ekspozitave

Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

Përgatitja e sliderave me projektor ose një prezantim në *PowerPoint*

Shkrim artikujsh gazetash

Organizimi shfaqjeve

Debate të përbashkëta

Kapitulli 2: Diversiteti dhe pluralizmi

Në shtëpi në Evropë

Çfarë gjurmësh të Evropës janë të pranishme në jetën e përditshme të nxënësve?

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Çfarë është Evropa?	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> riaktivizojnë njohuritë dhe zbulojnë pikëpamjet e tyre për Evropën si kontinent. 	Nxënësit punojnë me një hartë të Evropës. Ata tregojnë nga janë, shkruajnë qytetet dhe vendet që njohin, dhe cilët flamuj dhe gjëra të tjera të rëndësishme për këto vende bëjnë pjesë në njohuritë e tyre paraprake etj.	Kopje të shtypura të hartës së Evropës; vende, portrete, stilolapsa, ngjitës, gërshërë, atlas, libra, (nëse është e mundur).	Punë individuale dhe në grup, diskutim në seancë plenare.
Mësimi 2: Unë jam në shtëpi në Evropë (ndërtimi i një harte fizike I)	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> "luajnë" Evropash në sheshin e lojërave të shkollës; zhvillojnë ndjenjën e afërsisë dhe të distancës. 	Nxënësit ndërtojnë një hartë të Evropës në sheshin e lojërave të shkollës. Në fillim skicohen vendet dhe kufijtë. Ata tregojnë nga vijnë.	Harta e Evropës në disa kopje; portrete të vendeve, letër me ngjyrë, atlas.	Punë në çifte dhe në grup.
Mësimi 3: Unë jam në shtëpi në Evropë (ndërtimi i një harte fizike II)	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> bëhen të vetëdijshëm për të gjitha karakteristikat e ndryshme të Evropës si kontinent. fillojnë të kuptojnë konceptin e marrëdhënieve hapësinore, duke parë gjithnjë nga vijnë. 	Pasi kanë skicuar kufijtë dhe vendet, nxënësit vazhdojnë me karakteristikat gjeografike të tokës. Ata vendosin lumenjtë, malet dhe gjëra të tjera të rëndësishme në hartën fizike. Në fund bëhet harta fotografohet.	Harta e Evropës në disa kopje si model ose skicë, material blu për hedhjen e lumenjve (letër, tekstil etj.), material me ngjyrë për shënjimimin e maleve dhe pllajave, fushave (letër, tekstile etj.), atlas, kamera.	Punë në çifte dhe në grup.
Mësimi 4: Evropianët janë të ndryshëm dhe të barabartë	Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> nxënësit kuptojnë se Evropa ka një shumëllojshmëri karakteristikash. reflektojnë për faktin se evropianët kanë disa gjëra të përbashkëta, duke qenë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. 	Nxënësit shikojnë foton e hartës fizike. Mësuesi i përfshin ata në diskutim për ngjashmëritë dhe dallimet në: a) në kontekstin gjeografik dhe b) në kontekst social. Nxënësit diskutojnë dallimet sociale në Evropë dhe përpiqen të gjejnë zgjidhje për dialogun dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.	Foto të hartës fizike, vende, portrete, dërrasë e zezë ose tabelë, fije letre.	Diskutim plenar, punë në grupit.

Mësimi 1

Çfarë është Evropa?

Çfarë unë di për Evropën

Objektivat e mësimimit	Nxënësit ri-aktivizojnë njohuritë e tyre në lidhje me Evropën dhe zbulojnë pikëpamjet e tyre për kontinentin.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit punojnë me një hartë të Evropës. Ata tregojnë nga vijnë, shkruajnë çfarë qytetesh njohin, cilat vende janë të njohura për ta dhe të cilët flamuj e gjëra të tjera të rëndësishme dinë etj.
Burimet	Disa kopje të hartës së Evropës, portrete, vende, lapsa, ngjitës, gërshërë, atlas, libra, internet (nëse është i mundur).
Metodat	Punë individuale, diskutim plenar.

Përshkrim i mësimimit

Nxënësve u shpërndahen kopje të një harte memece të Evropës (mundësisht në formatin A3). Detyra e tyre është që të ri-aktivizojnë ato që dinë për Evropën. Ata fillojnë të punojnë me pyetjet e ndryshme të listuara nën hartë.

Mësuesi paraqet paketën e informacionit që ndodhet në pjesën e fletëve të punës së nxënësve (shtete dhe kryeqytete, flamuj, lumenj, male, pllaja e fusha). Nxënësit do të punojnë me këtë material, por gjithashtu mund të përdorin burime të tjera informacioni, që janë në dispozicion të tyre në klasë (në Internet, atlas, libra etj.).

Hartat e përfunduara të Evropës varen në mur.

Si detyrë shtëpie, nxënësit zgjedhin një vend evropian për të cilin duhet të kërkojnë informacion në shtëpi. Ata plotësojnë "Portrete Vendesh" në mësimin 2. Gjithashtu ata gjejnë një partner me të cilin mund të punojnë së bashku në mësimin e ardhshëm, i cili do të ishte mirë të zgjidhte një vend fqinj me atë që kanë zgjedhur vetë.

Mësimi 2

Unë jam në shtëpi në Evropë (ndërtimi i një hartë fizike I) Çfarë unë di për Evropën

Objektivat e mësimi	Nxënësit "luajnë" Evropash në oborin e shkollës. Ata zhvillojnë një ndjenjë afërsie dhe distance.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit ndërtojnë një hartë të Evropës në oborin e shkollës. Ata punojnë në çifte duke bërë kërkime në dy vende që i zgjedhin vetë. Ata e nisin punën me hedhjen e kufijve në këto vende, duke treguar se nga vijnë.
Burimet	Harta e Evropës shtypur në disa kopje si model ose shabllon, portrete të vendeve, letër me ngjyrë, atlas.
Metodat	Punë në çifte dhe në grup.

Informacion

Termi "hartë fizike" përdoret në dy kuptime të ndryshme. Së pari, një hartë fizike, në kontekstin e hartografisë, përshkruan një hartë e cila tregon shenja të dallueshme, si: male, fusha, pllaja, lumenj, liqene, oqeanë dhe karakteristika të tjera të përherëshme gjeografike. Së dyti, termi hartë fizike përdoret edhe në kontekstin e gjenetikës. Në këtë kontekst ajo përshkruan se sa është sasia e ADN që ndan dy gjene dhe matet në çifte bazë, në krahasim me një hartë gjenetike.

Në kuptimin e mësimave për Evropën ne e përdorim termin "hartë fizike" në kuptimin hartografik, por edhe në një kuptim shumë aktiv - pasi nxënësit "luajnë hartash" vetë. Vetëm në këtë mënyrë, nxënësit do të mund të kuptojnë marrëdhëniet e vështira hapësinore, konceptin e kufijve, gjatësinë e lumenjve dhe lartësitë e maleve. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë aspektet sociale të jetesës së përbashkët në kontinentin evropian. Në të vërtetë, duke i ndërtuar dhe më pas duke qëndruar në vendet e tjera, nxënësit, në kuptimin fizik, perceptojnë fqinjët e tyre dhe kufijtë e pengesat të tilla, si: gjuhët e huaja, kulturën dhe të dhëna të tjera plotësuese. Koncepti i ndërtimit të një harte fizike lidhet edhe me aspektet e të mësuarit duke bërë dhe me përvoja konkrete.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit punojnë në çifte për të dy vendet për të cilat kanë bërë kërkime në shtëpi (detyrë e marrë në fund të orës I). Ata sjellin në mësim pamje të vendeve dhe të gjithë informacionin që kanë mbledhur për to. Ata sjellin dhe hartat e përgatitura të Evropës.

E tërë klasa mbledhet në oborin e shkollës. Mësuesi udhëzon nxënësit të ndërtojnë një hartë fizike të Evropës, duke përdorur lloje të ndryshme të materialeve në dispozicion. Dy nxënës punojnë për një vend.

Mësuesi përcakton zonën në të cilën nxënësit mund të punojnë.

Më pas, nxënësit fillojnë hedhjen e kufijve të vendeve. Ata duhet ta bëjnë kujdes që vendet pranë njëri-tjetrit të jenë ata të duhurit. Pastaj ata mund të tregojnë kryeqytetet dhe flamujt e tyre.

Pasi kanë bërë këtë, secili nxënës duhet të qëndrojë në vendin e vet dhe të fillojë dialogun me nxënësin në vendin fqinj. Ata duhet të shkëmbejnë informacion në lidhje me vendet e njëri-tjetrit. Këtu nxënësit ndeshen me pengesat e padukshme, të tilla si nevoja për të folur në gjuhë të huaj. Si rezultat i portretit të vendit të plotësuar nga nxënësit, nxënësve u krijohet mundësia të shkëmbejnë disa fjalë me fqinjin në gjuhën e vendit që ai "përfaqëson". Pjesa tjetër e dialogut mund të zhvillohet në gjuhën e tyre amtare. Nxënësit duhet të përpiqen që të dialogojnë sa më shumë që të jetë e mundur me shokët e klasës në "vendet" fqinje.

Mësimi 3

Unë jam në shtëpi në Evropë (ndërtimi i një hartë fizike II)

Lumenj, male dhe fusha në Evropë

Objektivat e mëimit	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për të gjitha karakteristikat e ndryshme të Evropës si kontinent. Ata fillojnë të kuptojnë konceptin e marrëdhënieve hapësinore duke parë se nga vijnë.
Detyrat e nxënësve	Harta e Evropës është shtypur në disa kopje si hartë memece, materiale blu për hedhjen e lumenjve (letër, tekstile etj.), materiale me ngjyrë për hedhjen e maleve, si dhe fushave e pllajave (letër, tekstile etj.); atlas, aparat fotografik.
Burimet	Dërrasë e zezë ose tabelë.
Metodat	Punë në çifte dhe në grup.

Përshkrimi i mëimit

Pasi janë hedhur kufijtë e vendit dhe shënohen kryeqytetet dhe flamujt, nxënësit vazhdojnë të punojnë me lumenjtë, fushat dhe malet. Jo të gjithë nxënësit do të jenë të zënë me punë, sepse jo të gjitha vendet do të kenë lumenj të mëdhenj dhe terren të ngarkuar. Mësuesi mundet t'i caktojë këta nxënës në grupe të reja ose t'i caktojë ata që kanë përfunduar tashmë me “vendin e tyre” në një grup tjetër.

Nxënësit duhet të përdorin materiale të ndryshme si tekstile, letër etj., për të dhënë shtrirjen e lumenjve, fushave dhe pllajave.

Nxënësit mund të shtojnë edhe gjëra të tjera për hartën fizike, por kjo duhet të jetë vullnetare. Nxënësit vetë duhet të vendosin nëse janë apo jo të gatshëm për ta bërë këtë; Kjo varet edhe nga informacionet që kanë mbledhur gjatë hulumtimit të “vendit të tyre” (për ushqimin, njerëzit e famshëm etj.).

Pasi të ketë përfunduar, harta fotografohet. Është mirë që harta të fotografohet dy herë. Një herë me nxënësit në këmbë, në “vendet e tyre”, dhe një herë pa nxënësit, me qëllim që të shihen qartë të gjithë elementet e tokës, lumenjtë fushat etj.

Mësimi 4

Evropianët janë të ndryshëm dhe të barabartë

Ajo që kemi dhe nuk kemi të përbashkët

Objektivat e mësimi	Nxënësit kuptojnë se Evropa ka një shumëllojshmëri karakteristikash. Ata thellohen në faktin se evropianët kanë disa gjëra të përbashkëta, por janë edhe shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit shikojnë një foto të hartës fizike. Mësuesi angazhohet në një diskutim në lidhje me ngjashmëritë dhe dallimet në: a) një kontekst gjeografik dhe b) një kontekst social. Nxënësit diskutojnë rreth dallimeve sociale në Evropë dhe përpiqen të gjejnë zgjidhje për dialogun dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.
Burimet	Foto e hartës fizike, pamje të vendit, dërrasë e zezë, tabelë, letra ngjitëse.
Metodat	Diskusim i përbashkët, punë në grup.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit formojnë një rreth. Mësuesi paraqet fotot e hartës fizike. Detyra e nxënësve është të shohin fotot dhe të mendojnë për ngjashmëritë e dallimet në hartë.

Ata duhet t'i përgjigjen pyetjeve të tilla si:

- Cilat pjesë të Evropës kanë male të larta?
- Ku janë lumenjtë më të gjatë?
- Cilat vende kanë pllaja e fusha të ngjashme?
- Në cilat vende njerëzit flasin të njëjtën gjuhë?
- Cilat vende ndajnë një det?

Nxënësit përdorin pamjet e vendit për të marrë informacion. Ata paraqesin vendin që "përfaqësojnë" në formën e një prezantimi ose në formën e një shfaqjeje..

Si hap të dytë, mësuesi paraqet një seri pyetjesh të tjera për të filluar një diskutim të ri. Përveç ngjashmërive e ndryshimeve natyrore dhe gjeografike, vihen në dukje edhe ndryshime të tjera në Evropë, të tilla si dallimet sociale ose dukuri të tilla si paragjykimi. Mësuesi i motivon nxënësit për të shprehur mendimet e tyre rreth dallimeve sociale në Evropë, duke shtruar pyetje të tilla si:

- A ka vende të pasura dhe të varfra në Evropë? Cilat janë të pasura? Cilat janë të varfra?
- A është jeta më e vështirë në disa vende të Evropës se sa në të tjerat? Pse?
- Pse shumë njerëz e lënë vendin e tyre për të jetuar diku tjetër? Cilat janë arsytet?

Pasi ka grumbulluar mendimet e nxënësve në lidhje me këto ngjashmëri dhe me ndryshimet gjeografike, nxënësit duhet të ulen së bashku në grupe me nga katër vetë dhe të dalin me ide si të kuptojmë më mirë dallimet sociale në Evropë, pa mohuar identitetet kombëtare, duke nxitur madje edhe dialogun ndërkulturor. Nxënësit shkruajnë idetë e tyre në letra të vogla ngjitëse dhe i paraqesin ato para klasës. Pastaj ngjisin letrat pranë fotove të hartës fizike (kjo ndihmon edhe anën pamore).

KAPITULLI 3
BARAZIA
Arsimi fillor

Pakicat dhe shumicat

3.1 Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë

Ne pranojmë njëri-tjetrin në një grup

3.2 A është e drejtë?

Pakicat dhe shumicat në oborrin e shkollës (hulumtim)

3.3 A është e drejtë?

Pakicat dhe shumicat në oborrin e shkollës (vazhdim)

3.4 Një matricë e pushtetit

Pakicat dhe shumicat në vendin tonë

Kapitulli 3: Koncept kyç - "Barazia" (për arsimin fillor)

Informacion i zgjeruar për mësuesit: si të rritet ndërgjegjësimi në lidhje me pakicat dhe shumicat në jetën e përditshme të nxënësve në fillore

Shprehja "Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë" është shumë e njohur në Evropë. Ajo pasqyron një nga vlerat thelbësore të EQD/EDNJ, që mund të shprehet si vijon: "Me disa njerëz unë kam shumë gjëra të përbashkëta, ndërsa me të tjerë kam shumë pak. Edhe pse unë kam shumë gjëra të përbashkëta me ta, kam shumë të tjera që i kam të ndryshme. Disa elemente të personalitetit tim i përkasin shumicës, të tjerët i përkasin një pakice." Për rritjen e vetëdijes në lidhje me pakicat dhe shumicat në nivelin fillor, është e nevojshme të sqarohen termat që përdorim. Në përgjithësi, një pakicë është një grup brenda një vendi, që dallohet nga shumica për arsye të tipareve personale ose kulturore. Në shumicën e rasteve, një pakicë jeton si një grup demografik në një njësi të caktuar territoriale (për shembull, një rajon), por ai mund të të jetë gjithashtu i shpërndarë në tërë vendin ose përgjatë kufijve të një vendi. Karakteristikat e ndryshme të minoriteteve shpesh janë gjuha, përkatësia etnike ose feja, por ndonjëherë ata dallohen edhe nga qëndrimet morale, identiteti seksual ose statusi social.

Në përgjithësi, termi *pakicë* përdoret kur një grup është i dominuar nga një grup më i madh, por nuk asimilohet në atë grup. Prandaj, në përgjithësi, pakicat përshkruhen si pakica etnike ose kombëtare. Këshilli i Evropës, Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare kanë miratuar ligje për të drejtat e minoriteteve. Këto të drejta respektohen në shkallë të ndryshme. Këshilli i Evropës ka dy instrumente detyruese: Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (ETS Nr 157, të miratuar në vitin 1995) dhe Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (ETS Nr 148, të miratuar në vitin 1992).

Në vitin 1992, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi edhe Deklaratën për të Drejtat e Personave që i Përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore. Në vitin 1988, është themeluar në Tokio, Lëvizja Ndërkombëtare kundër të Gjitha Formave të Diskriminimit dhe Racizmit (IMADR), e cila provoi të zhvendoste vëmendjen rreth problemeve të racizmit dhe diskriminimit kundër pakicave. Avokatët e IMADR mbrojnë të drejtat e grupeve të paprivileguara.

Në shumicën e rasteve, termi *pakicë* i referohet një grupi njerëzish që kanë tiparet e mëposhtme:

- Të qenit i vogël në madhësi në krahasim me popullsinë e përgjithshme të një shteti;
- Status jo-dominues në vend;
- Karakteristika të përbashkëta të tilla, si: etnia, feja ose gjuha;
- Ekzistenca e një ndjenje solidariteti ose identiteti që bazohet në të perceptuarit të vetes si pakicë.

Të kategorizosh pakicat nuk është e lehtë. Megjithatë, kategoritë që përdoren më shpesh janë:

- Minoritete kombëtare ose etnike: grupet e njerëzve që jetojnë në territorin e një shteti, i cili dominohet nga një grup popullsie i ndryshëm me ta.
- Minoritete gjuhësore: një grup njerëzish që flasin një gjuhë të ndryshme nga shumica e njerëzve në atë vend.
- Pakicat fetare: ata që janë me një fe të ndryshme nga shumica e njerëzve në vend, të tilla si: protestantët në Irlandë, të krishterët në Arabinë Saudite, myslimanët në Danimarkë, Gjermani etj.
- Pakicat seksuale.
- Minoriteti i njerëzve të moshuar.
- Minoriteti i njerëzve të rinj.

Në arsimin fillor, trajtimi dhe kuptimi nga nxënësit, që në fillim të punës, i koncepteve të tilla si *pakicë e shumicë* është shumë i rëndësishëm. Vetëm pas kësaj mund të analizohen funksioni dhe statusi i pakicës ose shumicës. Koncepti i minoriteteve nuk është diçka e panjohur në jetën e përditshme të nxënësve, pasi ata shpesh përjetojnë "përkatësinë" ose "mos-përkatësinë" në një pakicë.

Përkufizimi i minoritetit në këtë rrethanë i referohet përbërjes së popullsisë së shkollës. Për këtë arsye, mësimet në vijim fillojnë me jetën e përditshme të nxënësve dhe përvojat e tyre me pakicat dhe shumicat (mësimet 1-3). Në një hap të dytë, mësimet lidhen me shumicat dhe pakicat në shoqëri dhe me identifikimin e grupeve të ndryshme (mësimi 4). Shkalla e analizës së statusit të grupeve shoqërore varen nga thellësia e diskutimit, motivimi i nxënësve dhe arritjet e përgjithshme akademike të klasës. Jo të gjitha minoritetet janë të paprivileguara. Disa grupe të vogla në shoqëritë tona janë shumë dominuese për disa arsye. Është detyra e mësuesit të nxisë procesin e debatit.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e kompetencës së mëposhtme:

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
*** **	**	**

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

0 Hulumtim në biblioteka

0 Hulumtim në internet

x Kryerja e intervistave dhe sondazheve

0 Interpretimi i imazheve

x Harta mendore

0 Krijimi i posterave

0 Organizimi ekspozitave

0 Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

0 Përgatitja e sliderave me projektor ose një prezantim në *PowerPoint*

0 Shkrimi i artikujve në gazetash

0 Organizimi i një shfaqjeje

0 Debate të përbashkëta

Kapitulli 3: Barazia -Pakicat dhe shumicat

Si mund të rritim vetëdijen e nxënësve të arsimit fillor për pakicat dhe shumicat në jetën e përditshme?

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë	Nxënësit mësojnë të njohin dhe të pranojnë njeri tjetrin si pjesë e një grupi. Ata zbulojnë se çfarë kanë të përbashkët dhe për të cilat nuk ishin të ndërgjegjshëm më parë. Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për qëndrimet dhe praktikatat në lidhje me këto ndryshime.	Nxënësve u janë paraqitur një nga një numër karakteristikash. Ata duhet të vendosin nëse e kanë apo jo secilën prej këtyre karakteristikave. Pasi kanë përcaktuar karakteristikat e tyre dhe të shokëve, ata diskutojnë çështjet në lidhje me barazinë.	Një copë shkumës ose fill spangoje për të bërë vija në terren.	Punë në grup, diskutim plenar.
Mësimi 2: A është e drejtë? (hulumtim)	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për situatën në shkollën e tyre duke vëzhguar nxënësit e tjerë në kohën e pushimit.	Nxënësit e kryejnë hulumtimin në sheshin e lojërave në shkollë duke numëruar nxënësit pjesëmarrës në veprimtari të ndryshme. Ata shënojnë të dhënat dhe zhvillojnë biseda me nxënësit që nuk janë të përfshirë në ndonjë veprimtari.	Një kopje me tabela për mbajtjen e shënimeve në sheshin e lojërave në shkollë, lapsa.	Punë në grupe me nga katër vetë.
Mësimi 3: A është e drejtë? (vazhdim)	Nxënësit reflektojnë për të dhënat që kanë mbledhur duke analizuar dhe interpretuar intervistat. Ata arrijnë në një përfundim të caktuar për pakicat dhe shumicat në shkollën e tyre.	Pasi kanë mbledhur të gjitha të dhënat sasiore he cilësore, nxënësit analizojnë dhe interpretojnë rezultatet. Ata punojnë me statistikën dhe paraqesin rezultatet para shokëve të klasës.	Shënimet nga mësimi 2, kopje e tabelës së statistikave, lapsa me ngjyrë, postera, zamkë.	Punë me grupe me nga katër vetë, prezantim.
Mësimi 4: Një matricë e pushtetit	Nxënësit kuptojnë se ndodhen disa pakica dhe shumica në vend. Ata kuptojnë se ndjenja e përjashtimit mund të jetë rezultat jo vetëm i veprimit sesa anëtarët e shoqërisë ju shohin ju, por edhe rezultat i mënyrës se si të shohin ty edhe anëtarët e grupit tënd.	Nxënësve iu paraqiten karta të ndryshme që tregojnë grupet brenda një shoqërie - me disa grupe që i përkasin një pakice dhe disa shumicës. Ata i ndajnë kartat sipas asaj që mendojnë nëse grupet i përkasin një pakice apo shumicës. Ata caktojnë kartat e fuqisë (fuqi e ulët ose fuqi e lartë) për grupet. Në një <i>seancë plenare</i> , diskutohet se çfarë efekti mund të ketë përkatësia në shumicë apo në pakicë.	Kartat me fjalë dhe kartat e fuqisë.	Diskutim plenar.

Mësimi 1

Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë Ne pranojmë njëri-tjetrin në një grup

Objektivat e mësimi	Nxënësit mësojnë të njohin dhe të pranojnë njëri-tjetrin si pjesë e një grupi. Nxënësit zbulojnë çfarë kanë të përbashkët dhe të cilën nuk kishin dijeni më parë. Ata bëhen të vetëdijshëm për qëndrimet dhe praktikatat lidhur me ndryshimet.
Detyrat e nxënësve	Nxënësve iu paraqiten një seri karakteristikash një nga një. Ata duhet të vendosin nëse ata kanë ose ndonjë nga këto karakteristika. Pasi kanë vërejtur karakteristikat e tyre dhe ato të shokëve diskutojnë çështje që lidhen me barazinë.
Burimet	Një shkumës ose spango për vizatimin e vijës në tokë.
Metodat	Puna në grupe, diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Mësuesi vizaton një vijë në dysheme në mes të klasës ose shtrin një fill spango në të. Hapësira në të dyja anët e vijës, përgjatë saj duhet të jetë e mjaftueshme për qëndrimin e nxënësve.

Mësuesi u kërkon të gjithë nxënësve që të qëndrojnë në njërin anë të vijës (të gjithë në të njëjtën anë).

Mësuesi përmend, një nga një, disa karakteristika. Sa përmendet një karakteristikë, nxënësit duhet të vendosë shpejt nëse kjo vlen për ta. Ata që pranojnë se e kanë atë karakteristikë duhet të kalojnë në anën tjetër të vijës. Pasi të kenë kapërcyer vijën, nxënësit shohin përreth për të parë se kush tjetër ka bërë të njëjtën gjë.

Më poshtë janë disa shembuj karakteristikash që mësuesi mund t'i përmendë. Nxënësit që:

- kanë veshur xhinse;
- kanë sy blu;
- kanë vizituar vende të tjera në Evropë;
- lexojnë rregullisht një gazetë;
- kanë ngrënë mëngjesin sot;
- kanë një motër ose vëlla;
- u pëlqen të shikojnë televizion;
- u pëlqen të luajnë futboll.

Tani, nxënësve mund t'u kërkohej të sugjerojnë karakteristika, por mësuesi duhet të jetë i vëmendshëm dhe të reagojë ndaj karakteristikave të ndjeshme.

Pasi loja të ketë arritur qëllimin e saj, nxënësit ftohen të formojnë një rreth dhe të diskutojnë për çështjet e mëposhtme:

- A e gjetën veten në një grup me dikë me të cilin mendonit se nuk kishit asgjë të përbashkët?
- Si ndiheni teksa jeni pjesë e një grupi të madh?
- Si ndiheni që jeni vetëm?

Variacion:

Sa po të jetë përmendur një karakteristikë, nxënësit shkojnë të formojnë një grup me ata që kanë karakteristika të njëjta. Ata qëndrojnë së bashku për të diskutuar për të përbashkëtat. Diskutimet e tyre mund të lidhen, për shembull, me preferencat dhe sjelljen.

Mësimi 2

A është e drejtë? (hulumtim)

Pakicat dhe shumicat në oborrin e shkollës

Objektivat e mësimimit	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për situatën në shkollën e tyre duke vëzhguar nxënësit e tjerë në kohën e pushimit.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit kryejnë hulumtime në oborrin e shkollë duke numëruar nxënësit pjesëmarrës në veprimtari të ndryshme. Ata shënojnë rezultatet dhe zhvillojnë biseda me nxënësit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndonjë veprimtari.
Burimet	Një kopje të tabelës për të marrë shënime në oborrin e shkollës, lapsa.
Metodat	Grupe me nga katër vetë.

Informacion

Hulumtimi sasior dhe cilësor në arsimin fillor

Metodat sasiore të mbledhjes së të dhënave - *statistikat* - mësohen për disa arsye: janë të dobishme për jetën e përditshme, luajnë një rol të rëndësishëm në lëndë të tjera dhe nxisin arsyetimin kritik kur përdorin të dhëna reale.

Mësimi i statistikës në shkollën fillore, zakonisht, bëhet përmes shkencave natyrore ose si pjesë e programit të lëndës së matematikës. Në shumë raste, në shkollën fillore, mësimi metodat sasiore të grumbullimit të dhënave mbetet në nivelin e një mjeti ndihmës dhe shumë rrallë përfshin analizimin dhe interpretimin e të dhënave të grumbulluara. Për të nxitur proceset e të menduarit kritik dhe të arsyetimit, mësimi i metodave sasiore nuk duhet të ndalet deri në prezantimin e rezultateve me anë të grafikëve ose diagrameve. Është e rëndësishme të përqendrohemi në lidhjen e metodave të marrjes së të dhënave me ato çfarë kanë qenë zbuluar më parë, dhe në interpretimin e rezultateve.

Shtimi i hulumtimeve cilësore i ndihmon nxënësit të fitojnë më shumë njohuri për atë që i shkakton të dhënat e regjistruara dhe për çfarë qëndron në themel të tyre. Në këtë kontekst, sugjerohet që nxënësit të lejohen të dalin me ide të tyre për pyetjet e intervistës. Duke bërë këtë, në një farë mënyre, nxënësit zhvillojnë kuptimin e vërtetë të çështjeve që janë duke u hetuar. Në dy mësimet e më pasme, elementet kryesore janë përdorimi i të dhënave reale nga jeta e përditshme e nxënësve dhe interpretimi i rezultateve prej tyre.

Përshkrimi i mësimimit

Mësuesi e ndan klasën në grupe me nga katër vetë. Për hulumtimet e tyre, secili grup do të fokusohet në një aspekt të asaj që po ndodh në oborrin e shkollës në kohë e pushimit.

Shembuj të aspekteve për hulumtime:

- numri i djemve dhe vajzave të angazhuara në veprimtari;
- veprimtaritë sportive që po ndodhin;
- lojërat e tjera që po luhen;
- temat që diskutohen;
- veprimtaritë e ndryshme të nxënësve të rinj dhe të vjetër.

Secilit grup do t'i caktohet një aspekt i hulumtimit për të gjetur të dhëna rreth *pakicave* dhe *shumicave* në shkollën e tyre. Grupi duhet të formulojë temën kërkimore ku dëshiron të përqendrohet. Nxënësit shkruajnë pyetjen e tyre kryesore në kopjen e shtypur të tabelës së hulumtimit.

Shembuj të pyetjeve:

- "Sa djem dhe vajza janë të përfshirë në veprimtaritë gjatë pushimit?"
- "Çfarë lloje veprimtarish sportive luhen në kohën e pushimit dhe nga kush?"

Përveç kësaj, nxënësit duhet të formulojnë një grup prej jo më shumë se pesë pyetjesh, në lidhje me temën e kërkimit që dëshirojnë të zhvillojnë ndaj nxënësve të tjerë në oborrin e shkollës.

Shembuj:

- "Pse mendoni se ka më shumë djem/vajza që zhvillojnë këtë veprimtari?"
- "Pse mendoni se ka më pak djem/vajza që e luajnë këtë lojë?"
- "Çfarë do të dëshironit të ndryshonit?"

Gjatë pushimit të gjatë, nxënësit shkojnë në oborrin e shkollës dhe vijnë kërkimin në grupe. Në varësi të nivelit organizativ të klasës, puna mund të ndahet edhe brenda grupit (dy prej anëtarëve marrin të dhëna për rezultatet sasiore, ndërsa dy të tjerë parashtrojnë pyetjet cilësore dhe mbajnë shënime).

Pasi të ketë përfunduar kërkimi, nxënësit kthehen në klasat e tyre dhe diskutojnë për rezultatet e tyre brenda grupeve. Cila është përshtypja e tyre e përgjithshme? A kanë rezultate të ngjashme?

Mësimi 3

A është e drejtë? (vazhdim)

Pakicat dhe shumicat në oborrin e shkollës

Objektivat e mësimi	Nxënësit reflektojnë për të dhënat që janë mbledhur dhe analizojnë e interpretojnë intervistat. Ata arrijnë në një përfundim të caktuar për pakicat dhe shumicat në shkollën e tyre.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit analizojnë të gjitha të dhënat sasiore dhe cilësore dhe interpretojnë rezultatet. Ata punojnë me statistikave dhe i paraqesin rezultatet e tyre para shokëve në klasë.
Burimet	Shënimet nga mësimi 2, kopjet e tabelave të statistikave, lapsa me ngjyrë, postera, zamkë.
Metodat	Punë me grupet me nga katër vetë, prezantim.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit ulen së bashku në grupet e tyre dhe shohin me kujdes shënimet nga mësimi i mëparshëm.


Ata diskutojnë se si do të paraqesin rezultatet e hulumtimit të tyre. Mësuesi u jep nxënësve një tabak të madh letre, të cilin nxënësit do ta përdorin për të bërë një poster.

Grupet pastaj punojnë për prezantimin e rezultateve të tyre. Këto rezultate duhet të ndahen në tri

pjesë të mëdha në poster:

- rezultatet sasiore (pasqyrë statistikore);
- rezultatet cilësore (rezultatet nga intervistat);
- interpretimet dhe zgjidhjet e mundshme.

Tabela në vijim tregon një paraqitje të mundshme të posterit:

Pyetja hulumtuese:
1. Statistikat

2. Çfarë mendojnë nxënësit?
- <i>Është e padrejtë që ...</i>
- <i>Unë mendoj se ne duhet të ...</i>
-
3. Çfarë do të thotë kjo?
- <i>Më shumë hapësirë për sport?</i>
- <i>Futboll edhe për vajzat?</i>
-

Ndërsa nxënësit punojnë në posterat e tyre, mësuesi ecën nëpër klasë dhe ofron sugjerime për pyetjet e veçanta ose për rezultatet.

Pasi të kenë përfunduar punën, secilit grup i jepen pesë minuta për të paraqitur posterin e tyre. Të gjithë posterat duhet të afishohen pastaj në shkollë, në një vend ku mund të shihen edhe nga nxënës të tjerë.

Variacion:

Interpretimet dhe zgjedhjet e nxënësve mund të jenë objekt i një diskutimi të mëtejshëm rreth hulumtimit dhe pasojave të mundshme që mund të lindin prej tij, jo vetëm për klasën, por edhe për të gjithë shkollën. Prezantimi në këshillin nxënësve ose në takimin me mësuesit mund të çojë në ndryshime të situatës së *pakicave/shumicave* në shkollë.

Mësimi 4

Një matricë e pushtetit

Pakicat dhe shumicat në vendin tonë

Objektivat e mësimit	Nxënësit kuptojnë se në vend ekzistojnë disa pakica dhe disa shumica. Ata kuptojnë ndjenja e përjashtimit mund të jetë rezultat jo vetëm i mënyrës si ju shohin anëtarët e shoqërisë, por edhe se si të shohin anëtarët e grupit tënd.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit prezantohen me karta të ndryshme që tregojnë grupet brenda një shoqërie - me disa grupe që i përkasin një pakice dhe disa shumicës. Ata ndajnë kartat sipas mendimit të tyre, nëse ata i përkasin një pakice apo shumice. Ata caktojnë kartat e pushtetit për grupet (pushtet i ulët ose pushtet i lartë). Në një <i>seancë plenare</i> , ata diskutojnë se çfarë pasojë ka përkatësia në shumicë apo në pakicë.
Burimet	Kartat fjalësh dhe kartat e fuqisë.
Metodat	Diskutim plenar

Përshkrimi i mësimit

Nxënësit ulen në një rreth. Duhet bërë kujdes që të gjithë nxënësit të mund të shohin në mes të rrethit.

Mësuesi vendos, në dyshemenë në mes të rrethit, setin e kartave me emra të grupeve të ndryshme brenda shoqërisë. Disa nga grupet duhet t'i përkasin *pakicave* dhe disa *shumicave*.

Shënim:

Është e rëndësishme të mbahet parasysh që jo të gjitha grupet e pakicave kanë pak pushtet në shoqëri!

Shembuj:

- fëmijët;
- njerëzit me aftësi të kufizuara;
- politikanët;
- njerëzit me ngjyrë të ndryshme të lëkurës;
- lojtarët;
- grindavecët;
- njerëzit shumë fetarë, që e tregojnë fenë e tyre me veshje të ndryshme;
- priftërinjtë dhe murgeshat;
- njerëzit e moshuar;
- pakica si: Romët, Egjiptianët, Arumunët etj.;
- menaxherët;
- punëtorët;
- shtëpiaket;
- mjekët;
- meshkujt;
- femrat.

Nxënësit duhet të shikojnë skeda të ndryshme. Pastaj, secili të marrë një skedë dhe, pa thënë gjë, duke u bazuar në njohuritë e tij, të klasifikojë grupin që shënohet në kartë si pakicë apo si shumicë. Ky duhet të jetë *hapi i parë* në fillimin e një "matrice të pushtetit". Vetëm një nxënës duhet të ngrihet, në një kohë të dhënë, dhe të marrë një skedë.

Më tej, matrica do të vazhdojë duke iu caktuar skeda pushteti pakicave dhe shumicave të ndryshme. Kjo do të jetë interesante për nxënësit, pasi ata do të zbulojnë se edhe pakicat mund të jenë shumë të pushtetshme në një shoqëri.

Pushteti	Pakica	Shumica
Pushtet shumë i lartë		
Pushtet i lartë		
Pushtet i mesëm		
Pushtet i pakët		
Pa pushtet		

Pasi të ketë përfunduar matrica, nxënësit diskutojnë pasojat që mund të ketë niveli i ndryshëm i pushtetit. Mësuesi drejton diskutimin, duke marrë parasysh me ndjeshmëri të lartë edhe qëndrimet e mëparshme ose idetë fikse të nxënësve .

KAPITULLI 4

KONFLIKTET Arsimi fillor

Rregulla që ndihmojnë për të zgjidhur konfliktet

4.1 Çdo gjë është në rregull! Vërtet?

Çfarë problemesh ose konfliktesh mund të vërejmë në klasën tonë?

4.2 Kjo është mënyra si e bëjmë ne

Çfarë zgjidhje na duhen për problemet?

4.3 Një listë me ide

Cilat prej zgjidhjeve parapëlqen shumica?

4.4 Kontrata jonë e rregullave

Si i shkruajmë ne rregullat e përbashkëta?

Kapitulli 4: Koncepti kyç - "Konfliktet" (për arsimin fillor)

Informacion për mësuesit: Zgjidhja e konflikteve në nivelin e shkollën fillore

Jeta e përditshme në shkollën fillore na jep shumë shembuj të situatave konfliktuale. Shumica e konflikteve bazohen në qëndrimet e përgjithshme të nxënësve ose në paaftësinë e tyre për të përballuar presionin. Shembuj të situatave konfliktuale janë:

- marrje ose fshehje e gjërave të dikujt;
- shtyrje ose prekje pa dashje;
- lojëra nervash me njëri-tjetrin;
- nuk i lë të qetë shokët e tjerë të klasës;
- ngacmime të ndërsjella;
- forma të rënda ngacmimesh si rrahje ose dhunë/abuzim emocional. fizik.

Nxënësit në këtë moshë, për zgjidhjen e konflikteve, përdorin strategji të ndryshme nga ato që përdorin të rriturit. Strategjitë ndryshojnë në varësi të moshës së nxënësve të shkollave fillore. Më të vegjlit kanë prirjen për të zbatuar strategji të tilla, si: reagime fizike (duke goditur etj.), reagime agresive, zënka me zë të lartë, duke thirrur një të rritur për ndihmë, duke u larguar nga skena e konfliktit, duke hequr dorë dhe tërhequr, duke bërë sikur nuk ka ndodhur asgjë ose me një gjest simbolik (një shtrëngim duarsh, një dhuratë etj.).

Nxënësit më të rritur të shkollave fillore (mosha 10 vjeç e lart) kanë prirjen të përdorin strategji të ndryshme në zgjidhjen e konflikteve të tilla, si: duke injoruar konfliktin, duke folur me njëri-tjetrin, duke kërkuar një zgjidhje në interes të përbashkët që merr parasysh të dyja qëndrimet, duke kërkuar kush ka të drejtë, për rrjedhojë kush ka "fituar", si dhe duke negociuar derisa të gjithë të përfshirët në të, të mbeten të kënaqur me zgjidhjen.

Ekspertët bëjnë dallimin ndërmjet tre llojeve kryesore të zgjidhjes së konflikteve:

- zgjidhja fizike e konfliktit;
- zgjidhja e njëanshme e konfliktit (duke e bërë një veprim "sikur nuk ka ndodhur", pajtim me gjeste simbolike ose me dhurata);
- zgjidhja konflikteve përmes bashkëpunimit (reflektimi ose aftësia për të parë dy këndvështrime).

Mësimet në këtë kapitull i marrin parasysh këto strategji për zgjidhjen e konfliktit dhe janë të bazuara në njohuri të psikologjisë zhvillimore. Ato janë një element kyç për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë të kuptuarit e problemeve individuale si dhe ato të përbashkëta dhe konfliktet, duke i ndihmuar ata të mësojnë të bëjnë dallimin midis të mirave publike dhe të mirave private. Zgjidhja e problemeve do të ndikojë në një grup më të gjerë njerëzish, nëse ato i përkasin kategorisë së problemeve ose konflikteve të përbashkëta dhe, në të njëjtën mënyrë, zgjidhja e një problemi ose konflikti individual duhet të ndikojë vetëm individin dhe jo në dikë tjetër.

Në shkollën fillore, konfliktet si ato të përshkruara më sipër, shpesh mund të lindin për shkak të infrastrukturës (nuk ka hapësirë të mjaftueshme), gjinisë (marrëdhëniet vajzë-djalë), punës së përbashkët (shpejtësi të ndryshme në punë, nivele të ndryshme etj.) ose si pasojë e sjelljes sociale (nuk e lejon dikë të mbarojë së foluri etj.). Kur zhvillohen këto katër mësimet rreth konfliktit, mësuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se trajtimi i gjërave që nuk shkojnë mirë në klasë nuk është e mundur të realizohet në vetëm një mësim. Pavarësisht nga mënyra e formulimit dhe e miratimit të rregullave të klasës ose rregullave të komunikimit, problemet dhe konfliktet mundet të ndodhin përsëri. Prandaj, konfliktet dhe zgjidhja e tyre, si dhe ndërgjegjësimi për problemet që mund të ndodhin në jetën e përditshme shkollore, duhet të trajtohet në vijimësi. Vetëm nëse nxënësit bëhen pjesëmarrës aktivë në diskutimin e krijimit të rregullave, ata do të jenë në gjendje të identifikohen me to.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e mëposhtëm të kompetencës:

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
*****	***	***

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

0 Hulumtim në biblioteka

0 Hulumtim në internet

0 Kryerja e intervistave dhe sondazheve

0 Interpretimi i imazheve

x Harta mendore

0 Krijimi i posterave

0 Ekspozita të përbashkëta

x Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

0 Përgatitja e sliderave me projektor ose një prezantim në *PowerPoint*

0 Shkrim artikuj gazetash

0 Vënia e një shfaqjeje në skenë

x Debate të përbashkëta

Kapitulli 4: Konfliktet

Rregullat ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve

Zgjidhja e konflikteve në arsimin fillor

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Çdo gjë është në rregull! Vërtet?	Nxënësit: - zhvillojnë kuptimin rreth të mirave publike dhe private - identifikojnë problemet në klasën e tyre.	Nxënësit grumbullojnë problemet (në një hartë mendore, imagjinare) dhe i klasifikojnë ato në kategoritë e problemeve të përbashkëta dhe ato individuale.	Copa të vogla letre, lapsa, informacione rreth dy kategorive të problemeve.	Punë individuale, diskutim plenar.
Mësimi 2: Kjo është mënyra si e bëjmë ne	Nxënësit: - reflektojnë rreth mekanizmave të tyre të zgjidhjeve të konflikteve dhe - zhvillojnë kuptimin për këndvështrime, personalitete e sjellje të ndryshme.	Nxënësit japin mendimet e tyre në lidhje me problemet dhe japin propozime për zgjidhje.	Tabelë, lapsa.	Punë në grupe.
Mësimi 3: Një listë me ide	Nxënësit: - mësojnë si të formojnë argumente në një debat; - praktikojnë mbështetjen e qëndrimeve <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> në diskutime; - kuptojnë funksionimin e shumicës.	Nxënësit paraqesin propozimet e tyre për zgjidhje dhe vendosin një liste rregullash të përbashkëta në klasë.	Tabelë, lapsa.	Diskusim plenar.
Mësimi 4: Kontrata jonë e rregullave	Nxënësit: - zhvillojnë kuptimin e përbashkët; - mësojnë si të identifikohen me një marrëveshje të formuluar në mënyrë të përbashkët.	Nxënësit shkruajnë rregullat e përbashkëta dhe e nënshkruajnë me emrat e tyre. Ata diskutojnë mekanizmat për kontrollin dhe për pasojat e mundshme.	Tabelë, lapsa.	Diskusim plenar.

Mësimi 1

Çdo gjë është në rregull! Vërtet?

Çfarë problemesh / konfliktesh mund të vërejmë në klasën tonë?

Objektivat e mësimi	Nxënësit zhvillojnë kuptimin rreth të mirave publike dhe private, nëpërmjet identifikimit të problemeve në klasën e tyre.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit grumbullojnë problemet (në një hartë mendore, imagjinare) dhe i klasifikojnë ato në kategoritë e problemeve të përbashkëta dhe ato individuale.
Burimet	Copa të vogla letre, lapsa, informacione rreth dy kategorive të problemeve.
Metodat	Punë individuale, diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Mësuesi shkruan titullin e mësimi "Çdo gjë është në rregull! Vërtet?" në dërrasën e zezë. Nxënësve u jepet detyra të mendojnë për të gjitha gjërat që, sipas tyre, nuk janë në rregull në klasë. Pasi jep detyrën, mësuesi cakton fushat e ndryshme në të cilat mund të lindin probleme ose konflikte:

- kur punojnë së bashku me shokët e tjetër të klasës;
- mes vajzave dhe djemve;
- kur duhet të ndajnë të njëjtat gjëra, psh. të njëjtën tryezë ose të njëjtën dhomë;
- duke qenë miq me dikë.

Nxënësit i shkruajnë të gjitha problemet ose konfliktet që mund të mendojnë në skeda të vogla prej letre, të cilat i ngjisin në dërrasën e zezë. Më pas, nxënësit ulen para saj në formë rrethi.

Mësuesi, në vijim, thekson se ka dy lloje problemesh: individuale dhe të përbashkëta. Ai jep shembuj të çdo lloji: për shembull, shumë zhurmë në klasë mund të jetë një problem i përbashkët, mirëpo edhe mungesa e hapësirës së mjaftueshme në tavolinë është një problem individual. Mësuesi i shënon problemet në dërrasën e zezë një nga një dhe kërkon nga nxënësit t'i ndajnë sipas kategorive. Për këtë, mësuesi ka përgatitur dy fletë, në të cilat ka shënuar, respektivisht, fjalët: "probleme dhe konflikte të përbashkëta" dhe "probleme dhe konflikte individuale". Ai i vendos ato në dërrasën e zezë duke krijuar dy kolona.

Pasi nxënësit kanë përfunduar ndarjen e problemeve/konflikteve, mësuesi fillon diskutimin se cili prej tyre mund të zgjidhet më lehtë.

Mësimi 2

Kjo është si e bëjmë ne

Çfarë zgjidhjesh kemi për problemet?

Objektivat e mësimi	Nxënësit reflektojnë rreth mekanizmave të zgjidhjes së konflikteve dhe krijojnë kuptimin e tyre për këndvështrimet, personalitetet dhe sjelljet e ndryshme që ekzistojnë.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit japin mendimet e tyre rreth problemeve dhe ofrojnë propozime për zgjidhjet.
Burimet	Tabelë, lapsa.
Metodat	Punë në grupe.

Përshkrimi i mësimi

Mësuesi, paraqet përsëri listën e problemeve ose të konflikteve nga mësimi 1. Ata ulen në grupe me nga katër vetë dhe zgjedhin dy probleme ose konflikte nga lista për të punuar në grupin e tyre.

Secili grup punon me dy probleme ose konflikte të ndryshme.

Nxënësit diskutojnë idetë e tyre për zgjidhjen e konflikteve ose problemeve në mënyrë që zgjidhjet të ndikojnë vetëm grupin ose personin e synuar (në varësi të faktit, nëse problemi hyn në kategorinë e problemeve të përbashkët apo atë individual).

Nxënësit shkruajnë idetë e tyre, dhe ilustrojnë një poster me dy probleme ose konflikte dhe me mënyrat e mundshme për zgjidhjen e tyre. Ata nënvizojnë zgjidhjet që parapëlqen grupi.

Mësimi 3

Një listë me ide

Cilat nga zgjidhjet preferon shumica?

Objektivat e mësimi	Nxënësit mësojnë si të formulojnë argumentet në një debat. Ata praktikojnë mbështetjen <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> në diskutimet e tyre dhe kuptojnë funksionimin e shumicës.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit paraqesin propozimet e tyre për zgjidhjen dhe vendosjen e një liste rregullash të përbashkëta në klasë.
Burimet	Tabelë, lapsa.
Metodat	Diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit marrin posterat që kanë krijuar në mësimin 2 dhe i paraqesin para klasës. Ata tregojnë se cilat zgjidhje, për të dy problemet ose konfliktet, i gjykojnë si më të përshtatshme dhe japin edhe arsyet përse.

Pas çdo prezantimi, studentët varin posterat e tyre në mur.

Në një klasë me 25 nxënës, afërsisht gjashtë grupe paraqesin zgjidhjet e tyre. Kjo do të thotë që do të trajtohen 12 probleme ose konflikte. Pasi të gjitha grupet të kenë paraqitur idetë e tyre, nxënësit duhet të votojnë për zgjidhje të ndryshme.

Çdo zgjidhjeje i caktohet një numër, nga një deri në pesë (duke supozuar se jo më shumë se pesë zgjidhje janë gjetur për çdo problem ose konflikt). Për të votuar, nxënësve u janë dhënë skedat me numra nga një deri në pesë. Për çdo problem ose konflikt, nxënësit mund të votojnë, duke mbajtur skedën me numrin e zgjedhur të ngritur lart. Mësuesi numëron votat për çdo numër dhe shënon zgjidhjen fituese.

Pasi vlerësojnë të gjitha zgjidhjet për problemet ose konfliktet, nxënësit reflektojnë së bashku rreth rezultateve si dhe për faktin se zgjidhja u vendos nga shumica.

Mësimi 4

Kontrata jonë e rregullave

Si i shkruajmë rregullat e përbashkëta?

Objektivat e mësimi	Nxënësit zhvillojnë kuptimin e përbashkët dhe mësojnë si të dallojnë interesat e tyre në një marrëveshje të formuluar së bashku.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit shkruajnë rregullat e përbashkëta dhe nënshkruajnë me emrat e tyre. Ata diskutojnë mekanizmat për kontrollin dhe pasojat e mundshme.
Burimet	Tabelë, lapsa.
Metodat	Diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Pasi të gjithë nxënësit votojnë për zgjidhjet e ndryshme të problemeve ose konflikteve të renditura, u jepet detyra të shkruajnë një "kontratë" rregullash, e cila mund të nënshkruhet nga të gjithë.

Në diskutimin plenar, nxënësit flasin për mënyrën si duan ta hartojnë këtë kontratë. A do të jetë ajo në formatin e një table posteri, në një format letër A4, apo do të jetë një dokument i mbështjellë tub dhe i vulosur? Ata duhet të bien dakord për formën që parapëlqejnë dhe nëse është e nevojshme, zgjedhja do të vendoset me vendim të shumicës.

Nxënësit janë të lirë të hartojnë kontratën e rregullave në mënyrën që dëshirojnë, por pasi të kenë plotësuar kriteret në vijim:

- Të gjitha zgjidhjet, për të cilat është rënë dakord, të jenë shkruar në formën e deklaratave.
- Të gjithë nxënësit të nënshkruajnë kontratën në fund.
- Vendi dhe data e nënshkrimit të jetë e shkruar në kontratë.

Pasi kontrata është shkruar dhe nënshkruar, nxënësit diskutojnë se çfarë do të ndodhë, nëse dikush thyen një nga rregullat. A do të ketë ndonjë pasojë? Nëse po, çfarë pasoje? Si do të kontrollohen rregullat e caktuara? A është ajo përgjegjësi e të gjithëve? Apo janë njerëz të veçantë përgjegjës për këtë? A do të jetë kjo e dobishme apo jo?

Hapi i mundshëm: pasojat e thyerjes së rregullave i shtohen kontratës (si një shtojcë).

KAPITULLI 5

RREGULLAT DHE LIGJI

Arsimi fillor

Baza e të jetuarit së bashku

5.1 Pse kemi nevojë për rregulla dhe ligje?

Çfarë lloje rregullash janë të nevojshme për t'u mësuar, kur jetojmë dhe luajmë së bashku në shkollë?

5.2 Çfarë ndodh nëse ...?

Mos ndjekja rregullave ka pasoja

5.3 Rregullat tona të reja shkollore

Hartimi i një marrëveshje të përbashkët

5.4 Një fushatë për rregullat tona të reja shkollore

Vlerësimi për rregullat e reja dhe paraqitja e tyre

Kapitulli 5: Koncepti kyç - "Rregullat dhe ligji" (për arsimin fillor) Informacion për mësuesit: marrëveshje mbi bazën e parimeve demokratike - Rregullat tona të reja shkollore

Në vitet e fundit, ka pasur diskutime në lidhje me çështjen e parimeve demokratike.

Çfarë është një demokraci sipas të kuptuarit të sotëm? A ka demokraci të mira dhe të këqija? A është e mjaftueshme një *kushtetutë demokratike* që një shtet të quhet demokratik? Shumë grupe dhe parti politike e quajnë veten demokratike ose e përfshijnë fjalën "demokraci" në emrat e tyre. Çfarë tregon kjo? Çfarë do të thotë kjo për anëtarët e këtyre grupeve?

Në thelb, është e qartë se demokracia nuk mund të imponohet. Një demokraci ka nevojë për një kuadër ligjor, një *kushtetutë* dhe marrëveshje të ndryshme, në mënyrë që ajo të funksionojë. Ajo do të jetë efiçase vetëm nëse njerëzit ndiejnë nevojën për të marrë pjesë në shoqërinë e tyre. Pjesëmarrja mund të shfaqet në forma të ndryshme dhe të zhvillohet në fusha të ndryshme; ajo realizohet në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme. Në thelb, demokracia do të thotë që njerëzit bëjnë ligjet me të cilat ata vetë duan të jetojnë. Në mënyrë ideale, kërkohet që, në të tilla procese, të marrin pjesë sa më shumë njerëz që të jetë e mundur. Çfarë duam të rregullohet? Kush duhet t'i bindet këtyre rregullave? Pse kemi nevojë për këtë ose atë rregull? Si merremi ne me problemin e madh të shkeljes së rregullave dhe ligjeve?

Në këtë kapitull, nxënësit jo vetëm që mësojnë në lidhje me një parim të rëndësishëm të demokracisë, por atyre u ofrohet edhe përvoja praktike për të. Përvoja tregon se nxënësit bëhen më të vetëdijshëm dhe më të përgjegjshëm, nëse janë të integruar në procesin e vendimmarrjes. Një grup njerëzish që jetojnë duke kaluar kohën së bashku duhet të hartojnë rregulla të cilat mundësojnë jetën e tyre së bashku. Fëmijët dhe adoleshentët kalojnë më shumë kohë në shkollë se kudo tjetër. Në këtë kapitull bëhet e qartë se shkolla është vendi ku mësohet. Në të, "jetojnë" dhe mësojnë së bashku shumë njerëz me nevoja shumë të ndryshme. Kjo jetesë e përbashkët duhet të rregullohet në një farë mënyre. Konfliktet, të cilat janë krejtësisht të natyrshme, duhet të gjejnë zgjidhje dhe interesat e pakicave të ndryshme duhet të mbrohen.

Demokracia shpesh ngatërrohet me idenë se të gjithë mund të bëjnë atë që dëshirojnë. Një koncept i tillë nuk përputhet me parimin e demokracisë. Demokracia është e bazuar në idenë se rregullat dhe ligjet janë bërë nëpërmjet proceseve të pjesëmarrjes, të cilat janë transparente për të gjithë. Këto rregulla dhe ligje edhe mund të ndryshohen. Këto parime janë objekt i kapitullit në vijim.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e mëposhtëm të kompetencës.

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	*	***

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

Hulimtim në biblioteka

Hulimtim në internet

Kryerja e intervistave dhe sondazheve

Interpretimi i imazheve

Harta mendore

Krijimi i posterave

Ekspozita të përbashkëta

Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

Përgatitja e sliderave për projektor ose një prezantim në *PowerPoint*

Shkrim artikuj gazetash

Organizimi i një shfaqjeje

Debate të përbashkëta

KAPITULLI 5: Rregullat dhe ligji -Baza e të jetuarit së bashku

Marrëveshja për bazën e parimeve demokratike - Rregullat tona të reja shkollore

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Pse kemi nevojë për rregulla dhe ligje?	Nxënësit reflektojnë për qëndrimet dhe besimet e tyre vetjake në lidhje me rregullat ekzistuese; Ata diskutojnë rëndësinë e ekzistencës së rregullave për të jetuar dhe punuar së bashku dhe zhvillojnë të kuptuarit e domosdoshmërisë së rregullave.	Nxënësit marrin pjesë në një lojë simulimi dhe përjetojnë funksionimin e rregullave. Ata listojnë dhe ndajnë midis tyre idetë në lidhje me nevojën për rregulla. Nxënësit shohin përputhjen e rregullave të shkollës me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shkollë.	Topa të butë, tabelë, lapsa, lista e rregullave të shkollës.	Puna në grupe, diskutim plenar, punë në çifte.
Mësimi 2: Çfarë ndodh nëse ...?	Nxënësit diskutojnë pasojat e thyerjes së ligjit; Ata reflektojnë për rregullat e shkollës në lidhje me parimet e drejtësisë, barazisë, pjesëmarrjes dhe respektit.	Nxënësit praktikohen duke luajtur role në të cilat thyhen rregullat e shkollës. Ata analizojnë rregullat ekzistuese shkollore dhe diskutojnë e mbajnë shënime për pasojat reale dhe ato të mundshme të thyerjes së rregullave. Ata tregojnë çfarë do të donin që të ndryshonin në rregullat e shkollës, pse do t'i ndryshonin ato dhe si.	Ngjitës, lapsa, tabelë, lista e rregullave të shkollës për secilin grup, një version i rregullave të shkollës, e shkruar me shkronja të mëdha në tabelë ose në dërrasën e zezë.	Loja me role në grupe, diskutim plenar, punë në grup.
Mësimi 3: Rregullat tona të reja shkollore	Nxënësit mësojnë se si të punojnë me një numër rregullash të përbashkëta të cilat janë të detyrueshme për të gjithë në shkollë; Ata diskutojnë mënyrat realiste të integritimit në jetën e përditshme të shkollës.	Nxënësit arrijnë një marrëveshje për rregullat të cilat janë pranuar nga shumica dhe për të diskutuar mundësitë e integritimit të mendimit të pakicës.	Tabelë, lapsa, skedat e votimit, lista e rregullave të shkollës për tabelë ose në dërrasën e zezë, copat e prera bukur të letrës.	Punë në çifte dhe në grup.
Mësimi 4: Një fushatë për rregullat tona të reja shkollore	Nxënësit kuptojnë kriteret e rëndësishme për ligje të mira; Ata mësojnë se si bëhet fushatë për rregulla të reja shkollore.	Nxënësit vendosin kriteret të ndryshme për rregulla të mira. Ata provojnë rregullat e reja të shkollës, në bazë të këtyre kriterëve të ndryshme. Ata shkruajnë marrëveshjen përfundimtare dhe e nënshkruajnë atë. Ndërkohë e paraqesin marrëveshjen e tyre në klasat e tjera në shkollë.	Tabelë, materialet e shkruara, letër, lapsa, kopje e marrëveshjes për klasat e tjera, rezultatet e seancës së ideve nga mësimi 1.	Puna në çifte, diskutim plenar, prezantime në klasat e tjera.

Mësimi 1

Pse kemi nevojë për rregulla dhe ligje?

Çfarë lloje rregullash janë të nevojshme për të mësuar, për të jetuar dhe për të luajtur së bashku në shkollë?

Objektivat e mësimit	Nxënësit reflektojnë për qëndrimet dhe besimin e tyre vetjake në lidhje me rregullat ekzistuese, diskutojnë rëndësinë e ekzistencës së rregullave për të jetuar dhe punuar së bashku dhe zhvillojnë kuptimin e domosdoshmërisë së rregullave.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit marrin pjesë në një lojë simulimi dhe përjetojnë funksionimin e rregullave. Ata listojnë dhe ndajnë midis tyre idetë në lidhje me nevojën e rregullave. Nxënësit përputhin rregullat e shkollës me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shkollë.
Burimet	Topa të butë, tabelë, lapsa, lista e rregullave të shkollës.
Metodat	Punë në grupe, diskutim plenar, punë në çifte.

Përshkrimi i mësimit

Klasa luan lojën "Hamendëso rregullat e mia". Mësuesi e ndan klasën në dy grupe dhe u shpjegon nxënësve se ata do të luajnë një lojë dhe të hamendësojnë rregullat.

Shpjegim:

- Çdo ekip mund të bëjë një gol duke shënuar me top në hapësirën e shënuar;
- Vetëm mësuesi i di rregullat;
- Mësuesi nuk i shpjegon rregullat dhe nxënësit nuk mund të pyesin cilat janë ato;
- Kur thyejnë një rregull, nxënësit duhet të ulen;
- Qëllimi i lojës është që nxënësit të shënojnë gol pa thyer rregullat; nxënësit kanë për detyrë që të zbulojnë e të kuptojnë se cilat janë rregullat që të mos i thyejnë.

Rregullat janë:

- Të gjithë mund të luajnë në lojë.
- Vetëm djemtë mund të gjuajnë topin me këmbë.
- Nxënësit, të cilit i fillon emri me shkronjën "A" nuk mund të vrapojë.
- Askujt nuk i lejohet të lëvizë me top.
- Dhuna është e lejuar.

Dy minutat e para të lojës luhen duke u përdorur vetëm dy rregullat e parë. Pastaj, mësuesi përfshin edhe rregullat e tjera dhe e gjithë loja zgjat rreth pesë minuta.

Pasi loja përfundon, mësuesi i mbledh nxënësit dhe diskuton pikat e mëposhtme me ta:

- Çfarë mendoni për lojën? A ishte e mirë? E keqe? E drejtë?
- Si mësuar për ekzistencën e disa rregullave?
- Çfarë ndjesish u krijoi mosnjohja e rregullave?

Mësuesi regjistron përgjigjet e nxënësve në tabelë ose në dërrasën e zezë. Pyetja kryesore është "Pse kemi nevojë për rregulla në shkollë?" Mësuesi mund të shkruajë diçka në tabelë ose në dërrasën e zezë, në varësi të përgjigjeve. Kriteri kryesor në lidhje me "barazinë", "pjesëmarrjen", "drejtësinë" dhe "respektin" duhet të jetë i pranishëm në dërrasën e zezë, në fund të seancës mësimore. Mësuesi shënon rezultatet për t'i përdorur në mësimin 4.

Në shkollë mund të ketë rregulla vetëm nëse nxënësit kanë të drejta dhe përgjegjësi. Nxënësve u jepet detyra që të rendisin të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shkollë dhe, më pas, t'i krahasojnë ato me rregullat e shkollës. Nxënësit punojnë në çifte dhe shkruajnë të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në letrat në dispozicion. Ata i shfaqin letrat e tyre në tabelë ose në dërrasën e zezë.

Pasi të gjitha letrat janë vendosur në të, nxënësit i hedhin një vështrim tabelës dhe mund të bëjnë pyetje për shokët e klasës.

Mësimi 2

Çfarë ndodh nëse ...?

Mos zbatimi i rregullave ka pasoja

Objektivat e mësimi	Nxënësit diskutojnë pasojat e thyerjes së ligjit. Ata reflektojnë për rregullat e shkollës në lidhje me parimet e drejtësisë, barazisë, pjesëmarrjes dhe respektit.
Detyrat e nxënësve	Përmes lojës me role, nxënësit praktikojnë thyerjen e rregullave të shkollës. Ata analizojnë rregullat në shkollën e tyre dhe diskutojnë duke shënuar pasojat reale dhe të mundshme nga thyerja e tyre. Ata tregojnë çfarë do të donin të ndryshonin në rregullat e shkollës, pse do t'i ndryshonin ato dhe si.
Burimet	Ngjitës, lapsa, tabelë, lista e rregullave të shkollës për secilin grup, një version i rregullave të shkollës, i shkruar me shkronja të mëdha në tabelë ose në dërrasën e zezë.
Metodat	Loja me role në grupe, diskutim plenar, punë në grup.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit formojnë grupe me katër vetë. Ata luajnë rolin e thyerësit të rregullave të shkollës. Grupet diskutojnë rregullat, para se të fillojnë lojën. Rolet mund të lidhen me:

- një lojë futboll;
- një sjellje e keqe në klasë;
- lojërat kompjuterike;
- sjelljen e keqe në oborrin e shkollës;
- të folurit me zë të lartë gjatë mësimi;
- përleshja me të tjerët;
- Etj.

Për çdo rregull të thyer, nxënësit regjistrojnë pasojat ose, nëse s'ka asnjë, ndonjë pasojë të mundshme. Grupet marrin shënimet dhe kthehen në seancë plenare.

Në seancën e diskutimeve, trajtohen çështjet e mëposhtme:

- Si i mbështetin rregullat të drejtat dhe përgjegjësitë tona dhe si na ndihmojnë për të jetuar së bashku në siguri, me të drejta të plotësuara dhe në mirëqenie?
- Pse kemi nevojë për rregulla?
- Si mund t'i dimë të gjithë se cilat janë rregullat?
- A janë rregullat të drejta për të gjithë?
- A ka situata kur rregullat ndryshojnë?
- Kush duhet t'i bëjë rregullat dhe pse?
- Çfarë ndodh nëse nuk ndjekim rregullat?

Pas diskutimit, nxënësit kthehen në grupet e tyre me nga katër vetë. Ata diskutojnë nëse duan të ndryshojnë diçka në rregullat ekzistuese të shkollës. Ata vijnë në një përfundim si grup dhe tregojnë ndryshimin që ata dëshirojnë të bëjnë, duke i ngjitur sugjerimet e tyre për rregullat e shkollës, në tabelë ose në dërrasën e zezë.

Mësimi 3

Rregullat tona të reja shkollore

Hartimi i një marrëveshje të përbashkët

Objektivat e mësimi	Nxënësit mësojnë si të punojnë për një numër rregullash të përbashkët, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë nxënësit në shkollë. Ata diskutojnë mënyrat realiste të integritit në jetën e përditshme të shkollës.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit arrijnë një marrëveshje për rregullat që janë pranuar nga shumica dhe diskutojnë mundësitë e integritit të mendimit të pakicës.
Burimet	Tabelë, lapsa, skedat e votimit, lista e rregullave të shkollës për tabelë ose në dërrasën e zezë, copat letre.
Metodat	Puna në grupe, diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit ulen në një rreth përballë me tabelën ose dërrasën e zezë, ku janë shkruar rregullat e shkollës me shkronja të mëdha. Letrat e ngjitura, që tregojnë se çfarë ndryshimesh dëshiron secili grup në rregullat e shkollës, janë ende në tabelë. Mësuesi drejton diskutimin me pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë mendojnë nxënësit në lidhje me ndryshimet e sugjeruara?
- A i pranojnë ata sugjerimet?
- Sa prej tyre i pranojnë? Pjesa më e madhe?
- Çfarë ndodh me pakicën? A mund të gjendet një kompromis?

Nxënësit kthehen në grupet e tyre. Ata punojnë për një rregull që do të ndryshohet dhe përpiqen ta riformulojnë atë. Ata e shkruajnë atë në një copë letër dhe e ngjitin në tabelë ose në dërrasën e zezë.

Pasi të gjitha sugjerimet e reja janë ngjitur në tabelë ose në dërrasën e zezë, është koha që nxënësit të votojnë. Të gjithë nxënësit duhet të marrin kartat e tyre të votimit. Çdo rregull do të lexohet nga mësuesi. Nxënësit votojnë duke përdorur skedat e tyre, duke treguar pranimin, refuzimin ose abstenimin.

Gjërat që nuk pranohen nga shumica duhet të diskutohen përsëri.

Në fund të procesit, rregullat e reja shkollore duhet të jenë shkruar në një letër A4.

Mësimi 4

Një fushatë për rregullat tona të reja shkollore

Vlerësimi për rregullat e reja dhe paraqitja e tyre

Objektivat e mësimi	Nxënësit kuptojnë kriterin e rëndësishëm për ligje të mira. Ata mësojnë se si bëhet fushatë për rregulla të reja shkollore.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit mbledhin kritere të ndryshme për rregulla të mira. Ata i provojnë rregullat e reja të shkollës, në bazë të këtyre kritereve të ndryshme. Ata shkruajnë marrëveshjen përfundimtare dhe e nënshkruajnë atë. Ata e paraqesin marrëveshjen e tyre në klasat e tjera në shkollë.
Burimet	Tabelë, materialet e shkruara, letër, lapsa, kopje e marrëveshjes për klasat e tjera, rezultatet e seancës së ideve nga mësimi 1.
Metodat	Puna në çifte, diskutim plenar, prezantime në klasat e tjera.

Përshkrim i mësimi

Mësuesi paraqet rezultatet e seancës së dhënies së ideve nga mësimi 1 (kriteret për rregullat). Nxënësve u kërkohet të testojnë rregullat e reja shkollore në bazë të këtyre kritereve. Ata punojnë në çifte dhe plotësojnë fletën e punës.

Nxënësit kthehen në *seancë plenare* dhe paraqesin rezultatet e analizës së tyre. A ka ndonjë ndryshim të madh në rregullat e shkollës? Nëse është kështu, këto ndryshime duhet të bëhen me marrëveshje.

Rregullat e reja të shkollës kopjohen për t'i prezantuar në klasat e tjera.

Mësuesi i ndan nxënësit në grupe me nga katër vetë. Grupet duhet të shkojnë në klasa të ndryshme dhe paraqesin rregullat e reja shkollore.

Është e rëndësishme që procesi të sqarohet paraprakisht. Çfarë do të duhet të bëjnë nxënësit në klasat e tjera? A duhet që ata të vlerësojnë rregullat e reja shkollore? Çfarë ndodh më pas? Grupet ushtrohen për prezantimin e rregullave të reja shkollore, duke përfshirë edhe arsyet pse u ndryshuan rregullat e mëparshme. Pastaj ata shkojnë në klasat e tjera dhe bëjnë prezantimet e tyre.

Pas prezantimeve, zhvillohet një bisedë e shkurtër në *seancë plenare*.

KAPITULLI 6

Pushteti dhe autoriteti

Arsimi fillor

Unë jam shefi! A jam unë?

6.1 Superheroi?

Cili duhet të jetë roli i kreut të klasës?

6.2 Djem të mirë, djem të këqij?

Cili është roli i politikanëve në demokraci?

6.3 Një person bën gjithçka, të tjerët nuk bëjnë asgjë?

Cilat janë rolet në sistemin e përfaqësimit dhe kush duhet t'i luajë ato?

6.4 Ndarja e pushtetit

Cilat janë kriteret që përcaktojnë sistemin e përfaqësimit?

Kapitulli 6: Koncept kyç - "Pushteti dhe autoriteti" (për arsimin fillor)

Informacion për mësuesit: pushtet legjitim - parimi i delegimit në arsimin fillor

Nxënësit e moshës 10 vjeç dhe ata më të mëdhenj në moshë, janë në gjendje të mendojnë në mënyrë abstrakte. Ata mund të njohin dhe të zhvillojnë struktura në mjedisin e tyre dhe janë të aftë të dallojnë interesat e veta dhe ato të të tjerëve. Me rritjen e moshës, ata do të jenë më të aftë për ta bërë këtë gjithmonë e më mirë.

Nga mosha 10 vjeçare, nxënësit fillojnë të kuptojnë lidhjet ndërmjet hapësirës dhe kohës, si dhe fillojnë të zhvillojnë aftësinë për të shprehur dhe perceptuar ndjenjat dhe të njohin normat. Në këtë moshë, nxënësit fillojnë të njohin mjaft mirë mjedisin ku jetojnë dhe të tregojnë interes më të madh për të panjohurat. Perceptimi i tyre për sistemet shoqërore (shoqatat, klubet, grupet e të rinjve etj.) bëhet më i hollësishëm, për rrjedhojë, ata motivohen dhe përfshihen në mbrojtjen e njerëzve të tjerë, madje edhe organizohen për interesat e tyre.

Jeta në komunitetin e klasës dhe të shkollës bëhet më e rëndësishme. Si është organizuar jeta e komunitetit? Cilët rregulla janë të rëndësishme? Kush i zhvillon dhe i vendos këto rregulla? Kush mund t'i ndryshojë këto rregulla?

Për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve, janë të nevojshme jo vetëm njohuritë politike për sistemet e komunitetit ose, në një kuptim më të gjerë, për shtetin, por edhe aftësitë për të ndikuar në strukturat dhe proceset brenda këtij komuniteti - me fjalë të tjera, për të "jetuar" demokracinë.

Veçanërisht në arsimin e mesëm, kushtet për fillimin e pjesëmarrjes në projektet jashtë shkollës janë shumë pozitive për psikologjinë zhvillimore të fëmijës. Nxënësit mund të njohin ciklin e proceseve politike dhe të kuptojnë procesin e vendimmarrjes. Për më tepër, shumica e vendimeve për nxënësit e kësaj moshe merren në nivel komuniteti (të tilla si trafiku, objektet e kohës së lirë etj.). Nxënësit mund të fitojnë ide të rëndësishme, nëse nxiten për të marrë për vete përgjegjësi sociale dhe nëse ndjehen përgjegjës për një pjesë të jetës së tyre shkollë. Duke trajtuar tema të tilla si *delegimi*, ata mund të grumbullojnë përvoja konkrete të pjesëmarrjes dhe të përgjegjësisë gjatë jetës së tyre të përditshme. Sa më shumë përvojë nga bota reale që të kenë nxënësit e kësaj moshe, dhe sa më shumë përvojë t'u japin këto situata kur ata mund të kenë ndikim në proceset politike, aq më e lartë do të jetë mundësia që ata më vonë të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse dhe të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për shoqërinë.

Pushteti dhe autoriteti - parimi i delegimit - është një hap drejt ngritjes së vetëdijes. Seria e ardhshme e mësimave përvijon proceset politike në shkollë, në mënyrë të ngjashme edhe me veprimtaritë që zhvillohen jashtë shkollës. Në këtë drejtim, zgjedhja e kreut të klasës nuk duhet të jetë një aktivitet i izoluar, por një që duhet të përdoret si model. Në ndryshim me aktivitetet shkollë: të tilla si zgjedhjet formale, ku nxënësit kopjojnë ose rikopjojnë zgjedhjet politike, zgjedhja e një kreu të klasës (ai që shpesh quhet *kujdestari i klasës*), duhet të ketë një ndikim në jetën e përditshme në shkollë.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e mëposhtëm të kompetencës.

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	*** **	**

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

- Huluntim në biblioteka
- Huluntim në internet
- Kryerja e intervistave dhe sondazheve
- Interpretimi i imazheve
- Harta mendore
- Krijimi i posterave
- Organizimi i ekspozitave
- Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve
- Përgatitja e sliderave për projektor ose një prezantim në *PowerPoint*
- Shkrim artikujsh gazetash
- Vënia e një shfaqjeje
- Debate të përbashkëta

Kapitulli 6: Pushteti dhe autoriteti

Unë jam shefi! A jam unë?

Pushteti legjitim - parimi i delegimit në arsimin fillor

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Superheroi?	Nxënësit: - reflektojnë rreth konceptit të përgjegjësisë dhe autorizimit, duke diskutuar për pozitën e kreut të klasës.	Nxënësit diskutojnë për përgjegjësitë, kompetencat dhe pozitën që duhet të ketë kreu i klasës.	Tabelë, lapsa, materiale të shtypura, foto e madhe e një superheroi.	Punë individuale, punë në grup, diskutim plenar.
Mësimi 2: Djem të mirë, të këqij...?	Nxënësit: - kuptojnë idenë se një person mund të përfaqësojë një grup njerëzish. - zhvillojnë kuptimin e konceptit të delegimit të pushtetit dhe përgjegjësisë.	Nxënësit krahasojnë mendimet e tyre për skemën e përfaqësimit politik në një demokraci. Ata diskutojnë pikëpamjet e tyre për politikanët duke bërë krahasimin me mendimet e njerëzve të tjerë. Ata kryejnë intervista të shkurtra për të realizuar këtë gjë.	Skema e përfaqësimit politik, lapsa, letër.	Punë individuale, punë në çifte, diskutim plenar.
Mësimi 3: Një person bën çdo gjë, pjesa tjetër nuk bën asgjë	Nxënësit: - reflektojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicioneve të ndryshme në procesin e zgjedhjeve dhe pasojat e tij.	Nxënësit paraqesin rezultatet e intervistave të tyre në klasë. Ata përcaktojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicioneve të ndryshme dhe zgjedhin një nxënës si kreun (<i>kujdestarin</i>) e klasës.	Tabelë, lapsa, skedat e zgjedhjeve, lista e nxënësve të interesuar për pozitën e kreut të klasës, kopje të materialit të shtypur.	Diskutim plenar.
Mësimi 4: Ndarja e pushtetit	Nxënësit: - njohin konceptet e rizgjedhjes dhe mos-përzgjedhjes. - reflektojnë kriteret për përcaktimin e sistemit të përfaqësimit.	Nxënësit diskutojnë dhe përcaktojnë kriteret që i lejojnë ata të kontrollojnë veprimtarinë e kreut (<i>kujdestarit</i>) të klasës.	Tabelë, lapsa.	Diskutim plenar.

Mësimi 1

Superheroi?

Cili duhet të jetë roli i kreu të klasës?

Objektivat e mësimi	Nxënësit reflektojnë rreth konceptit të përgjegjësisë dhe autorizimit, duke diskutuar pozitën e kreu të klasës.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit diskutojnë për përgjegjësitë, kompetencat dhe pozitën që duhet të ketë kreu i klasës.
Burimet	Tabelë, lapsa, materiale të shtypura, foto e madhe e një superheroi.
Metodat	Punë individuale, punë në grup, diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësve iu paraqitet një material me një "Superhero". Atyre u caktohet detyrë të plotësojnë rrathët bosh me kompetencat dhe përgjegjësitë që duhet të ketë kreu i klasës. Ata e bëjnë këtë punë për 10 minuta.

Pas plotësimit të kësaj detyre, nxënësit mbledhen në grupe me nga katër vetë dhe diskutojnë materialin e përgatitur prej tyre. Ata arrijnë në përfundim në lidhje me karakteristikat, kompetencat dhe përgjegjësitë më të rëndësishme, që duhet t'i ketë kujdestari (kreu) i klasës. Nxënësit shkruajnë përfundimet në skedat e letrës.

Secili grup ngjit parapëlqimet e tij në foton e *superheroit*, të vendosur në tabelë ose në dërrasën e zezë.

Mësuesi fillon diskutimin me anë këtyre pyetjeve:

- Cila është kompetenca më e rëndësishme që duhet të ketë kreu i klasës?
- Kur do ketë nevojë kreu i klasës për mbështetje nga të tjerët?
- A duhet patjetër që kreu (kujdestari) i klasës të jetë një *superhero*?
- Në cilat situata kreu i klasës do të jetë njëlloj si gjithë të tjerët?
- Çfarë dobësish mund të ketë kreu (kujdestari) i klasës?
- Në çfarë rrethanash e mendoni se kreu i klasës duhet të zëvendësohet prej dikujt tjetër? Si?
- Cilat janë dëshirat e pamundura për t'u realizuar nga kreu (kujdestari) i klasës?

Pas diskutimit, nxënësve u jepet detyra të përfytyrojnë veten në garë për postin e kreu të klasës. Ata duhet të mendojnë për përgjegjësinë dhe kompetencat, që ata diskutuan dhe të vlerësojnë vetveten nëse ata do ishin në gjendje të merrnin këtë detyrë.

Mësuesi i fton nxënësit të regjistrojnë emrat e tyre në një copë letre, nëse janë të interesuar që të marrin këtë pozicion.

Mësimi 2

Djem të mirë, djem të këqij?

Cili është roli i politikanëve në demokraci?

Objektivat e mësimimit	Nxënësit kuptojnë idenë se një person mund të përfaqësojë një grup njerëzish. Ata zhvillojnë më tej kuptimin për konceptin e delegimit të fuqisë dhe përgjegjësisë.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit krahasojnë mendimet e tyre për skemën e përfaqësimit politik në një demokraci. Ata diskutojnë pikëpamjet e tyre për politikanët duke bërë krahasimin me mendimet e njerëzve të tjerë. Ata kryejnë intervista të shkurtra për të realizuar këtë gjë.
Burimet	Skema e përfaqësimit politik, lapsa, letër.
Metoda	Punë individuale, punë në çifte, diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimimit

Nxënësve iu paraqitet skema e përfaqësimit politik (fleta e punës). Mësuesi prezanton konceptin e delegimit brenda shtetit dhe shpjegon se kryetarët e shteteve janë njëloj si krerët e klasës. Ata kanë pushtet të deleguar drejt tyre.

Mësuesi shpjegon skemën dhe sistemin e përfaqësimit.

Procesi i zgjedhjes së përfaqësuesve është i ndryshëm në sisteme të ndryshme shtetërore (për shembull, në një demokraci të drejtpërdrejtë ose një demokraci të përfaqësuar).

Duke punuar individualisht, nxënësit plotësojnë hapësirat në fletën e punës. Pastaj formojnë çifte dhe diskutojnë dhe shkëmbejnë informacionin që kanë për politikanët. Pyetjet e mëposhtme mund të jenë të dobishme për këtë qëllim:

- Çfarë mendoni për politikanët?
- Cilin politikan njihni ju?
- Çfarë duhet të bëjnë politikanët?
- Çfarë nuk duhet të bëjnë politikanët?
- Pse kaq shumë njerëz mendojnë se politikanët janë të këqij?

Në vijim, nxënësve u jepet detyrë të zhvillojnë intervista dhe të pyesin njerëz të tjerë për mendimet e tyre për politikanët dhe kompetencat e tyre. Nxënësit shkruajnë pyetjet për pjesëtarët e familjes së tyre, për rrethin e miqve dhe komunitetin që i rrethon. Mësuesi i udhëzon ata të mbajnë shënime përgjigjet e njerëzve. Disa prej pyetjeve të intervistës mund të jenë:

- Cilat janë kompetencat që duhet të ketë një politikan?
- Pse mendoni se politikanët shpesh konsiderohen si të këqij?
- Çfarë karakteristikash duhet të ketë një politikan?
- Çfarë karakteristikash nuk duhet të kenë?

Nxënësit i kryejnë intervistat pas mësimimit dhe i sjellin rezultatet në mësimin e ardhshëm.

Mësimi 3

Një person bën çdo gjë, pjesa tjetër nuk bën asgjë.

Cilat janë rolet në sistemin e përfaqësimit dhe kush duhet t'i luajë ato?

Objektivat e mësimi	Nxënësit reflektojnë për përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicioneve të ndryshme dhe kuptojnë procesin e zgjedhjeve dhe pasojat e tij.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit paraqesin rezultatet e intervistave të tyre në klasë. Ata përcaktojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicioneve të ndryshme dhe zgjedhin kreun (<i>kujdestarin</i>) e klasës.
Burimet	Tabelë, lapsa, skedat e zgjedhjeve, lista e nxënësve të interesuar për pozitën e kreut të klasës, kopje të materialit të shtypur.
Metoda	Diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit sjellin në klasë rezultatet e intervistave të tyre nga mësimi 2. Rezultatet paraqiten me anë të një fjalie, nga çdo nxënës. Mësuesi i shkruan përgjigjet në lidhje me kompetencat e politikanëve në tabelë ose në dërrasën e zezë, në mënyrë që nxënësit të mund të vënë në dukje prirjet në përgjigjet e dhëna.

Mësuesi i kthehet pyetjes e që lidhet me kreun e klasës si funksion politik. Lista e emrave të të gjithë nxënësve të interesuar për këtë pozicion vendoset në dërrasën e zezë. Mësuesi sqaron që për të ditur për kë të votojnë, klasa duhet të dijë më shumë për kreun e ardhshëm të klasës dhe rreth kompetencave dhe ideve të tij. Kandidatëve iu kërkohet të bëjnë një prezantim të shkurtër për veten, që nuk duhet të zgjasë më shumë se dy minuta. Fokusi kryesor i prezantimeve të tyre duhet të jetë "Çfarë do të bëj unë".

Pasi të gjithë kandidatët kanë paraqitur veten, nxënësve duhet t'u jepet mundësia për të bërë pyetje. Ata mund t'i drejtohen një personi individualisht, por mund të bëjnë pyetje të cilave duhet t'u përgjigjen të gjithë kandidatët.

Pas kësaj, nxënësit votojnë për kandidatët. Mësuesi paraqet dy lloje të ndryshme votimi: votimi i hapur dhe votimi i fshehtë. Nxënësit vendosin se cilën procedurë duan të ndjekin.

Në qoftë se vendosin për votim të fshehtë, ata duhet të plotësojnë emrin e kandidatit të tyre të dëshiruar në fshehtësi. Pastaj duhet t'i hedhin fletët e votimit në një shportë ose kuti. Dy nxënës duhet të jenë përgjegjës për numërimin e votave dhe për të shënuar rezultatet në tabelë ose në dërrasën e zezë.

Nxënësit që numërojnë votat shpallin emrin e personit që zgjidhet si kreu i klasës, si dhe emrin e atij që vjen i dyti, pasi ai do të jetë nënkryetari (zëvendës kujdestari) i klasës.

Mësuesi u jep nxënësve detyrën e mëposhtme për të bërë në shtëpi: "Shkoni në shtëpi dhe pyesni prindërit tuaj se kur votuan për herë të fundit në zgjedhje, çfarë lloj zgjedhesh ishin, ku u zhvilluan dhe si ishin organizuar." (Mësuesi duhet të kujdeset që nxënësit të mos u kërkojnë prindërve se për cilët kandidat kanë votuar etj.). Përdorni fletën e punës për këtë detyrë.

Mësimi 4

Ndarja e pushtetit

Cilat janë kriteret që përcaktojnë sistemin e përfaqësimit?

Objektivat e mësimi	Nxënësit njihen me konceptet e rizgjedhjes dhe mos-përzgjedhjes. Ata reflektojnë kriteret për përcaktimin e sistemit të përfaqësimit.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit diskutojnë dhe përcaktojnë kriteret që i lejojnë ata që të kontrollojnë puna e kreut (<i>kujdestarit</i>) të klasës.
Burimet	Tabelë, lapsa.
Metoda	Diskutim plenar.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit sjellin përgjigjet e prindërve të tyre për zgjedhjet në klasë. Ata ulen në grupe me nga katër vetë dhe diskutojnë për to.

Në vijim, mësuesi u lexon nxënësve një histori në lidhje me kryebashkiakun e një qyteti të vogël.

Na ishte një herë një qytet i vogël i quajtur Bortaun ku njerëzit ishin të pakënaqur. Kishte disa arsye për këtë. Bortaun nuk ishte shumë interesant dhe e vetmja gjë që mund të bëhej ishte të vizitonte parkun e qytetit. Nuk kishte as dyqane interesante, as koncerte dhe as vende për aktivitete sportive. Nuk kishte as edhe ndonjë kënd lojërash për fëmijët, as edhe në kopshtin e fëmijëve ose në shkollë. Popullit të Bortaunit i mbetej vetëm të shëtiste në park, të ulej dhe të shihte pellgun me ujë. Fëmijët ktheheshin në shtëpi nga shkollë, bënë detyrat e shtëpisë, shkonin në park e vraponin rreth pellgut. Në mbrëmje, njerëzit në Bortaun nuk kishin asgjë për të treguar, as përvojën e duhur dhe as kujtime për t'i ndarë me njëri-tjetrin. Një ditë ishte njëlloj si tjetra për popullin e Bortaunit. Pse ishte kjo gjendje? A ishte Bortaun tepër i varfër, për të ndërtuar ndërtesa të reja? A ishin njerëzit në Bortaun tepër dembelë për të bërë ndonjë gjë? Jo, padyshim jo. Vetëm se nuk ishte askush në krye të punëve për të organizuar gjërat si duhet, me sa duket, askush nuk dëshironte të merrte përgjegjësi për të filluar në ndryshimin. Ndryshe nga shumë qytete të tjera të vogla, Bortauni nuk kishte një kryetar të qytetit, një kryebashkiak.

Meqenëse, situata në Bortaun ishte bërë e padurueshme, një të diel, një grup njerëzish në park vendosën të zgjedhin dikë që të ishte në krye të Bortaunit. Ata vendosën të zgjidhnin një kryebashkiak. Diçka duhej të ndryshonte! Dhe shpejt!

Nuk ishin shumë njerëz që dëshironin ta bënë këtë punë. Vetëm dy kandidatë qëndruan në listë për zgjedhjet. Njëri nga kandidatët ishte mësuesi i zonës, zoti Knoules, i cili donte të ndryshonte gjërat që kishte në shkollë dhe jashtë saj. Ai kishte disa mendime si ta bënte këtë, por kur njerëzit e pyesnin se çfarë do të ndryshonte në Bortaun, ai u tha se, për momentin, nuk e dinte dhe se më parë ai duhej të pyeste banorët e qytetit se çfarë mendonin dhe çfarë u nevojitej. Shumë njerëz mbeteshin të zhgënjyer. Ata kishin menduar se zoti Knoules do të dilte me disa ide: për një qendër të madhe tregtare me kinema dhe një sallë ushqimi. Ata mendonin se, më në fund, do të kishin pishinë e madhe të notit që ëndërronin. Ata mendonin se zoti Knoules do të premtonte të ndërtonte një sallë koncertesh. Çfarë zhgënjimi ishte ky për banorët e Bortaunit!

Ndërkaq, kur kandidati i dytë, Z. Slimington, doli në skenë, populli i Bortaunit nuk priste shumë prej tij. "Kjo është humbje kohe; asgjë nuk do të ndryshojë në Bortaun," tha një nga pleqtë. "Unë mendoj se keni të drejtë", pëshpëriti një grua plakë pranë tij. Mr Slimington, një i ri bukurosh, filloi fjalimin e tij. Foli shumë për Bortaunin si vendlindjen e tij, duke përmendur edhe shkollën, parkun ku ishte rritur, si dhe mjaft gjëra të tjera që duhej të ndryshonin në Bortaun. Ai foli edhe për

terrenet sportive, aq të nevojshme për fëmijët, madje foli edhe për pishinën e re të notit, që të gjithë e donin, përmendi sallën e koncerteve të shumëpritur, madje përmendi edhe një sallë patinazhi për të rinjtë. Fjalimi i Z. Slimington bëri që fytyrat e njerëzve të Bortaunit të ndriçonin nga gëzimi. Papritmas të gjithë u qeshën. "Ndoshta ne e kishim gabim", pëshpëriti përsëri gruaja e moshuar. "Po, ndoshta", u përgjigj edhe plakuri, që tashmë përfytyronte dëshirën e madhe për të notuar në pishinën e re.

"Si do t'i paguajmë këto?" pyeti Z. Slimington audiencën. "Nuk ka problem! Unë sugjeroj që ne të gjithë të vëmë së bashku një pjesë të kursimeve tona dhe do të ndërtojmë gjërat e njëra pas tjetrës. Në këtë mënyrë do të fitojmë të gjithë diçka". Kjo iu duk e hapur dhe e drejtë popullit të Bortaunit. Kur zgjedhjet u zhvilluan të dielën në vijim, vetëm dy njerëz nga i gjithë Bortauni nuk votuan për z. Slimington. Ai ishte fitues i qartë. Dy njerëzit e vetëm që kishin votuar për z. Knoules, ishin ai vetë dhe e ëma e tij. Por, tani gjërat do të ndryshonin në Bortaun. Të gjithë e dinin këtë. Më në fund, ishte dikush që kish ide të qarta se çfarë do të bënte dhe sesi do të paguhej për to. Nuk kishte asnjë dyshim se kushdo që e donte me gjithë mend Bortaunin do t'ia jepte Z. Slimington të gjitha paratë e kursyera në vite - dhe ai i mori me kënaqësi të gjitha paratë që njerëzit ia dhanë.

Për një kohë të gjatë pas zgjedhjeve, populli i Bortaunit ishte i gëzuar, pasi e dinte që, së shpejti, do t'i kishte të realizuara të gjitha gjërat që ata dëshironin. Muaj të tërë shkuan, por ende nuk po shfaqeshin ndërtimet në Bortaun; nuk shiheshin fadroma për të filluar punimet e ndërtimit dhe, gjëkund, nuk qenë parë punëtorë të punonin për ndërtimet e reja.

Një pasdite, një makinë i ra për qark Bortaunit, me në krye diçka qesharake, në formë rrethore dhe me ngjyrë blu. "Ka ardhur pishina jonë", bërtiti një nga djemtë e vegjël në oborrin e shkollës. Britma e tij u shoqërua me një e "Bukur" nga gjithë të tjerët. Por, ajo që zbuluan vetëm disa ditë më vonë ishte se pishina që dërguar në shtëpinë e z. Slimington dhe ishte montuar në kopshtin e tij. Njerëzit filluan të çuditen. Disa filluan të dyshojnë në premtimet e tij, por disa ende besonin se pishina e tyre do të ndërtohej së shpejti. Megjithatë ata vendosën të tregohen të durueshëm.

Vetëm një javë më vonë, një grup njerëzish të moshuar panë një makinë të madhe të shtrenjtë, që shndrinte nga ari dhe shkëlqente në rrezet e diellit. "Ha! Ha!" Ndoshta, ndoshta do të ketë ndonjë vizitë prej Mbretëreshës" bëri shaka një nga pleqtë. Të tjerët u bashkuan me të qeshura, derisa panë që pas timonit u ul Z. Slimington. Në vend të përdorte paratë për terrenet e reja sportive, ai i kishte blerë vetes një makinë të re. Njerëzit në Bortaun u mërzitën edhe më tepër.

Një javë më pas ndodhi një incident tjetër. Z. Leterman, postieri ynë, që po kthehej në Bortaun nga ecejaket e tij të përditshme, u thoshte shokëve të tij se çfarë i kishte ndodhur atë ditë. "A e merrni dot me mend, kur unë... po kthehesha nga vila e Z. Slimington, dëgjova një zhurmë që dukej si për të qeshur, diçka si tingujt që lëshon një elefant. Kështu që m'u desh të ndaloja, për të hedhur një vështrim nga më afër. "Dhe, çfarë patë?" e pyetën shokët, që po e dëgjonin me interes. "Kjo duket se është një gjë e pabesueshme; kur vura re përmes gardhit metalik, pashë një elefant i madh. Pikërisht ky elefant e kishte bërë atë zhurmë të tmerrshme". "Vërtet?" e pyetën miqtë e tij me mosbesim. "Po, me të vërtetë, derisa unë zbulova se ishte vetëm një film. Veçse unë, më parë, kurrë nuk kisha parë një ekran kinemaje të tillë, kaq të madh! Atëherë i thashë Z. Slimington se ai paskej ndërtuar për vete një kinema kaq të madhe, kinemanë më të madhe në botë!" Askush nuk mund ta besonte këtë. Çfarë kishte ndodhur me sallën e tyre të koncerteve? Njerëzit në Bortaun u mërzitën aq sa s'tregohet. Por çfarë mund të bënin ata? Në fund të fundit, ata kishin votuar për të.

"Kjo nuk është puna ime", tha zoti Knoules, mësuesi, kur një grup i banorëve, që kishin vendosur më parë për të mbajtur zgjedhjet në qytet, erdhën për t'i kërkuar një këshillë. "Ju votuat për të dhe tani ai është kryetari i Bortaunit", theksoi Z. Knoules. "Sigurisht, por kjo është e padrejtë", thanë banorët. "Ai e ka përdorur edhe pjesën tjetër të parave që do të përdorej për parkun dhe për patinazhin, për të ndërtuar për vete një restorant të preferuar, në kopshtin e tij. Tani ai mund të hajë sa të dojë çdo ditë hamburgerë e suflaqe. Dhe ne të gjithë, ende rrimë ulur në park dhe mërzitemi, dhe fëmijët tanë ende janë ulur aty në park dhe mërziten". "Unë e di, e kam të qartë", tha Z. Knoules, duke mbyllur paksa sytë dhe duke fërkuar mjekrën me dorë. "Unë e di, e kam të qartë dhe ne duhet të bëjmë diçka ..."

Në grupet e tyre, nxënësit diskutojnë si mund të vazhdojë historia, duke u fokusuar në tri pyetje:

- Çfarë mund të bënte populli i Bortaunit më parë?
- Çfarë mund të bënin ata tani? Në fund të fundit, ata kishin votuar për z Slimington, si i pari i vendit.
- Si mund të pengojë kjo për më tej?

Nxënësit shkruajnë përgjigjet e tyre në një fletë letre dhe e paraqesin para klasës në diskutimin plenar.

Pasi të gjitha grupet kanë paraqitur idetë e tyre, mësuesi e fillon diskutimin duke bërë pyetjet e mëposhtme:

- Si mund të jemi të sigurt se kreu i klasës që do bëjë ato për të cilat kemi rënë dakord?
- Cilët mekanizma do të na e sigurojnë këtë?
- Kush mund ta bëjë këtë gjë?
- Çfarë do të ndodhë, në qoftë se ne zbulojmë diçka të gabuar?
- Kush mund të vendosë për një ndryshim të drejtuesit të klasës?

Nxënësit e diskutojnë këtë në seancë plenare dhe japin sugjerimet e tyre. Ata votojnë për sugjerimet dhe vendosin për një zgjidhje të përbashkët. Marrëveshja, tashmë, është shkruar dhe nënshkruar prej të gjithëve, duke përfshirë kreun e klasës dhe zëvendësin e tij (të saj).

KAPITULLI 7

Përgjegjësia

Arsimi fillor

Unë bëhem *eko* ... merr pjesë edhe shkolla ime!

7.1 Përgjegjësia

Nxënësit diskutojnë bazat e përgjegjësisë

7.2 Shkolla është jetë: ekologjia e gjallë?

Sa ekologjike është shkolla jonë?

7.3 Si mund të filloj të jem i përgjegjshëm?

Nxënësit ndërmarrin hapat e parë për ta bërë më ekologjike shkollën e tyre

7.4 Si e bëjmë - cili është plani?

Nxënësit reflektojnë për aktivitetet që bëjnë dhe vendosin si të vazhdojnë më tej

Kapitulli 7: Koncepti kyç - "Përgjegjësia" (për arsimin fillor) Informacion për mësuesit: Në ç'mënyrë, vlerat e nxënësve pasqyrojnë perceptimet e tyre rreth konceptit të të drejtave të njeriut?

*Mirë se vini në mëngjesin tim, mirë se vini në ditën time
Unë jam përgjegjës, dhe çdo gjë e kam bërë kështu
Që t'i shkrepja disa foto, për të parë se ç'mund të sjellin
Mendoj se i kam bërë të përkryera, dhe s'do të ndryshoja asgjë
Nga kënga Lamtumirë Andromeda (1973) nga Xhon Denver*

Në ditët e sotme, fëmijët mësojnë të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre që në moshë të re. Kjo pranohet në shumë familje dhe shoqëri. Një shtet demokratik mund të funksionojë vetëm në qoftë se qytetarët nuk kërkojnë se çfarë mund të bëjë shteti për ta, por çfarë ata mund të bëjnë për shtetin. Kjo ide bazohet në thënien e Xhon F. Kenedi: "Mos pyesni se çfarë mund të bëjë vendi juaj për ju – por kërkon se çfarë ju mund të bëni për vendin tuaj".

Ekzistojnë lloje e shkallë të ndryshme të përgjegjësisë. Përgjegjësia mund të jetë vetjake, kolektive ose morale. Kemi përgjegjësi të parlamentit, të qeverisë apo të medieeve. Kemi edhe përgjegjësi për edukimin e prindërve ose të mësuesve etj. Këto forma të përgjegjësisë mund të kenë një bazë ligjore ose të përfaqësojnë vlerat morale.

Në këtë kapitull, nxënësit kuptojnë se ekzistojnë forma të ndryshme të përgjegjësisë dhe se ato, shpesh herë, ngatërrohen. Gjëja më e rëndësishme për ne është se nxënësit fillojnë të kuptojnë që marrja e përgjegjësive për mjedisin e tyre rrethues është edhe kontribut për komunitetin. Duke vepruar kështu, nxënësit nuk kontribuojnë vetëm në jetën e komunitetit, por edhe fitojnë pushtet dhe ndikim. Në varësi të situatës ose të traditës politike në vend (ose në varësi të traditës së shkollës si trup qeverisës), marrja e përgjegjësive dhe fitimi i pushtetit mund të jetë e lehtë, por mund të jetë edhe shumë vështirë. Përgjegjësia e mohuar krijon zhgënjim në jetën e përditshme dhe duhet të analizohet dhe kapërcehet.

Qeniet njerëzore e fitojnë aftësinë për gjykim moral që në moshë të re dhe e kuptojnë se kur janë duke vepruar me përgjegjësi dhe kur jo. Megjithatë, në arsimin fillor, është e rëndësishme që të mos e kufizojnë veten vetëm me të mësuarit social dhe moral. Për më tepër, nëse vendosim ta bëjmë këtë në kuadër të EQD/EDNJ, me parimet e saj të nënkuptuara të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe instrumenteve të saj ligjore, synimet që janë vendosur paraprakisht do të zgjerohen. Reflektimi për përvojën e fituar përmes marrjes së përgjegjësive, të çon në një kuptim më të gjerë të vetes si qytetar. Për më tepër, kjo përvojë çon jo vetëm në përgjegjshmëri më të madhe, por edhe në marrjen e përgjegjësive, gjithmonë, si diçka të natyrshme.

Ashtu si në vargjet nga kënga e Xhon Denver, të treguar në fillim: *Unë jam përgjegjës dhe çdo gjë e kam bërë kështu*, nxënësit duhet të mësojnë të marrin përgjegjësi. Ata duhet të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e vendimeve të tyre. Mësimi dhe të jetuarit në demokraci në shkollë do të thotë se shkolla është vendi ku përgatitemi për jetën, por edhe vendi në të cilin jetojmë dhe vendosim së bashku. Është e qartë për të gjithë se ekzistojnë ndarje të qarta të roleve dhe, për këtë qëllim, janë të domosdoshme ligjet dhe rregullat. Megjithatë, në shumicën e shkollave në mbarë botën, potenciali i dhënies më shumë hapësirë për nxënësit dhe dorëzimi i më shumë përgjegjësive për ta, ende nuk është i përhapur. Mësuesit dhe drejtorët mund të ndryshojnë mjaft lehtësisht këtë situatë në kuadrin e rregullave dhe ligjeve ekzistuese.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e mëposhtëm të kompetencës.

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	**	***

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

- Huluntim në biblioteka
- Huluntim në internet
- Kryerja e intervistave dhe sondazheve
- Interpretimi i imazheve
- Harta mendore
- Krijimi i posterave
- Organizimi i ekspozitave
- Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve
- Përgatitja e sliderave për projektor ose një prezantim në *PowerPoint*
- Shkrim artikujsh ne gazeta
- Vënia e një shfaqjeje
- Debate të përbashkëta

KAPITULLI 7: Përgjegjësia-Unë bëhem *eko ...* merr pjesë edhe shkolla ime!

Në ç'mënyrë, vlerat e nxënësve pasqyrojnë perceptimet e tyre rreth konceptit të të drejtave të njeriut??

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Përgjegjësia	Nxënësit mendojnë rreth përgjegjësive si një çështje që është e lidhur me njerëz, objekte ose detyra.	Nxënësit mbledhin dhe analizojnë gazeta dhe revista që lexohen në komunitetin e tyre. Ata krijojnë një poster në të cilën nxjerrin në pah rezultatet e tyre.	Materiali i shkruar.	Punë në grupe.
Mësimi 2: Shkolla është jeta: ekologjia e gjallë?	Nxënësit kuptojnë se shkolla nuk është vetëm vendi i të mësuarit por edhe një vend për të jetuar. Ata planifikojnë të marrin përgjegjësi (ekologjike) për këtë "hapësirë ku jetojnë".	Zhvillohen e planifikohen mundësi të ndryshme për sjellje ekologjike.	Materiali i shtypur.	Prezantime në grupe, diskutim plenar.
Mësimi 3: Si mund të fillojmë të jemi të përgjegjshëm?	Nxënësit planifikojnë zbatimin konkret të hapave individuale. Ata bëjnë kompromis në grup	Nxënësit përdorin kohën e caktuar për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.	Puna individuale e varur nga plani i veprimeve.	Zbatim praktik.
Mësimi 4: Si e bëmë - cili është plani?	Nxënësit përpiqen të ndryshojnë këndvështrimet në mënyrë që të kuptojnë çfarë do të thotë marrje e përgjegjësive në pozicione të tjera.	Nxënësit transferojnë përvojat që ata kanë pasur kur punonin në grupe të vogla, në situata të tjera.	Materiali i shtypur.	Diskusim plenar, puna në grup.

Mësimi 1

Përgjegjësia

Nxënësit diskutojnë bazat e përgjegjësisë

Objektivat e mësimit	Nxënësit mendojnë rreth përgjegjësive si një koncept që lidhet me njerëz, objekte ose detyra.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit mbledhin dhe analizojnë gazeta dhe revista që lexohen në komunitetin e tyre. Ata krijojnë një poster në të cilën nxjerrin rezultatet e tyre.
Burimet	Fletë pune.
Metodat	Punë në grupe.

Informacion

Përgjegjësia, si koncept, i ka rrënjët e saj në kontekstet politike të shekujve të 18-të dhe të 19-të, kur veprimi i përgjegjshëm dhe parimet e qeverisjes përfaqësuese u bënë shqetësim i shoqërisë. Në filozofinë e shekullit të 20-të, theksi u vu në çështjen e vullnetit të lirë: a ishte personi përgjegjës për veprimet e kryera ose për karakterin e tij? Diskutimi përqendrohej më shumë në personin si individ.

Si rezultat, sot është e vështirë të kuptohet koncepti i përgjegjësisë kolektive, e cila është një çështje emergjente në politikën bashkëkohore. Kjo ndodh edhe për shkak se shumë punë e detyra të përditshme, që lidhen me përgjegjësinë, për shembull, llogaridhënia e ndërsjellë, përcaktimi sferës së përgjegjësisë së një personi, ose gjykimi i një personi për të qenë sa duhet përgjegjës për një rol të caktuar, duhet të merren parasysh.

Përshkrimi i mësimit

Nxënësit ulen në karriget e tyre në formën e një rrethi. Mësuesi vendos, në mes të rrethit, një tabelë ose fletë të madhe letre me titull "Marrja e përgjegjësisë për ...". Rreth tabelës mësuesi vendos fotografitë e marra nga revistat që tregojnë, për shembull:

- I përkëdheluri 1
- I përkëdheluri 2
- I përkëdheluri 3
- Grupe njerëzish
- Një person i vetëm
- Një fëmijë i vetëm
- Një liqen/një lumë
- Ushqime
- Mobilie
- Një zemër
- Plehra.

Pas kësaj, mësuesi, në mënyrë rastësore, vendos skedat me fjalë në dysHEME. Këto kanë emrat e sendeve të treguara në fotografitë e shkruara në to.

Pasi nxënësit kanë përfunduar së pari fotot, mësuesi u kërkon që ato t'i përputhin me skedat me fjalë. Teksa përfundon kjo fazë, mësuesi kërkon nga klasa të mendojë për problemin në vijim:

- Çfarë do të thotë të marrësh përgjegjësi për diçka ose para dikujt?
- Mendoni për një përvojë të vështirë. Çfarë ishte e vështirë në të dhe çfarë ju pëlqeu?

Është e rëndësishme që mësuesi, fillimisht, të parashtrojë problemin kryesor dhe më pas të formojë grupet dyshe të nxënësve për të punuar me të. Përndryshe, vëmendja e nxënësve do të jetë e përqendruar në formimin e çifteve dhe jo në zgjidhjen e problemit.

Nxënësit diskutojnë problemin në çifte për disa minuta e, më pas, i bëjnë të njohura mendimet e tyre para tërë klasës. Jo të gjithë nxënësit do të kenë mundësi të japin mendimet e tyre, por kjo do ndryshojë për sa kohë mësuesi bën kujdes që, jo gjithmonë, para klasës, të dalë e të flasë i njëjti person.

Pas një diskutimi të shkurtër, nxënësve u jepen detyra të mendojnë rreth profesioneve të ndryshme dhe si mund të të merret e të organizohet përgjegjësia për një punë apo pozicion të veçantë:

- Duke marrë përgjegjësinë për veten;
- Marrja e përgjegjësive për të tjerët;
- Marrja e përgjegjësive për gjërat.

Mësuesi i kërkon një nxënësi të shkruajë një liste profesionesh ose punësh, në tabelë ose në dërrasën e zezë.

Në çerekun e fundit të orës së mësimi, nxënësve u jepen detyra për të prodhuar një tekst të shkurtër (në të njëjtat çifte) dhe ta përfundojnë atë tekst si detyrë shtëpie.

Detyra:

"Zgjidhni një punë ose profesion nga lista. Ndoshta ju njihni dikë që e bën këtë punë. Nëse dëshironi, mund të zgjidhni edhe një punë ose profesion që mungon në listë. Shkruani një tekst të shkurtër në lidhje me këtë punë dhe përgjegjësitë e personit që e bën atë lloj pune:

- Përshkruani punën që duhet të bëhet nga bërësi i kësaj pune.
- Për kë duhet ai të marrë përgjegjësinë?
- Nëse personi nuk merr përgjegjësi, çfarë pasojash do të ketë për vendin, familjen, shkollën ose komunitetin?
- Ç'mund të jetë e vështirë për personin që e bën këtë punë?

Tekstet duhet të jenë shkruar në mënyrë të tillë që të mund të varen edhe në murin e klasës. Do të ishte më e dobishme, nëse çdo teksti do të bashkëngjiteti një vizatim, një ilustrim, një kolazh ose një foto për të krijuar një *poster*."

Mësimi 2

Shkolla është jeta: ekologjia e gjallë?

Sa ekologjike është shkolla jonë?

Objektivat e mësimit	Nxënësit kuptojnë se shkolla nuk është vetëm vendi i të mësuarit por edhe një vend për të jetuar. Ata planifikojnë të marrin përgjegjësi (ekologjike) për këtë "hapësirë ku jetohe".
Detyrat e nxënësve	Zhvillohen dhe të planifikohen mundësi të ndryshme për sjellje ekologjike.
Burimet	Fletët e punës.
Metodat	Prezantime në grupe, diskutim plenar.

Informacion

Të mësosh rreth ekologjisë do të thotë të jetosh në ekologji. Në këtë mënyrë, shkolla bëhet një vend i qytetarisë aktive. Qytetaria aktive mësohet më së miri duke vepruar. Individët kanë nevojë të kenë mundësi për të shqyrtuar çështjet e qytetarisë demokratike dhe të të drejtave të njeriut për veten e tyre, dhe jo t'u thuhet si të mendojnë a të sillen.

Edukimi për qytetari aktive nuk është vetëm për thithja e njohurive faktike - në këtë rast, rreth mënyrës sesi të ruhet mjedisi dhe të parandalohen dëmtimet e mëtejshme - por, përmes kuptimi të mirë praktik, të aftësive, qëndrimeve, karaktereve dhe vlerave.

Media është mesazhi - nxënësit mund të mësojnë nga qytetaria demokratike, sa nëpërmjet shembullit që ata marrin nga mësuesi dhe nxënësit e shkollës dhe nga mënyrat në të cilat organizohet jeta (ekologjike) në shkollë, aq edhe përmes metodave të mësimit dhe të mësuarit.

Përshkrimi i mësimit

Në pjesën e dytë të kapitullit, mësuesi duhet të sigurojë që tema do të ngushtohet e lidhet me kontekstin lokal. Së pari, mësuesi duhet të japë një përmbledhje të shkurtër të mësimit të kaluar. Duhet bërë e qartë se një komunitet që funksionon mirë kërkon edhe ndarje të përgjegjësisë ndërmjet shumë njerëzve.

Shkolla paraqitet si një komunitet, në të cilin jetohe dhe mësohet. Për këtë arsye, ajo mund të shihet si një *polis* (qytet-shtet), në të cilin duhet të zgjidhen problemet sociale dhe ekologjike. Ndër të tjera, shkolla duhet të bëhet një model për udhëzimet ekologjike dhe proceset lidhur me to dhe vëmendja duhet të përqendrohet në bërjen sa më mirë të kësaj pune. Ka shumë aspekte praktike në marrjen e përgjegjësisë. Nxënësve u kërkohet të mendojnë në lidhje me fushat e jetës shkollore në të cilat proceset ekologjike mund të përmirësohen dhe për atë që ata vetë mund të bëjnë në këtë drejtim.

Detyra tjetër ndërmerret në grupe me nga katër vetë. Çdo grupi i jepet një fjalë kyç. Grupet duhet të shkruajnë një listë me pyetje rreth kësaj fjale. Pyetjet e mëposhtme lidhen me fjalën "mbeturinat":

- Çfarë lloj mbeturinash prodhohen në shkollën tonë?
- Ku janë vendosur ato?
- Kush është përgjegjës për t'i grumbulluar ato?
- Si mund të pakësohet sasia e mbeturinave të shkollës?

- Çfarë mund të bëj unë ose klasa ime për këtë?

Për këtë detyrë duhet të llogaritet si afat kohor për hulumtime dhe për detyrat e shtëpisë edhe një mësim javën e ardhshme. Nëse mësuesi dëshiron ta shkurtojë atë, ai do të duhet të bëjë kërkimet dhe të marrë informacionet e duhura vetë. Nxënësit prodhojnë një listë të plotë me të dhëna që u paraqitet shokëve të klasës në "murin ekologjik".

Lista e fjalëve të mundshme kyç për grupet:

- Plehra
- Reduktimi i mbeturinave
- Energjia dhe fuqia
- Uji
- Transporti
- Shëndeti
- Mjediset e shkollës
- Bio-diversiteti
- Mbështetja e botës sonë
- Masat e përgjithshme ekologjike.

Mësimi 3

Si mund të filloj unë të jem përgjegjës?

Nxënësit ndërmarrin hapat e parë për ta bërë më ekologjike shkollën e tyre

Objektivat e mësimi	Nxënësit bëjnë planin e zbatimit konkret të hapave individual që ndërmarrin. Aspekte të tilla si menaxhimi realist i kohës, aftësia për të bërë kompromis në grup dhe fleksibiliteti i përgjithshëm duhet të jenë qëllimet e nxënësve.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përdorin kohën e caktuar për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.
Burimet	Veprimet individuale në varësi të planit të veprimeve.
Metodat	Zbatim praktik.

Përshkrimi i mësimi

Grupet e nxënësve bëjnë prezantime të shkurtra të listave të tyre. Për herë të parë në këtë mësim, mësuesi duhet të drejtojë një bashkëbisedim në lidhje me llojet e përgjegjësive ose pushtetit të vërtetë të nxënësve:

- Çfarë mund të ndryshojmë ne?
- Çfarë nuk duhet të ndryshojë?
- Çfarë lloj qëndrese do të ketë?

Pas këtij diskutimi plenar, duhet të merren disa vendime:

- Çfarë hapash duam të ndërmarrim?
- Sa kohë duhet të investojmë?
- A duhet të formojnë një " grup ekologjik" për këtë?
- A duam të përqendrohemi në një fushë (p.sh. uji, energjia elektrike ose mbeturinat) apo duam të përqijemi që të marrim masa të përgjithshme në të gjitha fushat ekologjike?

Është e rëndësishme që të zgjidhen detyra të realizueshme nga nxënësit. Kjo kërkon mbledhjen e informacionit dhe një fushatë ndërgjegjësimi në të gjithë shkollën.

Nën udhëheqjen e një grupi nxënësish ("grup ekologjik") duhet të hartohet një plan i shkurtër veprimi me detyra të përcaktuara që paraqiten në një tabelë, në një fletë të madhe letre ose në dërrasën e zezë.

Mësuesi drejton procesin e vendimmarrjes, në varësi nivelit të klasës. Është e rëndësishme që nxënësit të mbeten realistë dhe të mos planifikojnë ose projektojnë diçka që s'mund të arrihet me burimet ekzistuese. Mund të nevojiten shtesa financiare ose konsulta me organizata të tjera të jashtme. Këto vendime duhet të merren patjetër nga klasa.

Në varësi të vendimit, përmirësime të vogla duhet të jenë objekt i vendimmarrjes së përbashkët, për shembull, mbyllja, në orë të caktuara, e dritave, ndarja e mbeturinave në oborrin e shkollës në organike dhe jo-organike etj.

Këto detyra duhet të plotësohen para mësimi të ardhshëm, individualisht ose në grupe të vogla. Përvoja tregon se dokumentimi i këtyre proceseve me fotografi, vizatime etj., mund të jetë motivues i fuqishëm për nxënësit e tjerë.

Mësimi 4

Si e bëmë këtë - cili është plani?

Nxënësit reflektojnë për aktivitetet e tyre dhe vendosin si të vazhdojnë më tej.

Objektivat e mësimit	Në përfundim të këtij kapitulli, nxënësit përpiqen për të ndryshuar perspektivat në mënyrë që të kuptojnë çfarë do të thotë marrje e përgjegjësisë në pozicione të tjera. Ky është një hap më tej drejt një kuptimi më të thellë të pjesëmarrjes demokratike.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit transferojnë eksperiencat që kanë pasur kur kanë punuar në grupe të vogla për mjaft situata të tjera.
Burimet	Fletët e punës.
Metodat	Diskutim plenar, punë në grup.

Përshkrimi i mësimit

Ky mësim i katërt mund të zhvillohet për të përmbledhur Kapitullin 4. Megjithatë, mësuesit mund të përdorin këtë fazë për të filluar punën praktike. Puna praktike mund të përfshijë nxënësit që punojnë së bashku në grupe të vogla ose si klasë ose mund të marrë formën e një projekti të shkollës.

Mësimi duhet të fillojë në të njëjtën mënyrë siç është bërë në mësimin 1. Nxënësit ulen në një rreth dhe mendojnë afërsisht për atë që kanë mësuar nga gjithçka e zhvilluar në mësimet e mëparshme.

Ata fillojnë duke paraqitur rezultatet e hulumtimit të tyre:

- Çfarë është arritur?
- Çfarë nuk funksionoi?
- Çfarë u përmirësua apo u ndryshua?
- Çfarë do të thotë të marrësh përgjegjësinë për projekte ekologjike?
- A jam i gatshëm për të marrë përgjegjësi për diçka që "nuk është bërë për fajin tim"?
- Si mund ta shoh veten time?
- Çfarë më ka zhgënjyer mua? Çfarë më bëri të lumtur?

Për të ndihmuar nxënësit që të reflektojnë rreth asaj çfarë kanë arritur, përvoja ka treguar se është e dobishme të përdoret "muri ekologjik", i zhvilluar dhe zgjeruar gjatë gjithë kapitulli. Si pjesë e këtij diskutimi, duhet të bëhet e qartë se sa e rëndësishme është "marrja e përgjegjësisë" për një funksionim të mirë të komunitetit. Pyetjet e mëposhtme mund të përdoren për të nxitur diskutimin:

- Çfarë lloj komuniteti janë atje?
- Kush ndërmer dhe çfarë lloj roli merr?
- Si operon kjo punë në një shtet?
- Çfarë dimë ne për demokracinë dhe si funksionon një demokraci?
- Çfarë kuptoni me thënien e mëposhtme të Xhon F. Kenedi: "Mos pyetni çfarë vendi juaj mund të bëjë për ju, por kërkoni atë që ju mund të bëni për vendin tuaj"?

Edhe pse analogjitë mund të jetë ndonjëherë problematike: ato mund të jenë një hap interesant për t'u përdorur e për të nxitur nxënësit që të përdorin, që në këtë fazë, procese më komplekse të të menduarit.

Ata, me siguri, nuk kanë për të arritur në konkluzione përfundimtare. Është më e rëndësishme që ata të nxiten t'i mendojnë gjërat në kompleksitetin e tyre, proces që do të vazhdojë në kapitujt e mëvonshëm.

Nxënësve, që punojnë në grupe të vogla, u jepet fleta e punës për të shkruar përvojat e tyre:

Marrja e përgjegjësisë, ndarja e përgjegjësisë		
Shembull: Ekologjia		
Vendi/Situata	Çfarë përgjegjësie ka ky person?	
Klasa	Mësues	Nxënës
Shkolla	Drejtori	Mësues/nxënës
Shteti	Kreu i Shtetit	Populli
?		

Nxënësit duhet të mendojnë se kur dhe në çfarë situatë duhet të ndërmerret përgjegjësia. Pas një kohe të paracaktuar, një anëtar i grupit duhet të paraqesë rezultatet e të menduarit të të gjithë grupit. Gjatë diskutimit përfundimtar, mësuesi mund të sigurojë që paralelizmat ndërmjet përvojave në klasë dhe të situatave të përshkruara të jenë të dukshme. Gjithashtu ai ka përgjegjësinë t'u tregojë nxënësve kufizimet të mundshme që ekzistojnë në këtë drejtim.

Së fundi, gjatë një seance "flash" (çdo nxënës mund të përdorë vetëm një fjali për të shprehur mendimin e tij) nxënësit tregojnë çfarë kanë mësuar nga ky kapitull, për shembull:

- "Shpjegoni me një fjali atë që mendoni se ishte gjëja më e rëndësishme në këtë kapitull, në lidhje me "marrjen e përgjegjësisë".

Nxënësve u duhet thënë koha e duhur për të menduar çfarë do të thonë dhe për të bërë deklaratën e tyre. Kjo deklaratë duhet të bëhet nga çdo nxënës, edhe nëse të tjerët kanë thënë të njëjtën gjë ose diçka të ngjashme me të. Mësuesi duhet të marrë pjesë vetë në këtë ushtrim. Në fund, ai duhet të falënderojë nxënësit për pjesëmarrjen e tyre aktive, por nuk duhet të komentojë rreth deklaratave të tyre.

KAPITULLI 8

Të drejtat dhe liria

Arsimi fillor

Të drejtat e mia - të drejtat e tua

8.1 Dëshirat dhe nevojat: çfarë është e rëndësishme për mua?
Nxënësit mësojnë të bëjnë dallimin ndërmjet dëshirave dhe nevojave të tyre bazë.

8.2 Të drejtat e njeriut: çfarë thonë ato?
Nxënësit krahasojnë nevojat e tyre me nenet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

8.3 Anketim: çfarë mendojnë dhe njohin njerëzit rreth nesh
Nxënësit ndërmarrin një anketim të shkurtër për të drejtat e njeriut

8.4 Të drejtat e njeriut janë gjallë!
Paraqitja dhe diskutimi i rezultateve të anketës

Kapitulli 8: Koncepti kyç - "Të drejtat dhe liritë" (për arsimin fillor)

Informacion për mësuesit: të drejtat e njeriut:

Çfarë është e rëndësishme për mua? Për ju? Për të tjerët?

Të drejtat e njeriut mund të përkufizohen përgjithësisht si të drejta që janë të trashëguara nga natyra në jetën tonë dhe pa të cilat ne nuk mund të ekzistojmë si qenie njerëzore. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore na lejojnë të zhvillohemi plotësisht dhe të përdorim cilësitë tona njerëzore, inteligjencën tonë, talentet tona dhe ndërgjegjen tonë. Ato na lejojnë gjithashtu për t'u kënaqur shpirtërisht dhe për të plotësuar nevojat e tjera. Ato janë të bazuara në kërkesat në rritje të njerëzimit për një jetë, në të cilën dinjiteti i brendshëm dhe vlera e çdo qenieje njerëzore të respektohet dhe të mbrohet.

Ky kapitull mundëson informacionin bazë për mësuesit e shkollave fillore, të cilët dëshirojnë të nxitin ndërgjegjësimin dhe njohuritë për vlerat e të drejtave të njeriut, si dhe ndjenjën e reciprocitetit dhe universalitetit në të cilat bazohen standardet e të drejtave të njeriut. Kjo është vetëm një pikënisje, e cila duhet të plotësohet nga hulumtime dhe studime të mëtejshme dhe/ose duke përdorur manualet kombëtare dhe materialet audiovizive që janë tashmë në dispozicion. Këto, shpresojmë se do të përdoren për të filluar një proces të vazhdueshëm të përshtatjes dhe zhvillimit, në të gjitha nivelet e mësimdhënies, brenda kulturave të shumta e të larmishme në botë.

Dekada e Kombeve të Bashkuara për Edukimin e të Drejtave të Njeriut (1995-2004) ka përcaktuar edukimin për të drejtat e njeriut si "trajnim, përhapje dhe përpjekje për informim, që synojnë në ndërtimin e një kulture universale për të drejtat e njeriut, përmes dhënies së njohurive, aftësive dhe formimit të qëndrimeve, të cilat synojnë:

- a) Forcimin e respektimit të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.
- b) Zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut dhe të ndjenjës së dinjitetit.
- c) Promovimin e mirëkuptimit, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë midis të gjithë kombeve, popullsive vendase dhe grupeve të racave, kombësive, etnive, feve dhe gjuhëve të ndryshme.
- d) T'u bëhet e mundur të gjithë personave të marrin pjesë, në mënyrë efektive, në një shoqëri të lirë;
- e) Avancimin e aktiviteteve të Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes. (Përshtatur nga Plani i Veprimit të Dekadës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (1995-2004), paragrafi 2).

Ky proces varet nga sistemet lokale të arsimit, të cilat ndryshojnë gjerësisht, jo më pak edhe në shkallën në të cilën mësuesit duhet të përcaktojnë objektivat e tyre të mësimdhënies. Megjithatë, mësuesi do të jetë gjithmonë personi kyç për vënien në punë të iniciativave të reja dhe ka, kështu, përgjegjësinë e madhe në lidhje me komunikimin dhe promovimin e parimeve të drejtave të njeriut në klasë. Megjithatë, mësimi për të drejtat e njeriut nuk është i mjaftueshëm. Këto vlera duhet të përçohen në klasë së bashku, me vendimmarrjet demokratike dhe veprimet konkrete. Nxënësit do dëshirojnë jo vetëm të mësojnë për të drejtat njerëzore, por të mësojnë në dhe përmes tyre.

Fakti që Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut³ ka vlefshmëri dhe zbatueshmëri, pothuajse globale, është shumë e rëndësishme për mësuesit. Duke punuar me udhëzime që përkrahin gjerësisht prej kaq shumë viteve, mësuesi mund të thotë sinqerisht se ai po bën promovimin e një sistemi normativ, që është pranuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe qeveritë e tyre. Sistemet arsimore ndryshojnë mjaft nga njëri tjetri. Kur mësohen të drejtat e njeriut, mësuesit kanë edhe një mbrojtje të dytë, që ka të bëjë me faktin se ata po japin mësimin në një mënyrë të tillë që të respektojnë të drejtat e njeriut në klasë dhe në vetë mjedisin shkollor.

³ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 10 Dhjetor 1948.

Kjo do të thotë shmangie nga çdo lloj hipokrizie. Në shpjegimin e saj më të thjeshtë, hipokrizia ka të bëjë me situatat në të cilat lënda që mësuesi jep në mësim nuk përputhet me mënyrën sesi ai po e jep atë. Për shembull: "Sot ne do të flasim për lirinë e shprehjes - mbylle gojën ti në rreshtin e fundit!". Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë mjaft rreth pushtetit, por shumë më pak rreth të drejtave të njeriut dhe respektimit të dinjitetit të njeriut, të cilat qëndrojnë në thelbin e lirive të njeriut. Ndërkohë që nxënësit kalojnë mjaft kohë duke studiuar mësuesin për të kuptuar bindjet e tij personale, sjellje të tilla mund ta bëjnë të vështirë për një mësues, që të ketë ndikim real pozitiv në klasë. Për shkak të dëshirës për të kënaqur mësuesin, nxënësit, për shembull, mund të përpiqen të pasqyrojnë pikëpamjet vetjake të mësuesit, pa menduar për veten e tyre. Kjo mund të jetë një arsye, të paktën në fillim, pse nxënësit nuk shprehin idetë e tyre personale. Në formën e saj më komplekse, hipokrizia ngre probleme të mëdha për mbrojtjen dhe promovimin e dinjitetit njerëzor, si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit në klasë, si në një shkollë ashtu edhe brenda shoqërisë në përgjithësi. Kjo i nxit mësuesit të eksplorojnë mënyra dhe mjete që të përfshijnë edhe palë të tjera në procesin e vendimmarrjes për ato që duhen bërë dhe përse; kjo nënkupton jo vetëm përfshirjen e nxënësve, e administratorëve të shkollave, prindërve, por edhe, nëse është e përshtatshme, e anëtarëve të komunitetit në të cilin ata jetojnë dhe punojnë.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike është që të mbështesë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e mëposhtëm të kompetencës.

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	***	*

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

0 Hulumtim në biblioteka

0 Hulumtim në internet

x Kryerja e intervistave dhe sondazheve

x Interpretimi i imazheve

0 Harta mendore

0 Krijimi i posterave

0 Organizimi i ekspozitave

x Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

x Përgatitja e sliderave për projektor ose një prezantim në *PowerPoint*

0 Shkrim artikuj gazetash

0 Organizim shfaqjesh

0 Debate të përbashkëta

KAPITULLI 8: Të Drejtat dhe Liritë -Të drejtat e mia – të drejtat e tua? Të drejtat e njeriut: Çfarë është e rëndësishme për mua? Për ju? Për të tjerët?

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Dëshirat dhe nevojat	Nxënësit mësojnë se dëshira e tyre individuale – gjërat dhe idetë që ata do të donin t'i kishin dhe t'i realizonin – janë aq të rëndësishme sa edhe gjërat që qeniet njerëzore i kanë të nevojshme për të jetuar një jetë të mirë.	Nxënësit zgjedhin piktura që përfaqësojnë dëshirat dhe nevojat, diskutojnë dhe vendosin për to.	Spango rrobash, varëse rrobash, kapëse, copa të prera (fotografi) nga revista, material i shtypur.	Punë në grupe.
Mësimi 2: Të drejtat e njeriut: çfarë thonë ata?	Nxënësit mësojnë se Deklarata është në lidhje shumë të ngushtë me nevojat e njerëzve.	Nxënësit mendojnë rreth mësimit 1, duke përdorur një listë ose nene të zgjedhur nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.	Fleta e punës (Version i thjeshtuar i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut), lista të nevojave nga kapitulli 8, Mësimi 1.	Puna në grup, hulumtim.
Mësimi 3: Anketa: çfarë mendojnë dhe njohin njerëzit rreth nesh	Nxënësit e çojnë më tej përvojën e të mësuarit, nëpërmjet intervistimit të të rriturve, qëndrimeve që ata mbajnë dhe të drejtat e njeriut që ata njohin nga ana e tyre. Ata kuptojnë se sa ndryshojnë vlerësimet për të drejtat e njeriut.	Nxënësit përgatisin një vëzhgim dhe e praktikojnë, duke punuar me të në klasë. Anketa në vetvete duhet të bëhet si detyrë shtëpie gjatë javës së ardhshme.	Fleta e punës, letër, lapsa dhe stilolapsa.	Sondazhet në grupe.
Mësimi 4: Të drejtat e njeriut janë gjallë!	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm se si njerëz të ndryshëm kanë vlerësim të ndryshëm individual për të drejtat e njeriut, duke paraqitur rezultatet e sondazhit të tyre. Ata reflektojnë për proceset e të mësuarit dhe kështu mundësojnë transferimin e njohurive dhe të kompetencave.	Nxënësit e pranishëm diskutojnë rezultatet e sondazhit të tyre. Ata reflektojnë për të gjithë procesin e të mësuarit.	Letër A4.	Diskutim në grup, diskutim plenar.

Mësimi 1

Dëshirat dhe nevojat: çfarë është e rëndësishme për mua?

Nxënësit mësojnë të bëjnë dallimin ndërmjet dëshirave dhe nevojave të tyre bazë.

Objektivat e mësimit	Nxënësit mësojnë se dëshira e tyre individuale – gjërat dhe idetë ata do dëshironin ti kishin dhe realizonin – janë po aq të rëndësishme sa edhe gjërat që qeniet njerëzore i kanë vërtet të nevojshme për të jetuar një jetë të mirë.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit zgjedhin piktura që përfaqësojnë dëshirat dhe nevojat dhe diskutojnë e vendosin për to.
Burimet	Spango (tel rrobash), varëse rrobash, copa të prera (fotografi) nga revista, material i shtypu.
Metodat	Punë në grupe.

Informacion

Të drejtat e njeriut kanë dy anë: një natyrë etike dhe një ligjore. Edhe pse të drejtat e njeriut, në përgjithësi, janë konsideruar si të pandashme, është e qartë që çdo individ vendos për veten e vet se çfarë është e rëndësishme për jetën e tij. Më tej, është e rëndësishme të kuptohet, sidomos për adoleshentët, se jo të gjitha nevojat janë nevoja bazë, të njohura tashmë si të drejta në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Dallimi mes dëshirave dhe nevojave, respektimi i mënyrave sesi njerëzit mund të vlerësojnë të drejta të veçanta për të tjerët, dhe në të njëjtën kohë të pranojnë rëndësinë e kornizave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut është një proces afatgjatë i të mësuarit. Edhe pse aspektet ligjore të drejtave të njeriut, që nuk janë trajtuar në këtë mësim, mësuesit duhet të jenë gjithnjë të vetëdijsëm se Traktatet detyruese ligjore - të cilat qeveritë i nënshkruajnë dhe pranojnë ti zbatojnë – janë të bazuar në Kuadrin Normativ të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut. Në Evropë, traktati kryesor dhe ligjërishit i detyrueshëm, është Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut).⁴

Përshkrimi i mësimit

Klasa duhet të krijojë mundësinë që nxënësit të mund të ulen në grupe me nga katër deri në gjashtë vetë. Mësuesi duhet të vendosë të gjitha materialet e nevojshme për mësim në një tryezë të veçantë, nga e cila nxënësit mund të marrin atë që kanë *nevojë* dhe ta kthejnë në fund të mësimit. Pronësia është një faktor kyç në suksesin e EQD/EDNJ, ndaj dhe nxënësit bashkë me mësuesin duhet ta shohin klasën e tyre si një hapësirë jetese që u intereson dhe për të cilën kujdesen. Duhet të ketë sa më shumë copa të prera nga revistat, sa të jetë e mundur (me dhjetëra, ndoshta edhe disa qindra fotot) të mbërthyer në muret e klasës.

Mësuesi mbledh nxënësit përballë "murit të fotove" dhe i angazhon ata në diskutim përmes pyetjeve:

- Cilat ishin disa nga përvojat tuaja kur keni mbledhur fotot?
- A kishte diçka që ju habiti? Nëse po, çfarë?

Pas disa minutash bisede hyrëse, mësuesi i cakton dy nxënësve detyrën e mbajtjes së spangos së rrobave (rreth 4 metra e gjatë) dhe 12 kapëse rrobash. Pastaj, mësuesi merr dy skeda të përgatitura, me fjalët "dëshirat" dhe "nevojat" të shkruar për to. Ai var nga një kartë në të dyja anët e spangos dhe pastaj u kërkon nxënësve të mendojnë cilën prej fotove do të zgjedhin për të

⁴ ETS nr 5, e hapur për nënshkrim më 4 nëntor 1950, hyri në fuqi më 3 shtator 1953.

varur në anën e "dëshirave" dhe cilat në atë të "nevojave". Pasi të gjithë të kenë kanë menduar për këtë, mësuesi u kërkon dy nxënësve të varin sugjerimet e tyre dhe të shpjegojnë zgjedhjen e tyre. Më pas, mësuesi sqaron dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave së bashku me nxënësit, por duhet të kujdeset që të mos japë një përkufizim. Ai mbledh informacion nga nxënësit dhe u kërkon atyre të japin shpjegime për të.

Në grupe prej 4-6 vetash, nxënësve u jepet detyra që të zgjidhen 10 fotografi nga tërë ato që janë mbledhur, për të çuar 5 në kategorinë e "dëshirave" dhe 5 në atë të "nevojave". Secilit grup i jepet kjo detyrë me shkrim (Mësuesi shpërndan fletët e punës ose shkruan në tabelën e zezë.

Detyra dhe prezantimi:

- Nxënësit, të ndarë në grupe, duhet të zgjedhin 10 fotografi nga i gjithë koleksioni. Pesë prej tyre duhet të vendosen në kategorinë e "dëshirave" dhe pesë në kategorinë e "nevojave" (në se dy ose më shumë grupe dëshirojnë të njëjtën foto, mësuesi të përpiqet të gjejë një zgjidhje).
- Grupet duhet të diskutojnë zgjedhjet e tyre dhe përpiqen t'iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:
 - Pse është e rëndësishme kjo në jetën time?
 - Çfarë do të thotë në qoftë se unë nuk e kam këtë?
 - Çfarë dua që të kem apo të arrij më vonë në jetë?
 - Çfarë do të thotë kjo për mua si djalë / vajzë?
- 10 fotografitë e zgjedhura duhet të ndahen sipas rëndësisë dhe nxënësit duhet të shpjegojnë arsyen renditjen së e tyre. Ata duhet të gjejnë një zgjidhje që t'i përshtatet të gjithë anëtarëve të grupit.
- Dy anëtarë të grupit duhet të mbajë litarin e rrobave dhe një tjetër duhet të shpjegojë çdo zgjedhje. Vetëm zgjedhja e parë dhe e fundit duhet të shpjegohen. Në fund, nxënësit duhet të përpiqen të shpjegojnë me fjalët e tyre ndryshimin ndërmjet dëshirave dhe nevojave. A munden ata të gjejnë një "përkufizim" për të dyja?

Spangoja varet në mur (ose kudo tjetër në klasë), bashkë me të gjitha fotot e zgjedhura.

Mësimi 2

Të drejtat e njeriut: çfarë thonë ato?

Nxënësit krahasojnë nevojat e tyre me nenet e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut

Objektivat e mësimi	Nëpërmjet krahasimit të secilës nga nevojat e tyre me një nen në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, nxënësit kuptojnë se Deklarata është në lidhje shumë të ngushtë me nevojat e njerëzve.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit mendojnë rreth mësimi 1 duke përdorur një listë ose nene të zgjedhura nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
Burimet	Fleta e punës (Version i thjeshtuar i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut), lista të nevojave nga kapitulli 8 mësim 1.
Metodat	Puna në grup, hulumtim.

Përshkrimi i mësimi

Në fillim, mësuesi përmbledh rezultatet e mësimi 1. Ai bën lidhjen midis nevojave dhe të drejtave të njeriut dhe një prezantim të shkurtër të historisë së të drejtave të njeriut (shih të Drejtat e Njeriut në fletën e punës: një listë për të krahasuar të drejtat dhe nevojat). Mësuesi me këto të dhëna nuk duhet të zgjatet më shumë se 10 minuta.

Nxënësve u jepet detyra që të përputhin nevojat e tyre (të cilat i kanë përcaktuar) me të drejtat e njeriut, të treguar në listën e thjeshtuar të të drejtave të njeriut (fleta e punës). Ata duhet të punojnë në grupe të njëjta, si në mësimin e mëparshëm, dhe duhet të marrin parasysh pyetjet e mëposhtme: Cilat të drejta të njeriut janë të rëndësishme për ta, madje edhe në mënyrë të pandërgjegjshme? A munden ata të kuptojnë lidhjen mes të drejtave dhe nevojave? A mund të mendojnë për shembuj nga jeta reale që lidhen me një të drejtë të veçantë? Fletët e punës mund të ndihmojnë në këtë drejtim. Mësuesi duhet të vendosë nëse, do të punohet me këtë version të thjeshtuar të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut apo me dokumentin origjinal (në dispozicion nëpërmjet internetit) www.un.org/en/documents/udhr/).

Përdorimi i versionit të thjeshtuar, duhet ti bëjë nxënësit të jenë në gjendje të njohin mjaft shpejt që të drejtat e njeriut janë zhvilluar në bazë të nevojave të përditshme.

Shembull nga fleta e punës:

Lista e të drejtave themelore	“Nevojat” që kemi përcaktuar	Cilit nen të Deklaratës origjinale të drejtave të njeriut i përket kjo?
<i>E drejta për të jetuar, ekzistuar</i>		
<i>E drejta për të punuar</i>		
<i>E drejta e pronës</i>		
<i>E drejta e fjalës së lirë</i>		
...		

Nxënësit duhet të përipiqen të kopjojnë listën e tyre të nevojave nga mësimi i mëparshëm prej fletës së punës. Kjo nuk do të jetë shumë e lehtë, pasi formulimi i të drejtave dhe nevojave nuk do të jetë i njëjtë. Megjithatë, kjo mund të nxisë diskutimet dhe marrjen e vendimeve, që jo gjithmonë janë të qarta. Kjo bëhet qëllimisht.

Në një hap të dytë, grupet që kanë përfunduar duhet të krahasojnë listën e tyre me origjinalin e Deklaratës së të drejtave të njeriut.

Në fund të mësimit, duhet të përgatitet një listë e klasës. Kjo do të thotë se listat e grupit duhet të jenë kopjuar në një listë më të gjerë, e cila do të paraqitet për të gjithë. Nëse janë në dispozicion kompjuterë, nxënësit mund të bëjnë një listë elektronike, duke përdorur si model fletën e punës. Kjo detyrë mund të caktohet për një grup të vogël nxënësish që mund ta përfundojnë këtë si detyrë shtëpie. Nëse është e nevojshme, mësuesi mund ta hartojë vetë listën.

Mësimi 3

Anketa: Çfarë mendojnë dhe dinë njerëzit rreth nesh?

Nxënësit zhvillojnë një anketim të shkurtër rreth të drejtave të njeriut

Objektivat e mësimi	Nxënësit e çojnë më tej përvojën e të mësuarit duke intervistuar më të rriturit, rreth qëndrimeve dhe njohurive të tyre për të drejtat e njeriut. Ata vërejnë se sa ndryshon vlerësimi i të drejtave të njeriut.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përgatisin një anketim dhe e praktikojnë duke punuar me të në klasë. Anketa në vetvete duhet të zhvillohet si detyrë shtëpie gjatë javës së ardhshme.
Burimet	Fleta e punës, letër, lapsa dhe stilolapsa.
Metodat	Sondazhe në grupe.

Përshkrimi i mësimi

Klasa, tani, ka një listë të të drejtave të njeriut (kjo nuk është ende një listë të plotë). Sidoqoftë, nga lista bëhet e qartë se, edhe pa dijeninë e konceptit të të drejtave të njeriut, të gjithë e dinë se njerëzit kanë nevoja dhe se këto nevoja janë shumë të ngjashme me të drejtat e paraqitura në nenet e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut. Duke mësuar këtë, nxënësit kanë rindërtuar, pjesërisht, historinë e të drejtave të njeriut, të cilat, në fund të fundit, nuk janë krijuar rastësisht në mënyrë të izoluar, por janë zhvilluar nga ideja se të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejta themelore që askush nuk mund t'ia heqë.

Në mësimet 3 dhe 4, nxënësit duhet të kryejnë një studim të shkurtër. Në komunitetin e tyre lokal, ata duhet të përpiqen të zbulojnë se çfarë lidhet me të drejtat e njeriut, si gjykojnë këto të drejta dhe çfarë niveli të njohurive themelore kanë njerëzit për të drejtat e njeriut.

Nxënësit duhet të krijojnë, të zhvillojnë dhe të vlerësojnë një studim të shkurtër, i cili synon të kuptojë se si të drejtat e njeriut janë të pranishme në mjedisin e tyre rrethues. Mësuesi u jep atyre fletën e punës, në të cilin mund të vihen re kategori të ndryshme përgjigjesh: qëndrimet personale ndaj të drejtave të njeriut, njohja e këtyre të drejtave dhe gjendja aktuale në vendin e tyre. Nxënësit duhet të intervistojnë të rriturit, (të afërm, miq, fqinjë, kalimtarë) dhe t'u drejtojnë pyetjet e mëposhtme:

- A mendoni se është e rëndësishme që të drejtat e njeriut janë vendosur në të gjithë botën? Nëse është kështu, pse? Nëse jo, pse jo?
- Cilat të drejta duhen mbrojtur në të gjithë botën?
- Kush është përgjegjës për ta bërë këtë?
- Cilat të drejta duhen mbrojtur në vendin tonë?
- Kush është përgjegjës për ta bërë këtë?

Nxënësit duhet të jenë të kujdesshëm për të mos gjykuar, nëse qëndrimet, opinionet ose njohuritë e shprehura janë të sakta. Përkundrazi, ata duhet thjesht të shënojnë përgjigjet.

Intervistat nuk janë të lehta për t'u bërë. Për këtë arsye, do të ishte mirë nëse ato do nxiteshin në klasë. Një grup i vogël nxënësish mund të marrë rolin e intervistuesit dhe dy nxënës mund të marrin rolin e kalimtarit të panjohur. Intervistat me miqtë ose me të afërmit mund të nxiten. Është e rëndësishme që nxënësit të mos harrojnë të prezantojnë veten dhe të shpjegojnë qëllimin e intervistës. Kur shihen provat e intervistave, nxënësit e tjerë mund të japin ide konstruktive. Në këtë mënyrë të gjithë mësojnë.

Pyetje për reflektim:

- Si janë marrë shënimet?
- Cila është ndarja e roleve brenda grupit të intervistës?
- Si do të paraqiten rezultatet në mësimin tjetër?

Mësuesi u jep nxënësve një javë kohë, për të kryer intervistat. Është e përshtatshme që intervistat të kryen në grupe të vogla.

Mësimi 4

Të drejtat e njeriut janë gjallë!

Paraqitja dhe diskutimi i rezultateve të anketimit

Objektivat e mësimi	Nxënësit bëhen të vetëdijshëm se si njerëz të ndryshëm i vlerësojnë në mënyrë individuale dhe ndryshe të drejtat e njeriut. Ata reflektojnë për proceset e tyre të të mësuarit dhe mundësojnë kështu transferimin e njohurive dhe të kompetencave.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit paraqesin dhe diskutojnë rezultatet e sondazhit të tyre. Ata reflektojnë për të gjithë procesin e të mësuarit.
Burimet	Letër A4.
Metodat	Diskutim në grup, diskutim plenar.

Informacion

Diskutimi (një shkëmbim argumentesh, nga latinishtja, *discussio*, d.m.th. argumenti) është një formë e veçantë e komunikimit verbal mes dy ose më shumë personave, për një ose më shumë çështje, d.m.th. përmes diskutimit, ku të dyja palët paraqesin argumentet e tyre. Diskutimi duhet të mbahet në frymën e respektit të ndërsjellë. Një stil i mirë diskutimi kërkon që folësit të lejojnë, madje edhe të nxisin pikëpamjet dhe mendimet e tjera, duke i marrë ato parasysh me kujdes, në vend që t'i hedhin menjëherë poshtë. Cilësitë vetjake, të tilla si: qetësia, vetëpërmbytja dhe edukata, janë në interes të të dyja palëve. Në skenarin më të mirë, një diskutim do të çojë në zgjidhjen e një problemi ose në arritjen e një kompromisi, ku të gjithë të përfshirët të mund ta pranojnë.

Në shoqëritë moderne, diskutimet janë të qytetëruara, domethënë, trajtimi i çështjeve kundërshtuese, veçanërisht i atyre që kanë të bëjnë me konflikte në bazë interesi, menaxhohet në mënyrë paqësore. Konfliktet nuk duhet të shtypen, por të zgjidhen. Duke mësuar dhe praktikuar aftësitë e tyre për diskutim, nxënësit mësojnë një element themelor të ndërtimit dhe ruajtjes së paqes në shoqëri.

Përshkrimi i mësimi

Nxënësit duhet të paraqesin rezultatet e anketës së tyre për qëndrimet, njohuritë dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Nuk do të jetë e mundur që të paraqiten të gjitha rezultatet në një mësim të vetëm. Për këtë arsye, klasa ndahet në tre grupe dhe çdo grup paraqitet e rezultateve e përbashkëta.

Vetëm përshtypjet e përgjithshme mund të kalojnë në *seancën plenare*, e cila do të jetë bazë për diskutimin përfundimtar.

Rekomandohet që çdo nxënës duhet të mbajë shënime në një fletë letre në lidhje me atë që është gjetur më interesante, më e këndshme apo më e bezdisshme gjatë anketimit.

Këto shënime duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që nxënësit të mund t'i paraqesin ose t'i varin diku në klasë.

Në vendin tonë ka ende shumë shkelje të të drejtave të njeriut.

Unë u habita se sa shumë njerëz kërkonin t'i përgjigjeshin pyetjeve.

Specifikat për të drejtat e njeriut zakonisht nuk janë të njohura

Për diskutimin përfundimtar është e rëndësishme që mësuesi të mos e quajë të përfunduar detyrën e tij, me arsyetimin se nxënësit tani dinë gati çdo gjë që ka të bëjë me të drejtat e njeriut. Kjo ka për të qenë vetëm një analizë e parë dhe një qasje për të drejtat e njeriut. Nxënësit duhet të motivohen dhe të etur për të vazhduar të mendojnë rreth njeriut dhe të drejtave, për të mbajtur kurdoherë një qëndrim kritik.

Mësuesi mund ta marrë parasysh idenë e nxitjes së nxënësve të motivuar për të mësuar më shumë rreth të drejtave të njeriut, duke studiuar dokumente të veprimtarisë së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës ose grupeve të të drejtave të njeriut si Amnesty International.

Të gjitha fjalitë kryesore nga rezultatet e studimit duhet të jenë të afishuara ose të varura në klasë dhe nxënësit duhet t'i lexojnë ato në heshtje. Pas kësaj, është i nevojshëm një diskutim, që duhet të ndërtohet mbi bazën e çështjeve të mëposhtme dhe komenteve shoqëruese:

- Proceset e mësimit
- Njohuri të reja
- Përvojat gjatë intervistave
- Ide për vazhdimësinë e punës me temën e të drejtave të njeriut, si klasë apo si individ.

Në këtë pikë, do të ishte e rëndësishme që të gjithë të përfshirët (mësuesit, nxënësit dhe gjithë shkolla), të kuptojnë si mund të vazhdojë puna në këtë temë edhe në të ardhmen. Tema e të drejtave të njeriut duhet të jetë gjithmonë me interes për qeniet njerëzore. Ajo asnjëherë nuk duhet të jetë thjesht një punë e mbaruar .

KAPITULLI 9

Media

Arsimi fillor

Media në përdorim: Unë do ta bëja nëse do të mundesha

9.1 Ne përgatisim një ekspozitë

Pajisjet e reja dhe të vjetra të medieeve - çfarë gjejmë në to?

9.2 Pushteti i dijes dhe i aftësive!

Nxënësit përgatisin prezantimet e tyre për pajisjet e medieeve

9.3 Koha e prezantimit!

Grupet e specialistëve tregojnë aftësitë e tyre teknike në media

9.4 Ne planifikojmë një produkt të medias

Çfarë mund të bëjmë me aftësitë tona tani? Nxënësit merren vesh për një temë dhe një plan

Kapitulli 9: Koncepti kyç - "Media" (për arsimin fillor)

Informacion për mësuesit: nxënësit i tregojnë njëri-tjetrit si të përdorin pajisjet e medieeve

Siç tregohet edhe në hyrje të këtij manuali, edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut dallohen mes tri kompetencave. Ky kapitull merret me medien si kompetencë, e cila është një nga elementet qendrorë që u mundëson njerëzve të marrin pjesë në mënyrë aktive ose pasive në shoqërinë civile. Për të integruar këtë qasje si duhet, më poshtë listohen tri kompetencat.

Kompetencat e EQD/EDNJ:

Kompetenca në analizën dhe gjykimin politik	Kompetenca në përdorimin e metodave	Kompetencat në vendimmarrjen dhe veprimin demokratik
Aftësia për të analizuar dhe diskutuar ngjarjet politike, problemet e dhe çështjet e diskutueshme ...	Përvetësimi i shkathtësive dhe aftësitë për të gjetur dhe absorbuar informacionet, për të përdorur mjetet dhe mediet e komunikimit ...	Aftësia për të vlerësuar potencialin (dhe kufizimet) e dikujt për pjesëmarrjen politike dhe në zgjedhjen e duhur të një kursi veprimi ...

Kompetenca e dytë në tabelë - "kompetenca në përdorimin e metodave" - përfshin kompetencën e medias si një element qendror. Në kapitullin në vijim, fokusi kryesor qëndron në aftësinë për të punuar me mediet ekzistuese, në përdorimin e mundësive dhe në njohjen e kufizimeve e kufijve të saj. Në edukimin e medieeve, mund të diferencohen katër dimensionet e kompetencës së medias:

Kompetenca teknike e medias:

- Aftësia për të përdorur medien në mënyrë të saktë dhe për njohjen e mundësive të saj krijuese.

Kompetenca kulturore e medias:

- Njohja e "kodeve" të medieeve dhe të gjitha formave estetike dhe shoqërore të shprehjes. Përdoruesit e kualifikuar janë në gjendje të kuptojnë kodet e medieeve, mund t'i perceptojnë dhe të kuptojnë deklarata për shtyp dhe mund t'i përdorin edhe për qëllime të tjera.

Kompetenca sociale e medias:

- Aftësia për të përdorur me mençuri forma të ndryshme në tregun e komunikimit. Marrëdhëniet janë duke u bërë gjithnjë e më të afërta me mediet, duke përfshirë edhe format e ndryshme të "rrjeteve sociale".

Kompetenca reflektive e medias:

- Përdoruesi është në gjendje të analizojë në mënyrë kritike funksionin e medieeve, si dhe sjelljen e njeriut ndaj medias, në çdo kohë të dhënë.

Gama e gjerë e edukimit për medien përfshin këto katër dimensionet. Këndvështrimi EQD / EDNJ vetëm prek disa aspekte të këtyre koncepteve dhe nuk zëvendëson edukimin e medias. Por, në lidhje me qëllimet mësimore të lidhura me medien, këto përfaqësojnë strategji thelbësore të edukimit për medien. Lidhja e drejtpërdrejtë midis kompetencës teknike të medias e zotëruar nga mësuesit dhe shpeshësia e përdorimit të medieeve në klasë është një arsye tjetër për vlefshmërinë e këtij kapitulli. Shumë mësues e pranojnë haptazi se nuk dinë të menaxhojnë dhe të punojnë si duhet me llojet e ndryshme të medieeve ose të kuptojnë mundësitë e përdorimit të tyre në klasë. Megjithatë, një gjë është e qartë: sa më të sigurt të ndjehen mësuesit në

përdorimin e medieve të ndryshme, aq më i shpeshtë do të jetë përdorimi i medieve në mësimdhënie.

Në këtë kapitull trajtohet, si kompetenca praktike e mësuesve në media, ashtu edhe ajo e nxënësve. Vetëm pasi të jenë trajtuar, fokusi i kapitullit kalon për përdorimin e medias dhe në zgjedhjen e një teme specifike për të punuar.

Qëllimi i edukimit për qytetari demokratike dhe të drejta e njeriut është të mbështetë zhvillimin e kompetencave në tri fusha. Ky kapitull ka profilin e mëposhtëm të kompetencës.

Kompetenca në ...		
... analizë dhe gjykimin politik	... përdorimin e metodave	... vendimmarrjen dhe veprimin politik
**	*	***

Mbështetja me mjete

Në këtë kapitull do të përdoren mjetet e mëposhtme nga kutia e mjeteve të nxënësit. Mësuesi duhet të vendosë nëse disa ose të gjithë nxënësit kanë nevojë për përgatitje shtesë që të jenë në gjendje të punojnë me këto mjete.

Hulumtim në biblioteka

Hulumtim në internet

Kryerja e intervistave dhe sondazheve

Interpretimi i imazheve

Harta mendore

Krijimi i posterave

Organizim ekspozitash

Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

Përgatitja e sliderave për projektor ose një prezantim në *PowerPoint*

Shkrim artikujsh në gazeta

Vënia e një shfaqjeje

Debate të përbashkëta

KAPITULLI 9: Media -Media në përdorim: Unë do ta bëja po të mundesha!

Nxënësit i tregojnë njëri-tjetrit se si të përdorin pajisjet e medieve

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metodat
Mësimi 1: Ne përgatisim një ekspozitë	Nxënësit kuptojnë se është e rëndësishme të kuptojnë detajet teknike të pajisjeve të medieve dhe të investohet koha e nevojshme për këtë qëllim. Ata përgatisin një ekspozitë me pajisje të tyre dhe me ndihmën e pajisjeve të shkollës.	Përdorimi i një pajisje të cilën nuk e njohin bën që nxënësit të përpiqen të përshkruajnë atë dhe mënyrën sesi funksionon. Ata mbledhin dhe përshkruajnë pajisje të ndryshme të medias dhe përgatisin një ekspozitë në klasë.	Një pajisje media (të tilla si një aparat fotografik etj.), material i shkruar.	Biseda, punë në grup, detyrat e shtëpisë.
Mësimi 2: Pushteti i dijes dhe i aftësive!	Nxënësit kuptojnë diversitetin ose numrin e kufizuar të pajisjeve të medias që mund të përdorin.	Përgatitja e një ekspozite të medias në klasë dhe çuarja më tej e të kuptuarit si punon një pajisje specifike e medias.	Pajisjet vetjake për medien, pajisjet shkollore të medias, materiali i shkruar nga mësuesi për Kapitullin 9, mësimet 1 dhe 2, material i shtypur për nxënësit.	Varet nga organizimi i përzgjedhur nga mësuesi.
Mësimi 3: Koha e prezantimit!	Nxënësit bëhen specialistë teknike për të pajisjet e zgjedhura të medias. Ata mësojnë se si të paraqesin informacionin e përgatitur.	Si specialistë të pajisjes së tyre të zgjedhur të medias, nxënësit bëjnë prezantime në grupe.	Pajisje të medias, mjetet individuale për të bërë prezantime.	Prezantimet e grupit.
Mësimi 4: Ne planifikojmë një produkt të medias	Nxënësit zbatojnë kompetencën teknike të fituar për medien; Ata zgjedhin një temë dhe pajisjet e medias që nevojiten të përdoren.	Duke përdorur një proces demokratik dhe pjesëmarrës (në grupe të vogla dhe në një diskutim plenar), klasa vendos për temën që do të punojnë dhe pajisjet e medias që do të përdorin për të.	Mjeti "Harta imagjinare" (mjet nga kutia e mjeteve), Mjet i printuar: formular për përzgjedhjen e mjeteve të medias për temën e zgjedhur.	Puna në grup, vendimmarrja në seancë plenare.

Mësimi 1

Ne përgatitim një ekspozitë

Pajisjet e reja dhe të vjetra të medieeve - çfarë gjejmë në to?


Objektivat e mësimi	Nxënësit kuptojnë se është e rëndësishme të përvetësohen detajet teknike të pajisjeve të medieeve dhe të investohet koha e nevojshme për këtë qëllim. Ata përgatisin një ekspozitë me pajisjet e tyre dhe ndihmën e pajisjeve të shkollës.
Detyrat e nxënësve	Përdorimi i një pajisje, me të cilën nuk janë të familjarizuar, i bën nxënësit përpiqen për të përshkruar pajisjen dhe mënyrën sesi funksionon. Ata mbledhin dhe përshkruajnë pajisje të ndryshme të medieeve dhe përgatisin një ekspozitë në klasë.
Burimet	Një pajisje media (një aparat fotografik etj.), fleta e punës.
Metodat	Bisedë, punë në grup, detyrat e shtëpisë.

Përshkrimi i mësimi

Në mënyrë që nxënësit të bëhen më të vetëdijshëm për temën, mësuesi duhet të sjellë një pajisje të medieeve në shkollë (një aparat fotografik, një projektor, kompjuter, video kamera, telefon celular, një aparat fotografik të vjetër me film, një kasetofon, një projektor të varur etj.). Manuali udhëzues për pajisjen do të jetë i nevojshëm, por, mësuesi nuk duhet t'ia vërë atë që në fillim në dispozicion të nxënësve.

Në fillim të mësimi, pajisjet vendosen në një tavolinë në mes të klasës. Nxënësve u jepen detyra të shpjegojnë si punon kamera ose pajisjet e tjera, edhe pse ata ende nuk i njohin mirë ato. Nxënësit e realizojnë këtë, për shembull, duke vizatuar kamerën, në të cilën tregojnë pjesët e dukshme, duke i etiketuar ato (siç tregohet në foton më poshtë). Është gjithashtu e rëndësishme që nxënësit të vizatojnë pjesët e pajisjeve që ende nuk i njohin. Gjithashtu ata duhet të shkruajnë për çfarë mendojnë se shërbejnë ato pjesë.

Ana pamore e vizatimeve të nxënësve për mësuesin:



Sa më e komplikuar pajisja, aq më e vështirë do të jetë përmbushja e kësaj detyre. Është e rëndësishme që nxënësit të mos tremben. Nuk ka askush të drejtë apo gabim. Nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm se pajisje të tilla kanë mundësi të shumta e të ndryshme dhe se është logjike që duhet t'i njohësh mirë ato.

Variacion:

Është e mundur që vizatimi të kopjohet duke përfshirë edhe legjendën në një letër transparente për të bërë prezantim të përbashkët.

Mësuesi u jep një grupi nxënësish manualin e përdorimit për pajisjen (kjo mund të bëhet edhe një ditë më parë, pa e informuar pjesën tjetër të klasës). Sigurisht, do të jetë e pamundur të përshkruhet dhe të njihen të gjitha funksionet e pajisjes. Por nga ana tjetër, kjo nuk ka rëndësi, të paktën deri në këtë pikë, sepse kemi të bëjmë vetëm me një prezantim.

Më pas, mësuesi shpjegon qëllimet dhe procedurën e tërë kapitullit:

- Organizimi i një ekspozite pajisjesh të medieve të sjella nga shtëpia dhe nga shkolla (mësim 2).
- Njohja me një nga pajisjet dhe me funksionet e saj dhe mundësitë për prezantimin e saj para klasës (mësim 3 - plus mësim shtesë në varësi të numrit të pajisjeve).
- Kur pajisjet janë kuptuar, klasa vendos për një produkt të medies (film, histori audio, ekspozita fotografike, histori etj.) dhe zhvillon një plan paraprak për këtë qëllim (Mësimi 4).

Në fund të mësimit, mësuesi duhet të mbledhë të gjitha idetë e nxënësve dhe të japë udhëzime të qarta se si mund të ekspozohen të gjitha pajisjet në klasë. Ai duhet t'i bëjë gati skica për përshkrimin e pajisjeve para nxënësve (fleta e punës).

Shënim: pajisjet që i përkasin shkollës duhet të jenë gjithashtu pjesë e ekspozitës. Nxënësit të cilët nuk kanë sjellë asgjë në shkollë apo ata që kanë kohë shtesë, duhet të përgatisin përshkrimet e pajisjeve të shkollës dhe të bëjnë paraqitjen e tyre në ekspozitë.

Mësimi 2

Fuqia e njohurive dhe aftësive!

Nxënësit përgatisin prezantimet e tyre për pajisjet e mediave

Objektivat e mësimit	Nxënësit kuptojnë diversitetin ose numrin e kufizuar të pajisjeve të mediave që mund të përdorin. Nxënësve iu jepet informacion nga mësuesi për mediat dhe si të përdoren ato.
Detyrat e nxënësve	Përgatitja e një ekspozite të medias në klasë dhe avancimi i të kuptuarit se si punon një pajisje specifike e medias.
Burimet	Pajisjet vetjake për median, pajisjet shkollore të medias, materiali i shkruar nga mësuesi për Kapitullin 9, mësimet 1 dhe 2, fleta e punës.
Metodat	Varet nga organizimi i përzgjedhura nga mësuesi.

Përshkrimi i mësimit

1. Në fund të mësimit 1, mësuesi (ose një grup i nxënësve) duhet të përgatisë një tabelë në të cilën duhet të vendoset *ekspozita*. Në qoftë se dhoma mund të mbyllet e të jetë e sigurt, nxënësit mund t'i sjellin pajisjet e tyre edhe më parë. Mësuesi duhet të shoqërojë gjatë mbledhjes së pajisjeve dhe t'i përgjigjet çdo pyetjeje të ngritur. Prindërit duhet të jenë gjithashtu të informuar në lidhje me arsyen përse nxënësit duhet të marrin pajisjet e tyre medietike për në shkollë.
2. Pasi ekspozita bëhet e plotë dhe rregullohet bukur, mësuesi mund ta emërojë si "ekspertët e ekspozitës", nxënësit që do të jenë përgjegjës për të dhe që mund të mbështesin shokët e klasës së tyre. Është e qartë se nxënësit, në këtë fazë, duhet të jenë të vëmendshëm dhe të kujdesshëm kur trajtojnë pajisjet.
3. Nxënësit (nëse është e nevojshme, me ndihmën e mësuesit) duhet të bëjnë një listë të pajisjeve që do të përdoren nga, secili grup. Edhe koha e prezantimit duhet të përfshihet në listë. Në varësi të madhësisë së klasës dhe të numrit të pajisjeve të zgjedhura, mund të nevojitet më shumë se një orë mësimi për prezantimet (shih fletët e punës së nxënësve).
4. Lista duhet të jetë në vend të dukshëm. Në këtë mënyrë, do t'i shërbejë procesit të të mësuarit.

Lista mund të duket si këtu më poshtë:

Pajisje Mediesh	Anëtarët e grupit	Data dhe ora e paraqitjes plus gjatësia e kohës së nevojshme
Video regjistruar	Tim, Mirca, Susanne, Mario	E mërkurë, shkurt 14, 09:00; 20 minuta
Kamera digjitale	Lena, Lisa, Sofie Jan	E mërkurë, 14 shkurt, 09:20; 20 minuta

Si shtesë të këtij mësimi, mësuesi mund të përgatisë disa të dhëna të shkurtra që i paraqet pas *ekspozitës* (rreth 10 minuta). Ka dy mënyra për ta bërë këtë (por mësuesit e mirë-informuar mund të përgatisin të dhëna të tjera):

Media në demokraci. Qëllimi është t'u tregojë nxënësve funksionin që kanë mediet në shoqërinë tonë. Për nxënësit e shkollave fillore, ky mund të përbëjë informacionin bazë, i cili i ndihmon ata për të rritur të kuptuarit e tyre hap pas hapi (shih fletët e punës së mësuesit për Kapitullin 9, mësim 1).

Trajtimi me televizion. Si një alternativë, mësuesi mund të përgatisë një kontribut në lidhje me temën "Trajtimi me televizion", në qoftë se kjo i përshtatet më mirë konceptit të mësimdhënies (shih fletët e punës së mësuesit 9.2).

Këto të dhëna nuk janë për vlerësim. Funksioni i tyre është që të rrisë, hap pas hapi, sfondin e njohurive të nxënësve. Si në shumë raste të tjera të transferimit të njohurive, është e mundur që nxënësit nuk do t'i kuptojnë të gjitha detajet. Kjo duhet të pranohet në situata të tilla komplekse dhe mësuesi duhet të vendosë se çfarë pret prej nxënësve.

Mësimi 3

Koha e prezantimit!

Grupet e nxënësve tregojnë aftësitë e tyre teknike rreth mediave

Objektivat e mësimit	Nxënësit bëhen specialistë për të zgjedhur pajisje teknike të medias së tyre. Ata mësojnë si të paraqesin informacionin e përgatitur.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit bëjnë prezantime në grupe, si specialistë për zgjedhjen e pajisjes së mediave të tyre,
Burimet	Pajisjet e medias, mjetet individuale për të bërë prezantime.
Metodat	Prezantimet e grupit.

Përshkrimi i mësimit

Ky mësim (në varësi të prezantimeve mund të jenë disa mësimet) duhet të përgatitet nga nxënësit. Prezantimet do të jenë objektivi kryesor. Mësuesi do të shoqërojë ekipet gjatë fazës përgatitore. Në varësi të aftësive prezantuese të nxënësve, kjo detyrë mund të jetë mjaft komplekse.

Nxënësit duhet të mendojnë me kujdes për mënyrën si duan të përcjellin të gjitha informacionet në prezantimet e tyre. Kutia e mjeteve të nxënësve përmban pajisje të ndryshme për t'i mbështetur dhe ndihmuar, të tilla si në këshillat për:

- Krijimin e posterave;
- Përgatitjen e sliderave transparente; dhe
- Planifikimin dhe dhënien e prezantimeve.

Disa grupe mund të dëshirojnë të lexojnë prezantimet e tyre. Nga këndvështrimi i mësuesit, dhënia e mundësisë për të paraqitur prezantimet e tyre para klasës, u krijon nxënësve një ndjenjë sigurie që mund të ketë një ndikim të madh, sidomos në prezantimet e ardhshme. Kjo është e rëndësishme në lidhje me EQD/EDNJ, pasi një nga kompetencat kryesore në përdorimin e metodave në një demokraci, është aftësia për të paraqitur informacionet dhe opinionet e veta lirisht dhe në mënyrë bindëse.

Mësimi 4

Ne planifikojmë një produkt të medias

Çfarë mund të bëjmë me aftësitë tona tani? Nxënësit bien dakord për një temë dhe një plan

Objektivat e mëimit	Nxënësit do të zbatojnë kompetencat teknike të medias. Nxënësit zgjedhin një temë dhe pajisjet e medias që do i nevojiten.
Detyrat e nxënësve	Duke përdorur një proces demokratik dhe pjesëmarrës (në grupe të vogla dhe në një diskutim plenar), klasa vendos për temën që do të punojë dhe pajisjet e medias që dotë përdorë.
Burimet	Mjeti "Harta imagjinare" (Në kutinë e mjeteve) Skeda: Kartë prezantimi me një përshkrim të shkurtër të mjeteve të mediave.
Metodat	Puna në grup, vendimmarrja në seancë plenare.

Përshkrimi i mëimit

Së bashku me mësuesin, nxënësit zgjedhin për të punuar një temë (duke përdorur informacionet që janë mbledhur në lidhje me trajtimin e pajisjeve të mediave). Tema mund të jetë e lidhur me një fushë të EQD/EDNJ, për shembull, nxënësit mund të vendosin për të dokumentuar të gjitha terrenet sportive në komunitetin e tyre, ndërkohë që duhet të rendisin të gjitha gjërat që kanë humbur prej tyre. Ata mund ta dërgojnë këtë informacion tek autoritetet përgjegjës ose e botojnë në shtypin lokal. Mund të jetë e mundur që të dokumentohet një kantier ndërtimi për një periudhë më të gjatë kohore (duke përdorur fotografitë dhe zërin) për të hartuar kështu një raport me interes. Pasi është zgjedhur tema, nxënësit duhet të vendosin se çfarë lloj pajisjesh të mediave do të përdorin për të dokumentuar të dhënat.

Mësuesi planifikon zgjedhjen e një teme që u pëlqen të gjithëve dhe që do të dokumentohet duke përdorur pajisjet e medieve. Nëse mësuesi dëshiron të tregohet i hapur për temën, duhet të mbledhë të gjitha idetë e nxënësve në një listë. Idetë mund të grumbullohen në grupe të vogla, të cilat më pas mund të paraqiten në një *diskutim plenar*. Lista e përbashkët mund të shkruhet në tabelë.

Kërkimi për një temë që të pëlqehet nga të gjithë është komplekse, por ajo mund të jetë edhe një mënyrë e mirë për të mësuar arritjen e një kompromisi (mësuesi duhet ta vlerësojë këtë aspekt).

Më pas, grupet e nxënësve duhet të zhvillojnë disa ide paraprake, duke përdorur si mjet hartën imagjinare të kutisë së mjeteve. Këto ide do të paraqiten në klasë. Nëse për nxënësit është hera e parë që përdorin një hartë mendore, mësuesi duhet të diskutojë me hapat e veçanta që janë të nevojshme. Ai mund t'u japë edhe një model si ky në vijim:

- Shkruani titullin e temës tuaj në mes të fletës së letrës dhe vizatoni një rreth për qark saj. Sigurohuni që të përdorni letër të madhe.
- Vizatoni disa linja të trasha vijash rrethore që dalin nga rrethi. Në çdo linjë, shkruani emrin e një nënçështjeje që i përshtatet titullit të temës kryesore në mes.
- Nga vijat e trasha, ju mund të bëni shtesa, linjat më të holla që përfaqësojnë nënkategori ose pyetje të lidhura me nëntemat e shkruara në rreshtin e trashë.

- Përpiquni të gjeni sa më shumë kushte të ndryshme që të mundeni dhe vendosini në kategoritë e dhura. Ju mund të përdorni madhësi të ndryshme shkronjash (shkronjat kompjuterike), simbolesh dhe ngjyrash.

Të njëjtat grupe (ose ndoshta e tërë klasa, në një *seancë plenare*) do të mendojnë më pas se cilën nga pajisjet e medias do të përdorin (shih fletën e punës: skedat e prezantimit japin një përshkrim të shkurtër të pajisjeve të medias).

Nëse këto sugjerime janë zhvilluar në grupe, duhet të mblidhen rezultatet.

Çështja e përgjegjësisë duhet të trajtohet përsëri në një diskutim plenar:

- Çfarë lloj përgjegjësie ka një person që regjistron fotot dhe tingujt?
- Çfarë do të thotë mbrojtje e të drejtave vetjake e një personi?
- Kujt duhet ti kërkojmë informacion?

Kapitulli 9 duhet të përfundojë me këtë hap. Zbatimi i temës së përzgjedhur do të zhvillohet si pjesë e kurrikulës së lëndës, ku normalisht duhet të mësohet kjo temë.

Material shtesë për mësuesit

Kapitulli 9 - Materiali i mësuesit 1: Media në demokraci

Në një demokraci, mediat janë në anën e popullit dhe të vërtetës. Faktet paraqiten objektivisht dhe tërësisht. Opinione dhe gjykimet janë të shënuara në mënyrë të qartë (për shembull, dallohet qartë mesazhi nga komentet), siç është informacioni për të cilin nuk ka fakte të njohura ose për të cilat mund të bëhen vetëm supozime.

Për më tepër, ekziston një larmi mediesh dhe kjo sjell parashikimin e informacionit plotësues, si dhe të korrigjimit të mundshëm të një burimi nga një media te një tjetër. Kështu, përdoruesi i medias duhet të jetë në gjendje që të marrë informacion të balancuar në të cilën të bazojnë opinionet e tyre.

Në një diktaturë mediat janë në anën e sundimtarëve. Mediet mbështesin bazën e pushtetit dhe politikën e sundimtarit, duke përdorur teknika të propagandës (si mosdhënien e informacionit, sajimin e informacionit ose shtimin e dozës emocionuese të informacionit etj.).

Ndërsa në demokraci është e vërtetë e kundërta. Një analizë e medias në një vend mund të tregojë nëse dikush jeton në një demokraci apo jo. Në një demokraci, liria e mendimit dhe e shtypit janë të rëndësishme parësore: pa këto nuk ka demokraci, as edhe nuk gëzohen plotësisht të drejtat e njeriut. Për më tepër, në të kaluarën, media ka arritur vërtet *histori suksesi* në fushën e të drejtave të njeriut. Mediet, më shumë se një herë, nëpërmjet intervistave televizive ose mesazheve të tjera pamore, kanë çuar në lirin e njerëzve të burgosur për arsye politike; më shumë se një herë, njerëzit kanë dërguar mesazhe (SMS), duke përdorur celularët e tyre, për të paralajmëruar të tjerët rreth një katastrofe të afërt.

Gjithkush, për një arsye ose për një tjetër, alarmohet kur zhvillohet një konsolidim i medias në një demokraci. Zakonisht, kjo do të thotë se, të gjitha mediat raportojnë një ngjarje në të njëjtën mënyrë edhe pse mund të ketë opinione dhe gjykime të ndryshme në lidhje me këtë ngjarje.

Falë protestave dhe publikimeve të disa individëve kritikë, ndonjëherë është ende e mundur që një person të marrë informacion të plotë dhe ka një shans që një konsolidim i tillë i medieve të mund të demaskohet herë pas here. Megjithatë, shumica e qytetarëve mund të përdorin vetëm mediet masive të konsoliduar dhe efekti i kësaj nuk duhet të nënvlerësohet.

Media gjithashtu mban përgjegjësi për informacionin që shpërndan: a mundet një gazetar të jetë i sigurt se ajo që po raporton është e vërtetë? A është qëndrimi i tij kritik i justifikuar, apo thjesht ai kërkon të jetë i pari që raporton një "skandal"?

Përdorimi i medieve do të thotë gjithashtu ushtrim i pushtetit. Kushdo që regjistron, figurë apo zë dhe i publikon ato, duhet ta bëjë këtë me një ndjenjë të madhe përgjegjësie dhe duhet të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e tij ose të saj në një demokraci.

Material shtesë për mësuesit

Kapitulli 9: material i shkruar për mësuesit 2: të punosh me televizionin

1. Pse fëmijët janë aq të hipnotizuar nga TV?

Televizioni mundëson ndryshim të vazhdueshëm, relaksim dhe aventurë. Me shtypjen e një butoni, ke botën – e vërtetë ose imagjinare – në majën e gishtit, pa pasur nevojë të bëjë ndonjë përpjekje tjetër, fizikisht ose emocionalisht! Për shkak të telekomandës dhe të një numri të pafund programesh, ju jeni të aftë të kaloni nga një ngjarje emocionuese në një tjetër. Fëmijët, shpesh, identifikohen me karaktere dhe personalitete nga programe të ndryshme televizive; ata e përdorin televizionin për informacion, por e përdorin edhe kur nuk kanë asgjë më të mirë për të bërë.

2. Sa kohë kalojnë fëmijët para TV çdo ditë?

Në Evropën Perëndimore, konsumi mesatar i përditshëm i televizionit nga fëmijët e moshës mes 3 dhe 13 vjeç, është 90 minuta. Në të vërtetë, vetëm 60% e fëmijëve e fikin ndonjëherë vetë televizionin. Për më tepër, televizioni është shpesh i hapur ndërkohë që fëmijët bëjnë gjëra të tjera. Prindërit duhet të përpiqen për të vendosur disa rregulla për shikimin e televizionit, që fëmijët e tyre të jenë pak më të fokusuar në atë që po shikojnë. Në përgjithësi, rekomandohet që TV nuk duhet të jetë i hapur gjatë gjithë kohës dhe që fëmijët duhet shikojnë vetëm programe që janë të përshtatshme me moshën, interesante e të rëndësishme.

3. A ka shumë fëmijë që shikojnë sasi tepër të mëdha emisionesh të TV?

Të ashtuquajturit "të varur nga TV" shpenzojnë më shumë kohë para televizorit sesa në çdo aktivitet tjetër (shkollor, lojëra, takime miqsh etj.). Megjithatë, ka shumë pak fëmijë që futen në këto kategori. Nuk është domosdoshmërisht problem, në qoftë se një fëmijë shikon më shumë TV një ditë, sesa ditën tjetër. Problemi lind kur shikojnë gjëra të rastit ose kur diçka nuk po shkon mirë në familje ose me fëmijën. Në raste të tilla, konsumimi i TV përdoret për ti shpëtuar realitetit.

4. Çfarë pëlqejnë të shikojnë fëmijët e moshave të ndryshme?

Fëmijët e vegjël zakonisht duan të shikojnë programe nga të cilat mund të mësojnë diçka, si dhe filmat multiplikativë, filma me përralla dhe me aventura. Nga moshë 6 vjeç fëmijët fillojnë të bëhen të interesuar në rolet gjinore. Djemtë shikojnë filma me aksion dhe identifikohen vetë me heronjtë meshkuj; vajzat fillojnë të duan programe të ndryshme artistike dhe me muzikë, si dhe seriale të tëra, në të cilat familjet dhe kafshët luajnë një rol të rëndësishëm. Aty rreth moshës 12 vjeç, videot muzikore, me hitet e fundit dhe serialët për të rinjtë dhe dashurinë, fillojnë të bëhen të rëndësishme. Pothuajse të gjithë fëmijët i shohin këto programe, por në këtë moshë, ata fillojnë të shikojnë më shumë edhe programe për të rritur. Prindërit duhet të dinë që më parë përmbajtjen e programeve, në mënyrë që të shmangin gjërat që nuk janë të përshtatshme për fëmijët.

5. Cilat janë efektet e televizionit?

Televizioni mund të jetë çlodhës, por ai mund të shkaktojë edhe shqetësime, madje mund t'i bëjë fëmijët të ndihen të "ngarkuar". Kjo ndodh për shkak se imazhet ndryshojnë shumë shpejt dhe gjithmonë ka zhurma e zëra të lartë, sidomos në filmat vizatimorë dhe seritë me aksion. Disa përmbajtje programesh përçojnë ide të botës së vërtetë, duke dhënë hapur mënyrën se si ajo funksionon. Për më tepër, TV ndikon në emocionet e fëmijëve dhe fëmijët reagojnë për të parë: gëzim, frikë apo agresion në të njëjtën mënyrë siç bëjnë të rriturit. Mungesa e krahasimeve të ekuilibruara mund të bëhet një problem dhe, për këtë arsye, është tejet e këshillueshme të shmangët shikimi i programeve të një zhanri të veçantë.

6. Cilat programe informative janë të mira për fëmijët?

Shumica e kanaleve mundësojnë programe të posaçme për fëmijët. Ato japin informacion dhe përcjellin njohuri për botën. Disa kanale kanë edhe lajme për fëmijë, të cilat paraqiten në një mënyrë që fëmijët mund t'i kuptojnë lehtësisht. Për më tepër, një lajm për të rriturit i transmetuar në mesditë ose në mbrëmje, në përgjithësi, i shmang pamjet që nuk janë të përshtatshme për fëmijët. Megjithatë, të rriturit duhet të jenë gjithmonë të gatshëm, për t'u shpjeguar fëmijëve atë që ata nuk e kuptojnë.

7. Sa i rëndësishëm është TV në krahasim me mediet e tjera?

Për fëmijët më të vegjël, shpesh televizioni është forma më e përdorur e medias. Me kalimin e kohës, forma të tjera të ndryshme të medie (CD, MP3, video muzikore, TV në internet etj.) bëhen të rëndësishëm për ta, megjithëse, ekrani i TV mbetet burimi kryesor i informacionit dhe diskutimeve.

Prindërit e fëmijëve të vegjël duhet të kujdesen që fëmijët e tyre të marrin e të përjetojnë shumëllojshmëri mediesh: TV për çështjet aktuale dhe relaksim; radio për të dëgjuar muzikë gjatë gjithë ditës dhe për të dëgjuar disa pjesë të lajmeve; libra për nxitjen e imagjinatës dhe të aftësive gjuhësore; kompjuter dhe internet, në mënyrë që fëmijët të mund të bëhen nxënës të pavarur dhe të komunikojnë mirë me të tjerët.

8. Për çfarë është TV i mirë dhe kur nuk është kaq ideal?

Fëmijët që shikojnë një shumëllojshmëri programesh (lajme, tregime, emisione, serialë etj.) dinë shumë për çështjet aktuale dhe njohin shumë fakte e dukuri për jetën sot. Megjithatë, televizioni nuk ndihmon shumë në zgjidhjen e problemeve. Kur dikush është përfshirë në një "zënkë" me dikë, kërkon rrugën më të mirë për veprim ose përpiqet të zgjidhë një enigmë, nuk mund të ndihmohet vetëm nga faktet. Për këtë arsye, televizioni nuk mund ta zëvendësojë kurrë edukimin në shkollë ose në familje.

9. A janë të rriturit modele për t'u ndjekur?

Edhe fëmijët imitojnë të rriturit në përdorimin e medias. Nëse të rriturit lexojnë gazetën, atëherë edhe fëmijët e tyre do të jenë më të prirë për të lexuar gazetën. Nëse të rriturit kalojnë shumë kohë para TV, atëherë fëmijët do ta bëjnë po këtë gjë me teprí. Prandaj, prindërit nuk duhet kurrë të ankohen për zakonet e fëmijëve të tyre, sidomos në lidhje me TV, por duhet të jenë një shembull i mirë për ta në këtë drejtim. Ata nuk duhet kurrë ta shikojnë TV pa ndonjë qëllim të dukshëm, dhe duhet të jenë gjithnjë kritikë gjatë shikimit të TV.

10. Çfarë mund të bëjnë prindërit që të nxitin fëmijët të jenë shikues të arsyeshëm të TV?

Prindërit nuk duhet ta ndalojnë shikimin e TV, por duhet ta shikojnë atë së bashku me fëmijët, për t'u i shpjeguar atyre pse disa programe janë të mirë dhe të tjerët nuk janë aq të mirë. Televizioni nuk duhet të përdoret as si mjet shpërblimi apo ndëshkimi. Është e rëndësishme të gjejmë baraspeshën e duhur në këtë drejtim. Fëmijët duhet të kenë kohë të mjaftueshme për përvojat "reale", duke kaluar kohë me shokët, duke luajtur dhe përjetuar natyrën, qytetet dhe takimet me njerëz të tjerë.

Manual për nxënësit

Edukimi për Qytetarinë Demokratike dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNJ)
Vëllimi II



Botues: Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger
Përkthyes: "UEGEN"
Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj

I. Fletë pune për nxënësit

II. Mjete për nxënësit

I. Fletë pune për nxënësit

Hyrje

Të nderuar nxënës,

Ky është manuali juaj. Në faqet e mëposhtme ju do të gjeni një numër fletësh pune për ju, për t'i përdorur në klasë ose në shtëpi.

Mësuesi juaj do të shpjegojë se kur dhe se si do t'i përdorni ato, por ju ndërkohë, nëse mendoni se ato do të jenë të dobishme, mund të vendosni që t'i përdorni vetë.

Për të përdorur disa nga mjetet, do t'ju duhet të punoni në mënyrë të pavarur. Me të tjerat, ju do të duhet të punoni së bashku me shokët e shoqet e klasës.

Ndonjëherë ju do t'ju nevojitet të prisni diçka nga Fletët e Punës dhe, herë të tjera, duhet të shkruani ose të vizatoni diçka për to.

Disa detyra do të jenë të lehta për t'u bërë. Të tjerat do të jenë më të vështira, por ato do t'ju bëjnë të mendoni më shumë.

Nëse keni nevojë për më shumë ndihmë ose përkrahje, ju mund të përdorni mjetet në fund të këtij manuali.

Ne shpresojmë që ju ta shijoni punën që do të bëni dhe, me siguri, do të keni shumë ide të mira!

Përmbajtja

Kapitulli 1: Të dhënat në komunitetin tim

- Tabela "Më pëlqen dhe nuk më pëlqen"
- Stema e simboleve
- Diskutim tre hapësh

Kapitulli 2: Në shtëpi, në Evropë

- Harta e Evropës
- Vendet dhe kryeqytetet e Evropës
- Flamujt e Evropës
- Lumenjtë në Evropë
- Malet dhe pllajrat në Evropë
- Portreti i një vendi

Kapitulli 3: Pakicat dhe shumicat

- Tabela për shënime
- Fletë për statistikat
- Fjalë për skedat e fuqisë

Kapitulli 4: Rregullat që ndihmojnë për zgjidhjen e konflikteve

- Problemi ynë - problemi im
- Skedat e votimit

Kapitulli 5: Baza e të jetuarit së bashku

- Të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në shkollën tonë
- Skedat e votimit
- Kriteret për rregulla më të mira

Kapitulli 6: Unë jam shefi! A jam unë?

- Superhero?
- Skema e përfaqësimit politik
- Informacioni i zgjedhjeve

Kapitulli 7: Unë bëhem eko ... merr pjesë dhe shkolla ime!

- Përgjegjësi për çfarë?
- Çfarë lloj përgjegjësisë ka secili?

Kapitulli 8: Të drejtat e mia – të drejtat e tua

- Detyra për të vendosur mes "dëshirave" dhe "nevojave"
- Të drejtat e njeriut: një listë për të krahasuar të drejtat dhe nevojat
- Hulumtim për të drejtat e njeriut

Kapitulli 9: Media në përdorim: Unë do ta bëja nëse do të mundesha


- Skedat e prezantimit me një përshkrim të shkurtër të pajisjeve të mediave

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 1, mësimi 1
Tabela "Më pëlqen dhe nuk më pëlqen"

Gjërat që unë pëlqej dhe bëj				
Gjinia: _____				
1.	Më pëlqen të bëj dhe bëj	Unë e bëj por nuk më pëlqen ta bëj	Unë nuk e pëlqej ta bëj dhe nuk e bëj	Unë nuk e bëj, por do të doja ta bëj
2.				
3.				
4.				
5.				

Gjërat që të tjerët pëlqejnë dhe bëjnë				
Gjinia: _____				
6.	Më pëlqen të bëj dhe bëj	Unë e bëj por nuk më pëlqen ta bëj	Unë nuk e pëlqej ta bëj dhe nuk e bëj	Unë nuk e bëj, por do të doja ta bëj
7.				
8.				
9.				
10.				

**Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 1, mësimi 3 dhe 3
Modeli i simboleve**



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 1, mësimi 4
Diskutim në tre hapa

1. Çfarë mund të bëj ...

2. Ne mund ta
përdorim në shkollë

3. Dhe jashtë shkollës...

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 2, mësimi 1 Harta e Evropës (zmadhuar në A3)



- Ngjyrosni vendet me ngjyra të ndryshme!
- Plotësoni emrat e vendeve dhe të kryeqyteteve!
- Ku jetoni ju? Shënojeni vendin ku jetoni në hartë dhe shkruani emrin!
- Cilat janë dhe si quhen detet?
- Plotësoni lumenjtë më të rëndësishëm!
- Çfarë tjetër doni që të shkruani në hartë?

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 2, mësimi 1 Vendet dhe kryeqytetet e Evropës

Plotësoni vendet dhe kryeqytetet e Evropës në hartën tuaj memece.



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 2, mësimi 1 Flamujt e Evropës

Në hartën e mësipërme, përputhni flamujt e Evropës me vendet në hartën tuaj bosh.



Cili është flamuri juaj i preferuar?

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 2, mësimi 1

Lumenjtë në Evropë

Gjej këta lumenj në hartën më poshtë dhe hidhni pastaj në hartën skicë të Evropës.

Danub	Vollga
Rin	Oder
Po	Luarë
Dniepër	Senë
Ronë	Vistula
Elbë	Ebro
Ural	Tiber
Shanon	Tamiz
Tago	Don



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 2, mësimi 1 Malet dhe pllajtat në Evropë

Gjej këto male në hartën më poshtë dhe plotësoji ato në hartën skicë të Evropës.

Alpet
Malet Kjolën
Malet Karpate
Malet Urale
Pirenej
Apenine
Malet e Ballkanit
Alpet Dinarike
Malet Kaukazit
Pllaja e Mesetës



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 2, mësimi 2 dhe 3 Portreti i një vendi të Evropës

Portreti i vendit

Vendi ynë quhet:

Kjo është pamja e flamurit tonë:



Kryeqyteti quhet:

Kjo është forma e vendit tonë:

Vendi ynë ka rreth

_____ banorë

Gjuha e folur është:

Ushqimi më i njohur në vendin tonë:

Lumenjtë, liqenet dhe malet më të mëdhenj
quhen:

Ja si përshëndesin njerëzit në gjuhën
tonë:

Përshëndetje

Vendi ynë është i famshëm për:

Mirupafshim

Si jeni?

Emri im është

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 3, mësimi 2

Tabela për shënime

Tabela e pjesëmarrjes

Aktiviteti	Djemtë	Vajzat

Tabela e intervistës:

1. Pyetje:
2. Pyetje
2. Pyetje

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 3, mësimi 3
Skedat e fjalëve dhe pushtetit

Karta e fjalëve	Karta e pushtetit
Garipa	
Të moshuar	
Skiatorë	
Politikanë	
Priftërinj	

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 4, mësimi 1


Problemi ynë – problemi im

Problemet apo konflikte e përbashkëta dhe individuale (TABELË)

<p>Një problem/konflikt i zakonshëm i prek të gjithë nxënësit në klasë. Një zgjidhje për një problem/konflikt të përbashkët mund të ketë efekte të ndryshme në nxënës të ndryshëm.</p> <p>Shembull: Në klasën tonë, nganjëherë, bëhet shumë zhurmë.</p>	<p>Një problem/konflikt individual ndikon vetëm te një student në klasë. Edhe një zgjidhje për këtë problem duhet të ndikojë vetëm te ky nxënës.</p> <p>Shembull: Mua ndonjëherë më merr uria gjatë mësimi.</p>
---	---

Gjej shembuj të tjerë:	

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 4, mësimi 3
Kartat e votimit



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 5, mësimi 1
Të drejtat, përgjegjësitë dhe rregullat në shkollën tonë

Të drejtat	Përgjegjësitë	Rregullat
Siguria në klasë	Mbani rregull për të qenë të sigurt	Mos vrapo nëpër klasë

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 5, mësimi 3
Kartat e votimit

Pranoj	Refuzoj	Abstenoj
+	-	
+	-	
+	-	

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 5, mësimi 4

Kriteret për rregulla të mira

Kriteret për rregulla të mira

Rregulli ynë është:

Shkruani artikujt nga lista në tabelën e mëposhtme dhe pastaj kontrolloni rregullin tuaj

	Po	Jo

Përmbledhje:

Ne mendojmë se ky rregull është _____
sepse

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 6, mësimi 1 Superhero?

Shkruani se çfarë duhet të jetë në gjendje për të bërë një kujdestar klase dhe për çfarë duhet të jetë përgjegjës.


A do të jetë një i parë (kujdestar) i klasës një Superhero? Mendoni për këtë ...



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 6, mësimi 2 Skema e përfaqësimit politik

Plotësoni me këto fjalë:

Parlamenti	Populli	Qeveria
------------	---------	---------



Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 6, mësimi 3 Informacioni i zgjedhjeve

Pyetni prindërit tuaj rreth zgjedhjeve, si më poshtë. Shkruani përgjigjet e tyre.

Kur keni votuar në zgjedhjet e fundit?

Çfarë lloj zgjedhjesh ishin ato?

Ku u bënë?

Si ishin organizuar?

.....

Pyetni prindërit tuaj si më poshtë rreth zgjedhjeve. Shkruani përgjigjet e tyre.

Kur keni votuar në zgjedhjet e fundit?

Çfarë lloj zgjedhjesh ishin ato?

Ku u bënë?

Si ishin organizuar?

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 7, mësimi 1
Përgjegjësia për çfarë?

Unë marrë përgjegjësinë për..

... qenin im	... macen time
... peshkun tim	... një fëmijë
... një profesion	... një grup njerëzish
... një familje	... një liqen
... furnizimin me ujë	... ushqim
... veten time	... një shesh lojërash shkolla
...	...
...	...
...	...
...	...

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 7, mësimi 4
Çfarë lloj përgjegjësie ka secili?

Marrja e përgjegjësisë, ndarja e përgjegjësisë		
Shembull: ekologjia		
Vendi / gjendja:	Çfarë lloj përgjegjësie ka ky person të ketë?	
Klasa	Mësuesi:	Nxënësi:
Shkolla	Drejtori shkollës:	Mësuesi/Nxënësi:
Shteti	Kryetari i shtetit:	Populli:
?		

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 8, mësimi 1

Detyra për të vendosur mes "DËSHIRA" dhe "NEVOJA"

- Si grup, zgjidhni 10 fotografi nga i gjithë grumbulli. Pesë prej tyre duhet të përshtaten me kategorinë "DËSHIRA" dhe pesë prej tyre duhet të përshtaten me kategorinë "NEVOJA" (në qoftë se dy ose më shumë grupe dëshirojnë të njëjtën foto, përpiqu të gjesh një zgjidhje).
- Diskutoni zgjedhjet tuaja:
 - Pse është e rëndësishme kjo në jetën time?
 - Çfarë do të thotë nëse unë nuk e kam këtë?
 - Çfarë dua që të kem ose të arrij më vonë në jetë?
 - Çfarë do të thotë kjo për mua si djalë/vajzë?
- Renditni 10 fotot e zgjedhura sipas rëndësisë dhe shpjegoni arsyen. A mund të gjendet një zgjidhje që t'i përshtatet të gjithë anëtarëve të grupit?
- Dy anëtarë të grupit duhet të mbajnë spangon e rrobave dhe një person duhet të shpjegojë çdo zgjedhje. Shpjegoni vetëm zgjedhjen e parë dhe të fundit. Mundohuni që të shpjegoni me fjalët tuaja dallimin në mes "DËSHIRA" dhe "NEVOJA". A mund të gjendet një "përkufizim" për të dyja?

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 8, mësimi 2

Të drejtat e njeriut: një listë për të krahasuar të drejtat dhe nevojat

Të drejtat themelore	Lista e "nevojave" që kemi përcaktuar	Cilit nen të Deklaratës së të drejtave të njeriut i takon kjo?
E drejta për të jetuar, ekzistuar		
E drejta për të punuar		
E drejta e pronës		
E drejta e fjalës së lirë		
E drejta për sigurinë		
E drejta për mbrojtje nga dhuna		
E drejta për mbrojtjen e ligjit		
E drejta për të mos u arrestuar, nëse nuk ka arsye për të menduar se është kryer një krim		
E drejta për gjykim të drejtë		
E drejta për t'u parë si i pafajshëm, edhe nëse një person është arrestuar, derisa personi të gjendet fajtor nga një gjykatë e drejtë		
E drejta për të qenë qytetar i një vendi		
E drejta e votës		
E drejta për të kërkuar azil në qoftë se një vend e trajton keq një person		
E drejta për të menduar lirisht		
E drejta për të ushtruar një fe		
E drejta për të protestuar në mënyrë paqësore (për të folur kundër) një qeverie ose grupi		
E drejta për një standard bazë të jetesës (ushqim, strehim, veshje etj.)		
E drejta për arsim		
E drejta për kujdes shëndetësor (kujdesi mjekësor)		
E drejta e çdo të rrituri në moshë të pjekur për t'u martuar, pavarësisht se nga raca, feja apo identiteti seksual		

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 8, mësimi 3

Sondazh për të drejtat e njeriut

Personi i intervistuar (emri, mosha e përafërt, seksi, profesioni, data dhe vendi i intervistës):
Anëtarët e grupit:
Tema 1: A mendoni se është e rëndësishme që të drejtat e njeriut janë vendosur në të gjithë botën? Nëse po, pse? Nëse jo, pse jo?
Tema 2: Cilat të drejta duhet të mbrohen në të gjithë botën? Kush është përgjegjës për ta bërë këtë?
Tema 3: Cilat të drejta duhen mbrojtur më shumë në vendin tonë? Kush është përgjegjës për ta bërë këtë?
Informacione të tjera interesante të siguruar nga ky i intervistuar:

Fletë pune për nxënësin për Kapitullin 9, mësimi 1
Skedat e prezantimit me një përshkrim të shkurtër për pajisjet e
medieve (për t'u prerë dhe pastaj për t'u palosur në mes)

Emri i pronarit: Emri i nxënësit/grupit të nxënësve: Lloji i pajisjes: Funksionet: Viti i prodhimit: Të ndryshme:

Emri i pronarit: Emri i nxënësit/grupit të nxënësve: Lloji i pajisjes: Funksionet: Viti i prodhimit: Të ndryshme:

II. Mjete për nxënësit

Hyrje

Të nderuar nxënës,

Ky është mjeti juaj. Në faqet e mëposhtme ju do të gjeni një numër mjetesh që mund t'ju ndihmojnë

në shkollë ose në shtëpi. Çfarë është një mjet? Ju të gjithë e dini se një çekan, një kaçavidë dhe një palë gërsërë janë mjete. Në mësim, një mjet është një metodë që ju ndihmon ju të mësoni më mirë. Kështu pra, kur ju dini se si të kërkonti informacionin e duhur, si të paraqisni një informacion ose të përgatisni një prezantim, atëherë ju jeni më mirë të përgatitur për jetën.

Mësuesi juaj do t'ju shpjegojë se kur dhe si të përdorni secilin mjet. Por ju mundet gjithashtu t'i shihni vetë mjetet tuaja, sa herë që ju mendoni se është e nevojshme.

Mjetet mund t'ju ndihmojnë me gjëra të ndryshme, të tilla si:

- Si të kërkonti dhe të mblidhni informacion;
- Si të përzgjidhni informacionin tuaj;
- Si të kryeni punë krijuese;
- Si të paraqisni punën tuaj;
- Si të punoni me nxënësit e tjerë.

Çdo mjet fillon në një faqe të veçantë. Ju mund ta lexoni atë që shkruhet, vetëm ose së bashku me një koleg.

Ju tashmë mund të njihni disa nga mjetet. Disa prej tyre mund të jenë të reja dhe të dobishme për ju.

Ne shpresojmë që ju ta shijoni punën që bëni dhe të fitoni më shumë kënaqësi nga përdorimi i mjeteve.

Përmbajtja

1. Hulimtim në biblioteka
2. Hulimtim në internet
3. Kryerja e intervistave dhe e sondazheve
4. Interpretimi i figurave
5. Harta Imagjinare
6. Krijimi i posterave
7. Organizimi i ekspozitave
8. Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve
9. Përgatitja e sliderave për projektor ose një prezantim në PowerPoint
10. Shkrimi i artikujve të gazetave
11. Organizimi i shfaqjeve
12. Organizimi i debateve

1. Huluntim në biblioteka

Në biblioteka ju mund të gjeni shumë informacion që ju nevojitet kur studioni një temë. Për të përdorur këtë informacion, ju duhet të jeni në gjendje të zgjidhni pjesët më të rëndësishme. Lista e mëposhtme mund t'ju ndihmojë në këtë drejtim.

1. Cili është qëllimi im?

- Çfarë jam duke krijuar? Si duhet të jetë produkti përfundimtar? A duhet të jetë një prezantim? Një raport? Një poster?
- Ju do të duhet të shikoni për lloje të ndryshme informacioni, në varësi të qëllimit tuaj të punës. Për të bërë një poster, ju duhet të gjeni foto që mund t'i siguroni nga revista; për një raport ju duhet të gjeni informacion të saktë në lidhje me temën.

2. Çfarë informacioni më duhet mua?

- Shkruani çdo gjë që dini në lidhje me temën (një hartë mendore mund t'ju ndihmojë shumë).
- Shkruani çdo gjë që dëshironi të dini në lidhje me temën (nënvizoni pikat në hartën tuaj mendore). Përcaktoni pikërisht atë aspekt të temës për të cilën ju dëshironi të dini. Në varësi të produktit tuaj përfundimtar, ju mund të keni nevojë të përcaktoni mjaftë aspekte ose vetëm disa syresh.

3. Si mund të gjej informacion dhe si mund ta organizoj atë?

- Shikoni nëpër libra, revista, filma etj., që keni gjetur në bibliotekë dhe vendosni nëse ata mund t'u përgjigjen pyetjeve që u kërkohen. Ndihmën e nevojshme mund ta gjeni duke kërkuar nëpër indekset ose tabelat e përmbajtjes.
- Në një fletë të veçantë, shënoni titullin e librit dhe numrin e faqes ku keni gjetur informacionin. Ju gjithashtu mund të shënoni faqen me një libërshënues ose letër që ngjitet.
- Mund të gjeni të dobishme edhe faqet e fotokopjuara. Ndërkohë, mos harroni të shënoni titullin e librit që fotokopjohet.
- Shikoni fotografi të ndryshme nga revistat. Bëni fotokopjet e tyre ose shënoni faqen me një libërtragues.
- Nëse përdorni një film, shikojeni filmin dhe ndaloheni atë sa herë ndodh diçka interesante.
- Mblidhni materiale dhe i vendosni të gjitha bashkë në një dosje plastike.
- Theksoni informacionet më të rëndësishme.
- Me fjalët tuaja, shkruani informacionin më të rëndësishëm në lidhje me temën në një letër A4.

4. Si mund ta paraqesim informacionin?

Ju mundeni, për shembull:

- Të bëni një poster;
- Të organizoni një ekspozitë;
- Të mbani një fjalim;
- Të krijoni disa slajdera projektori;
- Të shkruani një artikull gazete;
- Të tregoni një klip video.

5. Si mund të vlerësoj huluntimet e mia?

- A e keni mësuar ndonjë gjë të re?
- A gjetët sa duhet informacion të vlefshëm?
- Cilat hapa shkuan mirë në kërkimin tuaj? Çfarë ishte e vështirë?
- Çfarë do të bëni ndryshe herën tjetër?

2. Hulumtim në internet

Ju mund të gjeni informacion në lidhje me çdo subjekt të imagjinueshëm në internet. Ju duhet të mendoni paraprakisht si do të gjeni informacionin më thelbësor dhe të saktë në lidhje me temën tuaj.

1. Gjetja e informacionit

Shënoni, në një fletë letre, fjalët kyç për temën tuaj, të dhënë ose të zgjedhur,. Mundohuni të analizoni se çfarë doni saktësisht të dini në lidhje me këtë temë.

Shembuj:

- EQD/EDNJ;
- Këshilli i Evropës;
- Pakicat;
- Demokracia.

Kombinojini termat e kërkimit, për shembull "tregjet e qyteteve mesjetare", duke përdorur thonjëza.

- Cilat kombinime, fjala vjen, do t'ju ndihmojnë për të gjetur informacionin më të rëndësishëm në lidhje me temën tuaj?
Shënoni këto kritere në një fletë letre.

2. Kontrolloni informacionin tuaj

Për shkak se kushdo mund të hyjë në internet për të krijuar informacion, është e rëndësishme të përdorni metodën e kontrollit të dyfishtë për informacionin që gjeni, për para se ta përdorni atë.

Mundohuni të sqaroni problemet e mëposhtme:

- A mund të gjeni këtë informacion në faqet e tjera në internet?
- Kush e bën informacionin të arritshëm nga publiku?
- Çfarë interesi mund të ketë një person ose organizatë në bërjen e këtij informacioni të arritshëm nga publiku ?
- A është personi ose organizata e besueshme?
- Krahasoni të dhënat nga interneti me informacione nga burime të tjera:
- A mund të gjeni të njëjtin informacion në një libër, me anë të një interviste ose nëpërmjet përvojës suaj?
- A është informacioni në internet i përditësuar, i kuptueshëm, më i plotë se ai që ju mund ta gjeni në një libër, intervistë ose përmes vëzhgimit tuaj?
- Cilat informata i përshtaten më mirë qëllimit tuaj?

3. Ruajtja e informacionit

Pasi të keni gjetur një adresë të mirë interneti, të cilën ju dëshironi ta vizitoni përsëri më vonë ose të dëshironi ta përdorni si një burim për punën tuaj, bëni listën tuaj personale të uebsiteve:

- Hapni një dokument të veçantë.
- Theksoni URL (adresa).
- Kopjoni URL duke shtypur CTRL (kontrolli) dhe C në të njëjtën kohë.
- Hidhjeni URL në një dokument, duke shtypur CTRL (kontrolli) dhe V në të njëjtën kohë.
- Ruani dokumentin tuaj nën "ueblastopic", p.sh. "ueblast_demokraci".

3. Kryerja e intervistave dhe sondazheve

Ju mund të mblidhni informacion në lidhje me një temë, kur pyesni njerëzit për njohuritë e tyre rreth temës ose kur doni të dini mendimin e tyre.

Ju mund të pyesni:

- Specialistët - në qoftë se doni të gjeni diçka specifike në lidhje me një temë; ose
- Njerëz të cilët nuk kanë ndonjë përvojë të veçantë për këtë temë, por ju jeni të interesuar të dini çfarë ata mendojnë për temën tuaj.

Intervistat ose vrojtimit bëhen më mirë së bashku me një grup të vogël. Në këtë mënyrë mund të ndihmoni njëri-tjetrin me pyetjet dhe me regjistrimin e përgjigjeve.

Ju mund të përdorni këto pika në listë:

- Shkruani një përgjigje të shkurtër për çdo pyetje.
- Shënoni pyetjet për të cilat nuk keni marrë përgjigje.
- Diskutoni ndonjë pyetje të hapur me klasën tuaj.

Hapat për të ndërmarrë:

1. Qëllimi

- Cila është tema jonë? Çfarë duam të dimë?
- Si duhet të jetë produkti përfundimtar?

2. Përgatitja

- Kush duhet të intervistohen? Sa njerëz? A luan rol mosha a gjinia?
- Si mund të zgjidhen njerëzit e duhur?
- Kur duhet të bëhet intervista/sondazhi?
- Si duhet të bëhet?
- Kush duhet të njoftohet ose nga cilët duhet të marrim leje?
- Si do të regjistrohen përgjigjet (në kasetë, shënime, pyetësorë)?

3. Pyetjet

- Çfarë pyetje duhet të bëjmë?
- Sa pyetje mund të bëjmë? Sa kohë kemi?
- Vendosini pyetjet së bashku për të formuar një sondazh.

4. Kryerja e vrojtimit/intervista

- Si mund të fillojmë me pyetjet?
- Si do të ndahen rolet në grup (kush drejton pyetjet, kush merr shënim përgjigjet, kush fillon dhe ndalon regjistruesin e incizimit)?
- Si mund ta përfundojmë intervistën?

5. Vlerësimi

- Nëse ju intervistuat një specialist, mendoni për gjërat më të rëndësishme që ai tha dhe i mbani ato shënim.
- Nëse keni pyetur disa njerëz për të njëjtën temë dhe do të doni të dini se sa nga këta njerëz ju përgjigjen në mënyrë të ngjashme, atëherë grumbulloni përgjigjet e ngjashme.

6. Prezantimi

Vendosni nëse prezantimi do të jetë për:

- klasën;
- për të shkruar një artikull gazete;
- për të krijuar një poster; ose
- diçka tjetër.

4. Interpretimi i figurave

Ashtu si tekstet, edhe fotografitë përmbajnë mjaft informacion. Këshillat e mëposhtme do t'ju ndihmojnë për të interpretuar dhe kuptuar fotot.

Zbuloni informacion në lidhje me foto:

- Cilat janë ngjyrat më të rëndësishme në foto?
- Ku janë format e dukshme, modelet, linjat?
- Çfarë është më e madhe ose më e vogël se normalja?
- Sa e madhe është sendi/personi në foto, në realitet?
- Çfarë periudhe kohore (në të kaluarën, të tashmen) dhe çfarë kohe e vitit ose e ditës është paraqitur në foto?
- Nga cili këndvështrim e shihni ju subjektin e fotos: përmes syve të një bretkose, një zogu apo një personi?
- Çfarë mund të dalloni në foto?
- Çfarë lloj fotoje është ajo (një foto, një poster, një pikturë, një gdhendje druri, një grafikë, një kolazh, një portret, një peizazh, një karikaturë etj.)?
- Çfarë është e ekzagjeruar ose e theksuar në foto (drita/errësira, raportet, dukja/sfondi, raporti i ngjyrave, lëvizja/ngjirja, gjestet, shprehjet e fytyrës)?

Merrni në foto:

- Çfarë është veçanërisht e rëndësishme për foton?
- Çfarë ju pëlqen në lidhje me të?
- Cila është karakteristikë e fotos?
- Si ndiheni kur shikoni foton?
- Cila pjesë e fotos është më e bukur?
- Ç'fjalë ju vijnë në mendje kur shikoni foton?

Diskutoni foton:

- Përshkruani foton me fjalët tuaja.
- I tregoni njëri-tjetrit se çfarë është kuptimplote, e mrekullueshme apo e rëndësishme në foto.
- Bëjini pyetje njëri-tjetrit në lidhje me një tjetër foto.
- Jepni komanda të shkurtra njëri-tjetrit, të tilla si kërko për, gjej, trego, shpjego ...
- Diskutoni pyetje të tilla si: Përse janë zgjedhur këto foto? Cilat fotografi plotësojnë tekstin që i takon një fotoje? Cila foto bie ndesh me atë që është shkruar në tekst?

Puno me fotot:

- Zgjidhni një foto dhe vëreni se ç'gjëra veprojnë jashtë skenës atje.
- Prezantoni personin që shihni në foto.
- Ndryshoni fotot dhe jepni komentin për to.
- Krahasoni fotografitë historike me fotot që keni përpara.
- Shpjegoni se çfarë do të kishte qenë e vështirë për të kuptuar në tekst, në qoftë se nuk do të kishit pasur fotot për t'ju ndihmuar.
- Shtoni foto të përshtatshme që plotësojnë tekstin.
- Krahasoni fotot dhe i vlerësoni ato. A ju pëlqejnë? Nëse jo, pse jo?
- Shkruani një përshkrim të fotos.

- Mendoni se çfarë ka ndodhur pak përpara shkrepjes së fotos?
- Mendoni se çfarë do të ndodhte nëse fotot do të mund të bëheshin të gjalla.
- Shtojini disa gjëra që ju vijnë në mendje për momentin, fjalë me tekst në foto.
- Përshkruani aromën dhe tingullin që fotoja ju bën të mendoni.
- Mblidhni fotot e subjekteve të ngjashme.

Interpretoni fotot:

- Çfarë titulli do t'i vini fotos?
- Ku është marrë, vizatuar apo shkrepur fotoja?
- Çfarë dëshiron fotografi/artisti të thotë me këtë foto?
- Pse është marrë ose vizatuar/shkrepur kjo foto?

5. Hartat mendore


Një hartë mendore ju ndihmon për të organizuar mendimet tuaja. Këtë do të thotë fjalë për fjalë termi. Hartat mund të jenë të dobishme në situata të ndryshme, kur ju duhet të mendoni për një temë specifike: mbledhjen e ideve, përgatitjen e një prezantimi, planifikimin e një projekti etj.

Udhëzimet për krijimin e një harte mendore

- Shkruani emrin e temës suaj në mes të letres dhe vizatoni një rreth për qark saj. Sigurohuni që të përdorni letër të madhe.
- Vizatoni disa vija të trasha që dalin si reze jashtë nga rrethi. Në çdo linjë, shkruani emrin e një nën subjekti, lidhur me temën kryesore në mes.
- Nga vijat e trasha, ju mund të hiqni linja të holla shtesë, që përfaqësojnë nënkategori ose pyetje, që lidhen me nëntemën e shkruar në vijën e trashë.
- Mundohuni të gjeni sa më shumë terma dhe vendosini në kategoritë e duhura. Ju mund të përdorni madhësi të ndryshme shkronjash, simbole dhe ngjyrash.

Krahasoni hartën tuaj mendore me ato të shokëve!

- Çfarë vini re?
- Në çfarë aspektesh harta juaj mendore është e ngjashme me atë të tjerëve?
- Si shprehet ndryshimi?
- Cilat janë termat më të rëndësishme?
- A ka kuptim organizimi i nënkategorive?
- A ka ndonjë gjë të rëndësishme që mungon?
- Çfarë do të bëni ndryshe herën tjetër?

	
Tema:	Data:

6. Krijimi i Posterit

Një poster ju mundëson të regjistroni punën tuaj dhe t'ua paraqisni atë shokëve të klasës. Është e rëndësishme që një poster të jetë i organizuar në mënyrë të tillë që t'i bëjë njerëzit t'i kushtojnë vëmendje. Posteri duhet t'i bëjë vëzhguesit kureshtarë për të gjetur më shumë gjëra në të.

Në një grup të vogël, shqyrtoni karakteristikat e rëndësishme të një posteri të suksesshëm dhe mendoni për elementet që mund të integrohen në posterin tuaj.

Nëse keni përgatitur tashmë një poster tuajin, ju mund të përdorni këto karakteristika për të vlerësuar një poster tjetër.

Listë kontrolli

Titulli: duhet të jetë i shkurtër dhe interesant; i dukshëm nga distanca.

Shkrimi: duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm nga larg. Në qoftë se përdorni kompjuterin, mos përdorni shkronja shumë të ndryshme. Shkruani fjali të shkurtra, që janë të dukshme nga distanca.

Piktura, fotografia, grafika: këto duhet të mbështesin atë që keni për të thënë dhe për ta bërë posterin më interesant. Kufizojeni veten në vetëm disa gjëra mbresëlënëse.

Prezantimi: ku duhet të vendoset: titulli, mbishkrimet, simbolet, kutitë, fotografitë ose vizatimet?
Skematizoheni posterin tuaj para se të filloni.

Organizoni me kujdes elementet e posterit: posteri duhet të plotësojë formatin e zgjedhur, por nuk duhet të jetë i ngjeshur.

7. Organizimi i ekspozitës

Një ekspozitë i ndihmon grupet e nxënësve për të paraqitur punën e tyre në mënyrë që të tjerët (klasa ose mysafirët e ftuar) të mund të marrin një ide se çfarë bëri grupi. Lista e plotë e mëposhtme mund t'ju ndihmojë të planifikoni dhe të organizoni ekspozitën.

Listë kontrolli

1. Çfarë duam të demonstrojmë

- Cili është mesazhi kryesor i ekspozitës?
- Cili mund të jetë titulli i ekspozitës suaj?

2. Kush është audiencia?

- Fëmijët dhe mësuesit nga shkolla juaj?
- Prindërit, vëllezërit e motrat?
- Klientët nga një agjenci zyrtare turistike?

3. Ku do të mbahet ekspozita?

- Në klasë ose diku në shkollë?
- Në një vend publik (për shembull, në sallën e bashkisë)?
- A do të ketë hapësirë dhe ndriçim të mjaftueshëm?
- A do të keni infrastrukturën e nevojshme?

4. Si mund të organizojmë një ekspozitë të paharrueshme?

- Të lejojmë modelet dhe objektet të preken?
- Të lejojmë hapësira për të luajtur, duke u provuar, vëzhguar ose eksperimentuar gjëra në shkollë?
- Të luhet muzikë apo të luajmë vetë?
- të ofrojmë ushqime të shpejta?
- Të caktojmë një udhërrëfyes të ekspozitës?
- Të krijojmë një fletëpalosje si një udhëzues për ekspozitën?
- Të organizojmë një garë apo një kuic?

5. Kush duhet të informohet paraprakisht?

- Mësuesit në shkollën tonë?
- Restoranti, pastrimi, mirëmbajtja dhe mbështetjen e stafit?
- Anëtarët e bordit të *Shkollës*?
- Drejtuesit?
- Specialistët që mund të na ndihmojnë?
- Vizitorët?

6. Çfarë duhet të bëjmë?

- Të krijojmë një listë të plotë vetjake?
- Të krijojmë një listë të materialeve?
- Të krijojmë një plan kohor (cili bën çfarë në çdo moment)?
- A duhet të dimë sa pará janë në dispozicion dhe ç'shumë është përdorur?

- Të krijojmë një fletëpalosje ose një ftesë?
- Të informojmë gazetatat lokale?

7. Si do të vlerësohet ekspozita?

- Cilat janë kriteret më të rëndësishme?
- Kush do të vlerësojnë ekspozitën (mësuesit, shokët e klasës, vizitorët)?

8. Planifikimi dhe paraqitja e prezantimeve

Ju mund të përgatisni një fjalim për shokët e klasës suaj, prindërit ose fëmijët e tjerë në shkollën tuaj. Në çdo rast, ju duhet ta përgatitni fjalimin sa mirë. Lista e plotë e mëposhtme do t'ju ndihmojë që ta bëni si duhet këtë.

A. Planifikimi i një fjalimi

1. Kush do të jenë dëgjuesit?

- Ku duhet ta ligjëroni fjalën tuaj?

2. Kush po e përgatit fjalimin?

- A po e përgatisni fjalimin tuaj i vetëm apo me një grup?

- Si e ka organizuar veten grupi?

3. Cili është qëllimi i fjalës?

- Çfarë duhet të mësojnë audienca?

- A duhet që audienca të reagojë?

4. Sa kohë keni?

- A do t'i lini kohë audiencës që të bëjë pyetje?

- A do t'i lini kohë audiencës për të dhënë opinione e reagime?

5. Cilat burime janë në dispozicion?

- Dërrasa e zezë / tabelë e bardhë?

- Projektor i varur?

- Kompjuter dhe projektues për një prezantim në PowerPoint?

- Postera (tabela)?

- Stereo?

6. Si mund të përfshihet audienca juaj?

- Jepni kohë për pyetje.

- Krijoni një mister apo një kuic.

- Kalo objekte dorë më dorë.

7. Çfarë doni të thoni?

- Mendoni për 3-6 tituj që janë të rëndësishëm për temën tuaj dhe shkruajini ato në një fletë individuale letre;

- Në çdo copë letër, shënoni disa fjalë kyçe për çdo titull.

B. Mbajtja e fjalimit

Një prezantim mund të ndahet në pjesë të ndryshme: një hyrje, pjesa kryesore dhe një përfundim.

Këtu janë disa ide për t'ju ndihmuar që të mbani sa më bukur fjalën tuaj.

1. Hyrja

- Filloni me një thënie përkatëse, ose duke treguar një foto apo objekt.

- Paraqitni temën kryesore.

- Shpjegoni se si do të strukturohet fjalimi.

2. Pjesa kryesore

- Informoni audiencën në lidhje me temën e fjalimit.
- Vendosni fletët e përgatitura më parë, në mënyrë që të tregohen titujt dhe informacioni.
- Organizoni fjalimin sipas këtyre titujve.
- Çdo herë që të filloni me një titull të ri, bëjeni këtë të qartë përmes një fotoje, shpjegimi etj.
- Paraqisni një foto të përshtatshme, objekt ose pjesë muzikore nën çdo titull.
- Mendoni si do ti shfaqni fotografitë - nëse do t'i kaloni dorë më dorë, do të përdorni në projektor apo do t'i shfaqni në një poster, etj

3. Përfundimi

- Thoni atë që është e re për ju.
- Thoni atë që keni mësuar.
- Tregoni një foto finale.
- Kuic për shokët e klasës.
- Lejo kohë për pyetje.

9. Përgatitja e fletave transparente për projektor ose e një prezantimi me PowerPoint

Prezantimi me PowerPoint ose me projektor, përdoren shpesh gjatë prezantimeve dhe rregullat për të dy janë të njëjtat.

Për krijimin e sliderave kushtojini vëmendje:

- Shkronja të qarta dhe të lexueshme
- Përdorni vetëm një madhësi shkronje
- Printimi të jetë i madh
- Të ketë hapësirë të mjaftueshme mes rreshtave
- Të mos ketë shumë tekst në çdo fletë transparente
- Në fletët transparente të jenë të pastra
- Hartat dhe grafikët të jenë të mëdha, fotot të jenë të dukshme;
- Ngjyrat të jenë të ndryshme, po ashtu dhe simbolet;
- Numri i fletëve transparente nuk duhet të jetë i madh.

Cili është më e mirë – fletët transparente apo prezantimi me PowerPoint?

Secila ka avantazhet dhe dizavantazhet e veta. Këtu do të gjeni disa të dhëna të rëndësishme, që të kuptoni se sa e lehtë do të jetë për ju të zgjidhni për të përdorur mes projektorit apo prezantimit me PowerPoint.

Cila formë e prezantimit është e duhura për nevojat tuaja?

Lexoni pikat e mëposhtme për t'ju ndihmuar çfarë mund të zgjidhni.

Projektori është më i mirë nëse:

- Ju keni më pak se pesë slidera për të treguar;
- Ju duhet të tregoni ose të shpjegoni diçka që shprehet në slidera;
- Ju duhet të shkruani në një slider gjatë prezantimit;
- Ju duhet të tregoni vetëm një foto në çdo slider;
- Ju duhet të mbulonit dhe zbuloni diçka në foto;
- Ju duhet të ndani detyrën në grupin tuaj dhe të caktoni një slider për secilin anëtar të grupit.

Prezantimi me PowerPoint është më i mirë nëse:

- Ju keni shumë informacion për të paraqitur;
- Ju keni një numër të madh të slajderash;
- Ju duhet të tregoni pjesë të informacionit njëherë pas tjetrës, në të njëjtin slajder;
- Ju duhet të tregoni diçka nga Interneti gjatë prezantimit tuaj;
- Ju duhet të tregoni një videoklip, një imazh digjital ose diçka që ka qenë e ruajtur në kompjuter;
- Ju duhet të përdorni video në një moment të mëvonshëm në kohë ose ta vini atë së bashku në një mënyrë tjetër.

10. Shkrimi i Artikujve të gazetave

Për të informuar të tjerët në lidhje me temën tuaj, ju mund të luani rolin e një gazetari dhe të shkruani një artikull për një gazetë. Në EQD/EDNJ, të shkruarit e një artikulli është një mënyrë për t'i bërë temat publike. Kjo mund të ndihmojë për të ndryshuar e këqija në shoqëri.

Një artikull gazete është i ndarë në seksione të ndryshme:

- **Titulli:** duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë.
- **Paragrafi kryesor:** një hyrje e temës në shumë pak vend dhe me fjali të shkurtra.
- **Autorët:** kush shkruan artikullin?
- **Teksti:** Vetë artikulli.
- **Krerët:** për të ndihmuar lexuesin për të parë "kapitujt".
- **Pamjet:** një foto kuptimplote për tekstin, me një shpjegim të shkurtër nën të.

Listë kontrolli:

- Krahasoni një artikull gazete (nga gazeta e sotme) me shembullin që shihni më sipër. A mund t'i dalloni seksionet e ndryshme?
- Theksoni seksionet duke përdorur ngjyra të ndryshme.
- Kushtojini vëmendje stileve të shkronjave (të forta, normale, të pjerrëta).
- Krahasoni artikullin tuaj të gazetës me ato të shokëve tuaj.
- Përdorni këto seksione në vetë artikullin tuaj të gazetës.

11. Organizimi i një shfaqje

Vënia në skenë e historive është një mënyrë e mirë për të reflektuar për jetën njerëzore. Ju mund të krijoni skena, duke përdorur foto, një pjesë muzikore ose një objekt. Kur filloni të veproni, thuhet se po merrni një rol. Kjo do të thotë që ju përpiqeni të merrni në dorë ndjenjat e një personi të veçantë dhe t'i vini ato në skenë. Pas shfaqjes, të gjithë do të jenë në gjendje të mendojnë se cilat pjesë të saj ishin "të vërteta" dhe cilat ishin të imagjinuara.

Shfaqje "e lirë"

- Shkruani fjalët kyçe që përfaqësojnë shfaqjen.
- Vendosni kush do të luajë rolin dhe se çfarë është e rëndësishme për të kujtuar në çdo rol.
- Mblidhni të gjitha materialet e nevojshme.
- Lexoni skenarin.
- Përgatisni skenën.
- Shijoni shfaqjen.

Më pas, diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë mundët të shihnit?
- A e kuptuan të gjithë çdo gjë?
- Çfarë ishte veçanërisht e mirë?
- Sipas mendimit tuaj, a mungonte gjë ?
- Çfarë ishte disi e ekzagjeruar?
- Çfarë pyetjesh kemi në lidhje me përmbajtjen?

Krijimi i një dramatizimi nga një tekst

Lexoni ngjarjen së bashku dhe krijoni skenat:

- Kush ishte i përfshirë? Ku ka ndodhur?
- Si e trajtuan njerëzit situatën? Çfarë thanë ata?
- Si reagueshan të tjerët?
- Si përfundon ngjarja?
- Vendosni për numrin e akteve të shfaqjes.
- Si do të ndahen rolet? Cilat kostume do të jenë të nevojshme?
- Lexoni skenarin tuaj.
- Vlerësoni shfaqjen së bashku me shokët e klasës suaj.

Krijimi i një shfaqjeje prej një imazhi

- Shikoni një foto që mund të përdoret si bazë për një lojë.
- Përfytyroni veten në foto.
- Mblidhni ide: si jetojnë njerëzit që shihni në foto? Përse janë të lumtur në lidhje me...? Përse janë të pakënaqur në lidhje me...?
- Krijoni një shfaqje duke përdorur këtë foto dhe shënoni fjalët kyçe për çdo skenë.
- Vendosni për numrin e akteve të shfaqjes .
- Vendosni për ndarjen e roleve dhe çfarë është e rëndësishme në secilin prej tyre.
- Lexoni shfaqjen dhe gjeni rekuizitën.
- Merrni në dorë situatën dhe ftoni vizitorët.
- Vlerësoni shfaqjen së bashku me lojën e shokëve të klasës suaj.

12. Organizimi i debateve

Një debat na bën të vetëdijshëm për mendimet e ndryshme në lidhje me një temë dhe për të kuptuar avantazhet dhe dizavantazhet e çështjeve të diskutueshme. Për një debat, është e nevojshme prania një çështje kundërshtuese, për të cilën mund të përgjigjemi me *po* ose *jo*. Në një demokraci, ka gjithmonë më shumë se një zgjidhje ose një mendim.

Dy opinione - një debat

Ja se si funksionon:

- Ndani klasën tuaj në dy grupe. Njëri grup është "pro" çështjes, grupi tjetër është "kundër" çështjes.
- Secili grup gjen argumente⁵ për të mbështetur qëndrimin e tij. Ata duhet të mbledhin edhe argumentet e kundërta me ato të grupit tjetër.
- Shënoni argumentet tuaja duke përdorur fjalë kyçe.
- Secili grup cakton dy folësit.
- Debatu organizohet në tri pjesë: raundi i hapjes, debati i hapur dhe raundi i mbylljes.
 - Raundi i hapjes: Secili folës shpjegon saktë dhe shkurtimisht argumentet e tij. Grupi "pro" dhe "kundër"⁶ paraqesin me radhë argumentet e tyre.
 - Debatu: folësit paraqesin argumentet e tyre dhe përpiqen të kundërshtojnë me anën e argumenteve.
 - Raundi i mbylljes: ky raund ka të njëjtën procedurë me atë të hapjes. Çdo person ka mundësi për të përmbledhur mendimin e tij ose të saj.

Mbajtësi i kohës

- Zgjidhni dikë nga klasën tuaj që jetë përgjegjës për mbajtjen e kohës gjatë debatit.
- Raundi i hapjes duhet të zgjasë jo më shumë se tetë minuta (çdo person mund të flasë për dy minuta).
- Debatu duhet të zgjasë jo më shumë se gjashtë minuta.
- Raundi i mbylljes duhet të zgjasë jo më shumë se katër minuta (një minutë për person).
- Në qoftë se dikush shkon përtej kohës së caktuar, mbajtësi i kohës i bie ziles.

Vëzhguesit

Nxënësit që nuk janë folës vëzhgojnë se çfarë ndodh. Pas debatit, edhe ata thonë atë që kanë vënë re, duke përdorur pikat e mëposhtme si bazë:

- Cilat janë argumentet që u prezantuan?
- Kush është përgjegjës për zbatimin, çfarë do të zbatojë dhe si?
- A ju lejua çdo kryetari të fliste, apo u ndërpre?
- Si u përpoqën folësit e ndryshëm t'ua transmetonin mesazhin të pranishmëve?
- Cilët ishin argumentet bindës?
- Çfarë shembuj argumentesh të mirë u prezantuan?
- Cilat fjalë u përdorën më shpesh?
- Si folën folësit (duke përdorur edhe gjuhën e trupit, zërin e lartë, uljen dhe ngritjen e tij etj.)?

5. Argumenti: një deklaratë që formulohet për të mbështetur një kërkesë.

6. Pro dhe kundër: kjo do të thotë "në mbështetje" të një pikëpamjeje dhe "kundër kësaj pikëpamjeje".

Të fshehtat e nëntë koncepteve kyçe



Rritemi në *demokraci* i drejtohet mësuesve që duan të integrohen në Edukimin për Qytetari Demokratike (EQD) dhe Të drejtat e Njeriut (EDNJ) në mësimdhënien e tyre të përditshme. Nëntë kapituj mësimorë, me rreth katër mësim për secilin kapitull, na japin udhëzime hap pas hapi, duke përfshirë të dhëna për nxënësit dhe informacione për mësuesit. Manuali i plotë mundëson programin e një viti të plotë shkollor për nxënësit në shkollën fillore (klasat 4 - 6), por meqenëse çdo kapitull, është i plotë në vetvete, manuali lejon lirshmëri të madhe në përdorim. Prandaj, është ai i përshtatshëm për redaktorët e teksteve, zhvilluesit e kurrikulës, për trajnerët, mësuesit kujdestarë dhe mësuesit fillestarë.

Objektivi i EQD/EDNJ është që të mësojë fëmijët të bëhen qytetarë aktivë, të jenë të gatshëm dhe të aftë për të marrë pjesë në komunitetin demokratik. Prandaj, EQD/EDNJ thekson fuqimisht veprimin dhe të mësuarit në bazë detyre. Komuniteti i shkollës është konceptuar si një fushë përvoja e mirëfilltë, ku të rinjtë mund të mësojnë si të marrin pjesë në vendimmarrjen demokratike dhe të marrin përgjegjësinë qysh në këtë moshë. Konceptet kryesore për EQD/EDNJ mësohen si mjete të të mësuarit përgjatë gjithë jetës.

Ky është Vëllimi II nga një seri prej gjashtë vëllimesh. Vëllimet e tjera janë:

EQD/EDNJ Vëllimi I: *Edukimi për demokraci* - Materiale në ndihmë të mësuesve të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut

EQD/EDNJ Vëllimi II: *Rritemi në demokraci* – Veprimtari mësimorë për arsimin fillor për edukimin për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut

EQD/EDNJ Vëllimi III: *Të jetojmë në demokraci* - Veprimtari mësimorë për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut për arsimin e mesëm të ulët

EQD/EDNJ Vëllimi IV: *Pjesëmarrja në demokraci* – Veprimtari mësimorë për arsimin e mesëm të lartë për edukimin për qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut

EQD/EDNJ Vëllimi V: *Eksplorimi i të drejtave të fëmijëve* - Nëntë projekte të shkurtër për arsimin fillor

EQD/EDNJ Vëllimi VI: *Mësimdhënia e demokracisë* – përmbledhje e modeleve për edukimin për qytetari demokratike dhe edukimin e të drejtave të njeriut

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

<http://book.coe.int>
Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar pothuajse të gjithë kontinentin e Evropës. Ai kërkon të zhvillojë parimet e përbashkëta demokratike dhe ligjore, në bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Dokumenteve të tjera referencë, për mbrojtjen e individëve. Që kur ai u themelua, në vitin 1949, si pasojë e Dytë Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Evropës ka simbolizuar gjithnjë pajtimin.